



Strasbourg, 19.10.2021
KOM(2021) 644 final

**KOMUNIKATË NGA KOMISIONI PËR PARLAMENTIN EVROPIAN, KËSHILLIN,
KOMITETIN EKONOMIK DHE SOCIAL EVROPIAN DHE KOMITETIN E
RAJONEVE**

Komunikatë e vitit 2021 mbi politikën e zgjerimit të BE-së

{DPS(2021) 288 final} - {DPS(2021) 289 final} - {DPS(2021) 290 final} –
{DPS(2021) 291 final} - {DPS(2021) 292 final} - {DPS(2021) 293 final} –
{DPS(2021) 294 final}

SHQ

SHQ

I. HYRJJE

Kjo komunikatë përmbledh një pasqyrë të zhvillimeve që nga paketa e fundit e zgjerimit, e miratuar në tetor 2020. Kjo shqyrton progresin e bërë nga Ballkani Perëndimor dhe Turqia, sfidat e hasura dhe reformat që duhen adresuar, si dhe përcakton konkluzionet dhe rekomandimet për periudhën në vijim. Gjithashtu merr parasysh rrethanat specifike, përfshirë pandeminë COVID-19, që kanë ndikuar në zhvillimet në BE dhe rajon.

Samiti ndërmjet **BE-së dhe Ballkanit Perëndimor** i mbajtur më 6 tetor 2021 dërgoi një sinjal të rëndësishëm për partnerët e BE-së nga Ballkani Perëndimor se e ardhmja e tyre është në Bashkimin Evropian. **Angazhimi i fuqishëm dhe strategjik i BE-së** në rajon u pasqyrua përmes disa veprimeve kyçe që sollën përfitime të prekshme për qytetarët e Ballkanit Perëndimor, që nga mbështetja e vazhdueshme për reagimin kundër COVID-19 deri te një zotim i rëndësishëm financimi sipas Planit Ekonomik dhe të Investimeve¹ për të përforcuar zhvillimin afatgjatë të rajonit dhe rimëkëmbjen e qëndrueshme. Krerët ranë dakord të forcojnë bashkëpunimin në një sërë fushash, duke përfshirë sigurinë dhe u angazhuan për mbajtjen e samiteve ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor si ngjarje të rregullta.

Pandemia COVID-19 goditi rëndë Ballkanin Perëndimor në gjysmën e dytë të vitit 2020 dhe në fillim të vitit 2021. Pas paketës fillestare të BE-së prej mbi 3.3 miliardë eurosh për të përfituar njerëzit dhe bizneset në Ballkanin Perëndimor², Plani Ekonomik dhe i Investimeve ka shtuar 9 miliardë euro të tjera në mbështetje për rimëkëmbjen socio-ekonomike të rajonit në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit (IPA). Synimi është gjenerimi i investimeve potenciale shtesë në vlerën 20 miliardë euro.

Të gjithë partnerët e Ballkanit Perëndimor u janë bashkuar mekanizmit COVAX, të cilës BE-ja, si pjesë e Team Europe, i ka ndarë tani mbi 3 miliardë euro. COVAX siguron **qasje në vaksina të sigurta dhe efikase** kundër COVID-19 për partnerët pjesëmarrës, me një çmim të negociuar. Përveç mbështetjes së konsiderueshme për COVAX, Bashkimi Evropian ndau 70 milionë euro grante për Ballkanin Perëndimor kryesisht për rishitjen e vaksinave të blera nga BE-ja. Si pikënisje, 650,000 doza u dorëzuan ndërmjet majit dhe gushtit 2021, të facilituara nga Austria, e pasuar nga donacione nga disa shtete anëtare, në emër të Team Europe. Në total, BE-ja dhe Shtetet Anëtare të saj kanë ofruar 2.9 milionë doza të vaksinave për Ballkanin Perëndimor. Mekanizmi për Mbrojtje Civile i BE-së kontribuoi në shpërndarjen e vaksinave dhe materialit mjekësor dhe nga rezervat e urgjencës mjekësore nga Shtetet Anëtare dhe *rescEU*. BE-ja do të vazhdojë të mbështesë planet e vaksinimit të të gjithë partnerëve për të ndihmuar në arritjen e shkallës së ngjashme të vaksinimit me mesataren e BE-së deri në fund të vitit 2021.

Marrë parasysh perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor, BE-ja ka vazhduar ta trajtojë rajonin si partnerë të privilegjuar duke i lidhur ata me mekanizmat dhe instrumentet e BE-së, përfshirë mbledhjet e Komitetit të Sigurisë Shëndetësore, prokurimin e përbashkët të kundërmasave mjekësore, Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian, Fondin e Solidaritetit, asistencën konsullore për riatdhesim dhe lirim nga kufizimet e përkohshme të eksportit të pajisjeve mjekësore nga BE-ja. Për më tepër, grantet e dhëna për blerjet e vaksinave mund të përdoren gjithashtu nga partnerët e Ballkanit Perëndimor për të mbuluar kostot e kërkesave teknike për t'u harmonizuar plotësisht me sistemin e certifikatave digjitale COVID të BE-së. Republika e Maqedonisë së Veriut e ka kryer këtë harmonizim në gusht dhe

¹ COM (2020) 641 final

² Kjo përfshin rialokimet nga Instrumenti për Asistencën e Para-Aderimit prej 41.46 milionë euro mbështetje të menjëhershme, 88 milionë euro për mbështetjen e shëndetësisë, duke përfshirë 70 milionë euro për të siguruar disponueshmërinë dhe qasjen në vaksina të besueshme, efektive dhe të autorizuara nga BE-ja kundër COVID-19, 761.5 milionë euro për të mbështetur rimëkëmbjen nga ndikimi social dhe ekonomik i krizës, si dhe 750 milionë euro ndihmë makro-financiare dhe një paketë ndihme prej 1.7 miliardë euro nga Banka Evropiane e Investimeve.

Republika e Shqipërisë në fillim të shtatorit. Pjesëmarrja në sistemin e certifikatave digjitale COVID e BE-së do të lehtësojë udhëtimin ndërmjet Ballkanit Perëndimor dhe BE-së dhe do të ndihmojë më tej rajonin në zbutjen e ndikimit ekonomik dhe social të pandemisë.

Për të bashkëpunuar dhe treguar solidaritet me Turqinë lidhur me pandeminë COVID-19, **masat e para të reagimit të financuara nga BE** u nisën menjëherë pas shpërthimit të virusit. Deri më tani, Bashkimi Evropian ka mobilizuar mbi 105 milionë euro në fondet e BE-së për parandalimin dhe trajtimin e COVID-19, si dhe për zbutjen e ndikimit ekonomik dhe social. Në veçanti, në kuadër të Ndihmës për Refugjatët, rreth 64 milionë euro u mobilizuan për t'iu përgjigjur nevojave të refugjatëve lidhur me COVID-19. Turqia ishte ndër vendet e para që u përfshi në sistemin e certifikatave digjitale COVID të BE-së, duke mundësuar njohje reciproke të certifikatës në BE dhe në Turqi. Në gusht 2021, Turqia aktivizoi Mekanizmin për Mbrojtje Civile të BE-së duke kërkuar avionë për të ndihmuar në luftimin e zjarreve që shpërthyen në rajonet bregdetare të Egjeut dhe Mesdheut.

Pasqyrë e zhvillimeve kryesore

Mali i Zi dhe **Serbia** ranë dakord të zbatojnë metodologjinë e rishikuar të vitit 2020 të përcaktuar në komunikatën e Komisionit 'Përmirësimi i procesit të anëtarësimit - Një perspektivë e besueshme e BE-së për Ballkanin Perëndimor'³. Kjo marrëveshje u miratua në konferencat e para politike ndërqeveritare të mbajtura me këto vende më 22 qershor 2021 dhe tregoi përkushtimin e BE-së për të bërë progres në negociatat e tyre të anëtarësimit. Konferenca e parë ndërqeveritare me Malin e Zi sipas metodologjisë së rishikuar siguroi një drejtim politik për përshpejtimin e punës për të përmbushur pikat referente të përkohshme të sundimit të ligjit – pika referente e ardhshme e nevojshme për të avancuar në negociatat e anëtarësimit. Konferenca e parë ndërqeveritare me Serbinë sipas metodologjisë së rishikuar përcaktoi rrugën drejt hapjes së grupimeve bazuar në progresin e pritur nga vendi, veçanërisht në reformat e sundimit të ligjit.

Në përputhje me metodologjinë e rishikuar, në konkluzionet dhe rekomandimet e kësaj komunikate, Komisioni vlerëson bilancin e përgjithshëm në negociatat e anëtarësimit me Malin e Zi dhe Serbinë dhe propozon rrugën përpara për secilin vend. Konferencat e ardhshme ndërqeveritare duhet të zhvillohen pas publikimit të paketës aktuale vjetore të raporteve dhe konkluzioneve pasuese të Këshillit. Në varësi të marrëveshjes në Këshill, këto konferenca do të ofrojnë një forum për hapjen e grupimeve, për dialogun politik mbi reformat, për vlerësimin e procesit të përgjithshëm të anëtarësimit dhe planifikimin për vitin e ardhshëm, duke përfshirë hapjen dhe mbylljen e grupimeve dhe kapitujve të mëtejshëm dhe masat e mundshme korrigjuese.

Sa i përket kornizës së negociatave me **Maqedoninë e Veriut** dhe **Shqipërinë**, është thelbësore që vendet anëtare të BE-së të përfundojnë diskutimet pa vonesa të mëtejshme dhe që konferencat e para ndërqeveritare me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut të mbahen sa më shpejt të jetë e mundur nën Presidencën Sllovene. Maqedonia e Veriut ka mbajtur një ritëm të qëndrueshëm dhe të vendosur në zbatimin e reformave të BE-së, veçanërisht në fushat kyçe si sundimi i ligjit, duke përfshirë luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Vendi vazhdon të plotësojë kushtet për mbajtjen e konferencës së parë ndërqeveritare. Çështjet e mbetura dypalëshe ndërmjet Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut duhet të zgjidhen si çështje prioritare. Progresi i Shqipërisë në reformën zgjedhore dhe vazhdimi i rezultateve të mira në zbatimin e reformave kyçe për sundimin e ligjit kanë mbështetur vlerësimin e Komisionit se vendi ka përmbushur kushtet për mbajtjen e konferencës së parë ndërqeveritare të negociatave të anëtarësimit. Vonesat në nisjen zyrtare të negociatave të anëtarësimit po ndikojnë negativisht në kredibilitetin e BE-së.

³ COM(2020) 57 finale

Opinionin e Komisionit për aplikimin e **Bosnjës dhe Hercegovinës** për anëtarësim në Bashkimin Evropian⁴ identifikoi 14 prioritete kyçe që Bosnja dhe Hercegovina duhet të përmbushë në mënyrë që Komisioni të rekomandojë hapjen e negociatave të pranimit në BE. Këshilli miratoi 14 prioritete kryesore në dhjetor 2019. Bosnja dhe Hercegovina duhet të ofrojë një masë kritike të reformave drejt përmbushjes së 14 prioriteteve kyçe përpara se Komisioni të shqyrtojë rekomandimin e vendit për statusin e kandidatit.

BE-ja ka vazhduar të mbështesë zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me **Kosovën***. Propozimi i Komisionit për heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës është ende në pritje në Këshill dhe duhet të trajtohet si çështje urgjente. Komisioni vazhdon të vlerësojë se **Kosova** ka përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara nga Këshilli lidhur me liberalizimin e vizave.

Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor fokusohet në tejkalimin e hendekut socio-ekonomik ndërmjet rajonit dhe BE-së. Ai i ofron rajonit asistencë përmes investimeve dhe nismave politike në fushat e transportit, energjisë, tranzicionit digjital, agjendës së gjelbër, mbështetjes për sektorin privat, integritit ekonomik, inovacionit dhe mbështetjes për zhvillimin e kapitalit njerëzor. Ai njeh rolin kyç të sundimit të ligjit si një gurthemel i zhvillimit të qëndrueshëm dhe nënvizon se, së bashku me reformat strukturore ekonomike, progresi në fushat kyçe duhet të vazhdojë përgjatë zbatimit të nismave kryesore.

Për të zbatuar planin, BE-ja po mobilizon deri në 9 miliardë euro të financimit të IPA III në 2021-2027, duke përfshirë deri në 1 miliard euro për krijimin e Instrumentit të Garancisë për Ballkanin Perëndimor, që pritet të grumbullojë kapital për rreth 20 miliardë euro në investime në dekadën e ardhshme. Një fokus i vazhdueshëm në marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimin rajonal do të jetë i nevojshëm për të arritur objektivat e Planit.

Komisioni vazhdoi të zbatojë **Strategjinë për Ballkanin Perëndimor**⁵ dhe Agjendën Prioritare të miratuar në Samitin ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor në Sofje në maj 2018⁶. Shumica e veprimeve të planifikuara tani janë në përfundim e sipër, ose janë përfunduar. Në veçanti, janë duke u zhvilluar projekte që synojnë të masin performancën e sistemeve të drejtësisë të vendeve të Ballkanit Perëndimor, si dhe të monitorojnë gjykimet e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimin të organizuar. Për më tepër, vendet e Ballkanit Perëndimor tani janë të lidhura ngushtë me punën e agjencive të BE-së në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme. Bashkëpunimi i strukturuar me BE-në lidhur me migracionin dhe çështjet e sigurisë është i vazhdueshëm, veçanërisht në luftën kundër terrorizmit, parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe krimin të organizuar. Megjithatë, një sërë rekomandimesh relevante në lidhje me reformat e sundimit të ligjit në të gjithë rajonin mbeten për t'u adresuar dhe për t'u dhënë prioritet.

Rajoni ka përfunduar të gjitha veprimet në Planin e Veprimit të Zonës Ekonomike Rajonale dhe, në Samitin e Procesit të Berlinit në Sofje në nëntor 2020 u dakordua një plan ambicioz pasues për të krijuar një treg të përbashkët rajonal. Ky **Treg i përbashkët rajonal** - një shembull i bashkëpunimit rajonal gjithëpërfshirës - do të jetë vendimtar në rritjen e atraktivitetit dhe konkurrueshmërisë së të gjithë rajonit, në përshpejtimin e rimëkëmbjes pas pandemisë, veçanërisht për të tërhequr investitorët që kërkojnë diversifikim të furnizimit dhe zinxhirë më të shkurtër vlerash, si dhe në maksimizimin e përfitimeve të investimeve në infrastrukturën e konektivitetit. Prandaj është e rëndësishme që të gjitha palët të luajnë një rol

⁴ [COM\(2019\) 261 final](#)

* Ky emërtim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

⁵ COM(2020) 57 finale

⁶ [sofia-declaration_en.pdf \(europa.eu\)](#)

konstruktiv në ndërtimin e Tregut të Përbashkët Rajonal dhe përbushjen e angazhimeve të tyre të përbashkëta për të mirën e njerëzve dhe biznesit në rajon.

Ndryshimet e natyrës së punës, transformimet digjitale dhe të gjelbra dhe pandemia COVID-19 kanë një ndikim shumë të drejtpërdrejtë në jetën e njerëzve dhe po ndikojnë në strukturën socio-ekonomike të rajonit. Për të përqafuar mundësitë dhe për të minimizuar implikimet e mundshme negative të këtyre sfidave, është thelbësore që partnerët e Ballkanit Perëndimor të ruajnë **stabilitetin makro-fiskal dhe të zbatojnë reforma strukturore** për të adresuar dobësitë e identifikuara në ekonomitë e tyre dhe për të ndihmuar shoqëritë e tyre të bëhen më rezilente. Për këtë arsye zbatimi i reformave të përcaktuara në **Programet e Reformës Ekonomike (PRE)** dhe në udhëzimet e politikave të miratuara së bashku me Shtetet Anëtare të BE-së⁷ është thelbësor jo vetëm për të përmirësuar konkurrueshmërinë, për të nxitur krijimin e vendeve të punës dhe për të lehtësuar përfshirjen sociale, por gjithashtu për të garantuar qëndrueshmëri fiskale dhe për të përbushur kriteret ekonomike në procesin e anëtarësimit dhe për të maksimizuar ndikimin e mundshëm të paketës së investimeve të BE-së.

Turqia është një vend kandidat dhe partner kyç për BE-në në fusha thelbësore me interes të përbashkët, si migrimi, kundër-terrorizmi, ekonomia, tregtia, energjia dhe transporti.

Në vitin 2021 dialogu dhe bashkëpunimi me Turqinë janë rritur. Komunikata e Përbashkët mbi ‘Gjendjen e marrëdhënieve politike, ekonomike dhe tregtare BE-Turqi’⁸ është dorëzuar nga Përfaqësuesi i Lartë dhe Komisioni në Këshillin Evropian më 20 mars 2021. Mbi këtë bazë, krerët e BE-së kanë vendosur që Bashkimi Evropian është i gatshëm të angazhohet me Turqinë në një mënyrë me faza, proporcionale dhe të kthyeshme për të rritur bashkëpunimin në një sërë fushash me interes të përbashkët, me kusht që de-eskalimi aktual të jetë i qëndrueshëm dhe që Turqia të angazhohet në mënyrë konstruktive dhe në varësi të kushteve të vendosura, të përcaktuara në konkluzionet e fundit të Këshillit Evropian. Në këtë kontekst u zhvilluan dialogje të nivelit të lartë për klimën, migracionin dhe sigurinë, në mënyrë që të pasohet së shpejti me dialogun për shëndetin. Këshilli Evropian përsëriti interesin strategjik të BE-së për një mjedis të qëndrueshëm dhe të sigurt në Mesdheun Lindor dhe në zhvillimin e një marrëdhënieje bashkëpunuese dhe reciprokisht të dobishme me Turqinë. Në të njëjtën kohë, krerët e BE-së riafirmuan angazhimin e tyre për të mbrojtur interesat e BE-së dhe ato të shteteve anëtare të BE-së.

Deklarata BE-Turqi e marsit 2016 vazhdoi të jepte rezultate dhe mbeti korniza kryesore për bashkëpunimin mbi migracionin. Turqia vazhdoi përpjekjet e saj shumë të lavdërueshme për të pritur rreth katër milionë refugjatë nga Siria dhe vende të tjera, në atë që është komuniteti më i madh i refugjatëve në botë. Megjithatë, u ngritën probleme në lidhje me zbatimin e Deklaratës për shkak të pezullimit të njëanshëm të Turqisë të kthimit të migrantëve të parregullt dhe azilkërkuesve të refuzuar nga ishujt grekë nga marsi 2020 e në vazhdim dhe shfaqja e rrugëve alternative të kontrabandës drejt Qipros dhe Italisë. Turqia gjithashtu vazhdoi të kërkojë një përditësim të Deklaratës së marsit 2016. Në përgjithësi, numri i kalimeve të paligjshme kufitare midis Turqisë dhe BE-së mbeti ende dukshëm më i ulët se përpara miratimit të Deklaratës BE-Turqi.

BE-ja vazhdoi të qëndrojë pranë angazhimit të saj për të ofruar mbështetje të konsiderueshme financiare për refugjatët dhe të presë komunitetet në Turqi. Mekanizmi për Refugjatë në Turqi ka mobilizuar 6 miliardë euro. Buxheti i plotë operacional i saj u kontraktua në fund të vitit 2020, me mbi 4.2 miliardë euro të disbursuara deri në gusht 2021, përmes mbi 100 projekteve. Arritjet e tij përfshinin ndihmën për 1.8 milionë refugjatë në plotësimin e nevojave të tyre

⁷ [st08101-en20.pdf \(europa.eu\)](#)

⁸ JOIN (2021) 8 finale/2

themelore, ndihmën për 700 000 fëmijë refugjatë për të shkuar në shkollë, ndërtimin e 363 shkollave dhe ofrimin e mbi 18 000 000 konsultimeve të kujdesit shëndetësor parësor. Në qershor, Komisioni propozoi të ndahet një paketë shtesë prej 3 miliardë euro që mbulon periudhën 2021-2023, përveç 0.5 miliardë eurove në financimin humanitar lidhës të vënë në dispozicion në vitin 2020. Kjo do të përfshijë financimin për menaxhimin e migracionit dhe kontrollin e kufijve, veçanërisht në kufirin lindor të Turqisë. Situata e refugjatëve në rajon do të mbetet kritike apo edhe e përkeqësuar, e rënduar nga COVID-19 dhe vështirësitë ekonomike të mëvonshme. Flukset e migrimin nga pjesë të tjera të rajonit, duke përfshirë Afganistanin, mund të çojnë në nevoja shtesë. Turqia megjithatë nuk është zbrapsur nga trendi negativ i largimit të mëtutjeshëm nga Bashkimi Evropian, me **ngecje të madhe në fushën e demokracisë, sundimit të ligjit, të drejtave themelore dhe pavarësisë së gjyqësorit**. Krerët e BE-së kanë theksuar se shënjestrimi i partive politike, mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe medias përfaqëson pengesa të mëdha për të drejtat e njeriut dhe bie ndesh me detyrimet e Turqisë për të respektuar demokracinë, sundimin e ligjit dhe të drejtat e grave. Dialogu për çështje të tilla mbetet pjesë integrale e marrëdhënieve BE-Turqi.

Si BE-ja ashtu edhe Turqia vazhdojnë të përfitojnë nga **Unioni Doganor**. Vëllimi i tregtisë dypalëshe u rrit dhe pesha relative e BE-së në tregtinë e jashtme të Turqisë u rrit pak. Megjithatë, Turqia nuk ka trajtuar një sërë irritues tregtarë që pengojnë funksionimin normal të Unionit Doganor, pavarësisht angazhimit të intensifikuar të Komisionit. **Politika e jashtme** gjithnjë e më e vendosur e Turqisë vazhdoi të ishte në kundërshtim me prioritetet e BE-së në kuadër të Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë dhe interesave më të gjera të BE-së, veçanërisht për shkak të ndërhyrjeve dhe mbështetjes së saj për veprimet ushtarake në shumicën e konflikteve rajonale përreth. Në qershor 2021, krerët e BE-së përmendën se në përputhje me interesin e përbashkët të BE-së dhe Turqisë për paqen dhe stabilitetin rajonal, Këshilli Evropian pret që Turqia dhe të gjithë akterët të kontribuojnë pozitivisht në zgjidhjen e krizave rajonale.

Ndjekja e dialogut me mirëbesim dhe abstenimi nga veprimet e njëanshme, të cilat bien ndesh me interesat e BE-së dhe shkelin ligjin ndërkombëtar dhe të drejtat sovraane të shteteve anëtare të BE-së, janë kërkesa absolute për të siguruar një mjedis të qëndrueshëm dhe të sigurt në Mesdheun Lindor dhe në zhvillimin e një marrëdhënie bashkëpunuese dhe reciprokisht të dobishme ndërmjet BE-së dhe Turqisë. Të gjitha mosmarrëveshjet duhet të zgjidhen përmes dialogut paqësor dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

BE-ja dënoi fuqishëm hapat e njëanshëm të Turqisë dhe njoftimet e bëra nga Presidenti i Turqisë dhe udhëheqësi i komunitetit turk-qipriot më 20 korrik 2021 në lidhje me rihapjen e mëtejshme të qytetit të rrethuar me gardh të Varoshës në Qipro. BE-ja bëri thirrje për anulimin e menjëhershëm të të gjitha hapave të ndërmarra në Varosha që nga tetori 2020.

Mbështetja financiare e BE-së i ndihmon vendeve kandidate dhe vendeve kandidate potencial që të miratojnë dhe zbatojnë reformat e nevojshme politike, institucionale, ligjore, administrative, sociale dhe ekonomike për të qenë në përputhje me vlerat e BE-së dhe për t'u përfruar në mënyrë progresive me rregullat, standardet, politikat dhe praktikën e BE-së me synim anëtarësimin në BE, duke kontribuar kështu në stabilitetin, sigurinë dhe prosperitetin e tyre.

Në qershor 2021, u arrit një marrëveshje politike midis Këshillit dhe Parlamentit Evropian mbi propozimin e Komisionit për një **Rregullore mbi Instrumentin për Asistencën e Para-Aderimit (IPA III)**. Rregullorja është miratuar më 15 shtator 2021⁹. Plotësimi i kornizës ligjore do të mundësojë fillimin e zbatimit të Planit Ekonomik dhe Investimeve për Ballkanin Perëndimor, një mjet crucial për rimëkëmbjen e rajonit.

⁹ Gazeta Zyrtare L 330, 20.9.2021

IPA III merr një qasje solide të drejtuar nga politika, që përfshin një shpërndarje strategjike dhe dinamike të asistencës dhe në thelb të saj vendos kërkesat themelore për anëtarësim. Duke fokusuar ndihmën financiare të BE-së në prioritetet kryesore, IPA III do të ofrojë mbështetje edhe më të madhe për reformat, duke nxitur kështu zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik dhe duke i afruar partnerët me BE-në. Në përputhje me marrëveshjen politike të arritur ndërmjet Këshillit dhe Parlamentit në qershor, IPA III forcon kushtëzimin në lidhje me demokracinë, të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit.

II. BAZAT E PROCESIT TË ADERIMIT

Reformat themelore në sundimin e ligjit, ekonominë dhe funksionimin e institucioneve demokratike, si dhe të administratës publike mbeten kryesore për përgatitjen e vendeve kandidatë dhe kandidatëve potencialë për të përmbushur kërkesat e anëtarësimit. Kapaciteti dhe vullneti politik i vendeve të zgjerimit për t'u fokusuar dhe shtyrë përpara këto reforma është thelbësore për integrimin e tyre në BE. Prandaj është thelbësore që progresi të jetë i fuqishëm, i prekshëm dhe i pakthyeshëm.

Në vazhden e pandemisë COVID-19, qeveritë e Ballkanit Perëndimor dhe Turqia vazhduan të vendosin kufizime që synojnë mbrojtjen e shëndetit publik. Parlamentet në Ballkanin Perëndimor vazhduan të funksionojnë, në disa raste me kufizime përkatëse. Liria e tubimit shpesh kufizohej për arsye të shëndetit publik, në disa raste kundër rekomandimeve të Avokatit të popullit; gjithashtu janë kufizuar të drejta të tjera themelore. Pandemia në disa raste ndikoi në efikasitetin dhe transparencën e procedurave gjyqësore. Masat emergjente të marra në kontekstin e pandemisë COVID-19 duhet të jenë proporcionale, të kufizuara në atë që është e nevojshme dhe e kufizuara në kohë, në mënyrë që të respektohen sundimi i ligjit dhe standardet demokratike dhe të të drejtave të njeriut.

Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Mbrojtja gjyqësore efektive nga gjykatat e pavarura dhe të paanshme është një gur themel i sundimit të ligjit. Në të gjithë Ballkanin Perëndimor, institucionet gjyqësore vazhdojnë të përballen me shumë sfida. Rreziqet e presionit të padrejtë mbi gjyqësorin dëmtojnë ekuilibrin e përgjithshëm institucional dhe ndarjen e pushteteve, gjë që në fund cenon parimin e barazisë para ligjit. Vendosmëria dhe përkushtimi i vazhdueshëm nga nivelet më të larta të qeverisë dhe të gjithë akterët përkatës është thelbësor për reformat e suksesshme në drejtësi. Masat vendimtare për të forcuar pavarësinë, cilësinë dhe efektivitetin e sistemeve gjyqësore të partnerëve të Ballkanit Perëndimor, të mbështetur nga një regjistër i rasteve të qëndrueshëm afatgjatë, janë thelbësore për progresin e mëtejshëm në procesin e anëtarësimit.

Shqipëria ka bërë progres të mirë të vazhdueshëm në reformën e saj gjithëpërfshirëse në drejtësi, duke përfshirë rezultate të prekshme në procesin e verifikimit. Gjykata Kushtetuese tashmë është plotësisht funksionale dhe ka nisur të gjykojë çështje të rëndësishme. **Maqedonia e Veriut** ka bërë progres të lehtë, për shembull në zbatimin e strategjisë së saj gjyqësore. **Serbia** dhe **Kosova** kanë bërë progres të kufizuar në avancimin e reformave të tyre gjyqësore. Në **Serbi**, ka një zotim të ripërtërirë për reforma, me plane për të forcuar pavarësinë e gjyqësorit, duke përfshirë ndryshimet kushtetuese, të cilat është planifikuar të finalizohen deri në fund të vitit 2021. Në **Kosovë**, kapaciteti i përgjithshëm i institucioneve gjyqësore për të ndjekur penalisht dhe gjykuar rastet shpejt dhe në mënyrë efektive mbetet i dobët. **Mali i Zi** dhe **Bosnja dhe Hercegovina** nuk kanë bërë progres në reformat e tyre gjyqësore. Në **Mal të Zi**, reformat kyçe në drejtësi po stagnojnë, dhe për të zhbllokuar progresin drejt përmbushjes së pikave referente të përkohshme të sundimit të ligjit duhet një angazhim politik vendimtar në të gjitha nivelet e qeverisë, parlamentit dhe gjyqësorit. **Bosnja**

dhe Hercegovinë është duke stagnuar, pa progres në forcimin e gjyqësorit; në mungesë të veprimeve domethënëse, integriteti i përgjithshëm i sektorit vazhdoi të përkeqësohej.

Turqia vazhdoi me ngecje të mëdha që është vërejtur viteve të fundit. Ajo nuk e ka trajtuar çështjen kyçe të mungesës sistematike të pavarësisë së gjyqësorit. Presioni politik mbi gjyqtarët dhe prokurorët vazhdoi, duke minuar më tej pavarësinë dhe cilësinë e përgjithshme të gjyqësorit. Shkarkimet në shkallë të gjerë të gjyqtarëve dhe prokurorëve vazhduan të dobësonin efikasitetin dhe profesionalizmin e sistemit gjyqësor. Refuzimi i Turqisë për të zbatuar të gjitha vendimet përkatëse të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut ka rritur më tej shqetësimet në lidhje me respektimin e Turqisë ndaj standardeve ndërkombëtare dhe evropiane. Autoritetet turke duhet të trajtojnë urgjentisht mangësitë serioze, veçanërisht në lidhje me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe respektimin e rreptë të parimit të prezumimit të pafajësisë.

Korrupsioni në Ballkanin Perëndimor si dhe në Turqi vazhdon të jetë i përhapur. Për më tepër, disa dobësi ndaj korrupsionit janë përkeqësuar nga pandemia. Përpjekje dhe rezultate të fuqishme në luftën kundër korrupsionit nevojiten për të zbutur kërcënimet ndaj qeverisjes demokratike, për sigurinë ligjore dhe ekonomike dhe për të siguruar një mjedis të qëndrueshëm dhe transparent biznesi. Suksesi në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dallon nëpërmjet vendeve të zgjerimit, me progres të vazhdueshëm në disa fusha dhe ngecje të qarta në disa të tjera. Prokurimi publik mbetet veçanërisht i cenueshëm ndaj korrupsionit. Mekanizmat e kontrollit gjatë gjithë procesit të prokurimit duhet të forcohen dhe transparencja dhe llogaridhënia duhet të rriten ndjeshëm me masa më të fuqishme dhe ambicioze. Vlerësimet e rrezikut të korrupsionit dhe masat për të luftuar korrupsionin nuk bëhen sistematikisht për sektorët më të rrezikuar. Në të gjithë bordin, nevojiten shumë më shumë përpjekje dhe vullnet i qartë politik për të zhvilluar një regjistër të rasteve të besueshëm dhe solid të hetimit dhe ndjekjes penale të rasteve të korrupsionit, veçanërisht në nivel të lartë, dhe për të siguruar sekuestrimin dhe konfiskimin e duhur të aseteve kriminale.

Në **Shqipëri** vetingu i gjyqësorit dhe krijimi i Strukturave të Specializuara Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar janë duke dhënë rezultate në luftën kundër korrupsionit. **Maqedonia e Veriut** ka forcuar kornizën e saj strategjike dhe institucionale dhe ka konsoliduar regjistrin e saj rasteve të hetimit, ndjekjes penale dhe gjyqimit të disa rasteve të korrupsionit, përfshirë atë në nivel të lartë. Progresi në **Kosovë, Mal të Zi** dhe **Serbi** ishte i kufizuar. Ndërsa Agjencia Kundër Korrupsionit e Malit të Zi pati një qasje më proaktive, vendi duhet të shtojë përpjekjet për parandalimin dhe shtypjen e korrupsionit, si dhe për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive. Kosova ka rritur kapacitetin e Prokurorisë së saj Speciale, por nevojiten ende përpjekje të vazhdueshme për hetime proaktive, vendime gjyqësore përfundimtare dhe konfiskim përfundimtar të aseteve. Në **Serbi** u forcua kapaciteti i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, por nuk u ndërmorr asnjë hap konkret për miratimin e një strategjie të re kundër korrupsionit të mbështetur nga një plan veprimi i besueshëm dhe realist dhe shumica e rekomandimeve të GRECO mbeten pezull. **Bosnja dhe Hercegovina** nuk bëri fare progres për të trajtuar korrupsionin e përhapur dhe shenjat e kapjes politike. Kornizat legjislative dhe institucionale mbeten të papërshtatshme dhe tepër të fragmentuara. Në **Turqi** nuk ka pasur fare progres. Korniza e saj ligjore dhe institucionale kundër korrupsionit mbeten nën standardet ndërkombëtare dhe mundësojnë ndikim të padrejtë politik në hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit. Llogaridhënia dhe transparencja e institucioneve publike duhet të përmirësohet. Mungesa e një strategjie kundër korrupsionit tregon mungesë vullneti për të luftuar korrupsionin.

Të drejtat themelore janë të mbrojtura në masë të madhe në legjislacionin në Ballkanin Perëndimor, por sfidat mbeten në sigurimin e zbatimit efektiv të tyre. Mbrojtja e të drejtave themelore nga gjykatat mbetet e pamjaftueshme në një sërë fusha të politikave. Në përgjithësi, ka pasur zhvillime të kufizuara apo edhe stagnim në këtë fushë në pjesën më të madhe të

rajonit. Shqetësimet dhe rekomandimet e raporteve të mëparshme të vendit janë adresuar vetëm në një shkallë të kufizuar. Në Turqi, situata e të drejtave të njeriut u përkeqësua më tej dhe mbetet një shqetësim serioz.

Liria e shprehjes, liria e medias dhe pluralizmi janë shtyllat kryesore të një shoqërie demokratike dhe duhet të mbështeten. Në Ballkanin Perëndimor, ka pasur progres të kufizuar ose nuk ka pasur fare progres në këtë drejtim. Megjithëse peizazhi mediatik në përgjithësi lejon lirinë e shprehjes, janë kërcënimet, frikësimi dhe dhuna ndaj gazetarëve, si dhe fjalët nënçmuese nga zyrtarët publikë ato të cilat vazhdojnë të shkaktojnë shqetësim serioz. Këto mund të kenë një efekt ftohës në ushtrimin e lirisë së medias dhe ritmi i hetimeve dhe ndjekja penale për incidente të tilla duhet të rritet. Pavarësia e rregullatorëve të medias dhe transmetuesve publikë duhet të garantohet, duke përfshirë financimin e duhur dhe emërimet e bazuara në meritë në strukturat menaxhuese. Funksionimi efektiv i organeve të pavarura vetërregulluese gjithashtu duhet të mbështetet më tej. Të gjitha vendet në rajon duhet të rrisin transparencën në financimin e medias dhe në lidhjet midis interesave publike dhe private që ndikojnë në linjat editoriale dhe çojnë në autocensurë.

Ngecje e madhe vazhdoi në Turqi, ku ushtrimi i lirisë së shprehjes dhe shpërndarja e zërit të opozitës mbeten mjaft të kufizuara. Indimidimi i medias vazhdoi përmes rasteve penale dhe dënimeve të gazetarëve, mbrojtësve të të drejtave të njeriut, avokatëve, shkrimtarëve, politikanëve të opozitës, studentëve dhe përdoruesve të mediave sociale.

Partnerët e Ballkanit Perëndimor duhet të demonstrojnë se po vazhdojnë përpjekjet për të promovuar dhe forcuar **barazinë gjinore** dhe për të trajtuar dhunën me bazë gjinore. Në Turqi janë shtuar shqetësimet në këtë drejtim, ku ka pasur një reagim kundër të drejtave të grave, siç dëshmohet nga tërheqja e vendit nga Konventa e Stambollit.

Ligjet dhe politikat për **mosdiskriminimin** në përgjithësi janë në fuqi, por nuk ka përcjellje të mjaftueshme për rastet e diskriminimit, krimin të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes. Mbrojtja ligjore për të drejtat e **personave lezbikë, homoseksualë, biseksualë, transgjinerë, interseksual dhe queer (LGBTIQ)** është përmirësuar në shumicën e partnerëve të Ballkanit Perëndimor, por ligjet duhet të respektohen në praktikë, pasi diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes mbeten të shpeshta. Në Turqi, mbrojtja e të drejtave themelore të personave LGBTIQ, gjuha e urrejtjes dhe fushatat e shpifjeve kundër komunitetit LGBTIQ janë ende një çështje shqetësuese.

Fëmijët, veçanërisht ata në situata vulnerabël, janë prekur nga mbyllja e shkollave dhe kufizimet e tjera të vendosura nga kriza COVID-19. Nevojiten përpjekje për të forcuar **të drejtat e fëmijës** dhe për të ndërtuar sisteme reziliente për mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve. Sistemet e drejtësisë të përshtatshme (miqësore) për fëmijët duhet të zhvillohen plotësisht, dhe alternativat e paraburgimit duhet të vihen në dispozicion dhe të përdoren në mënyrë më sistematike, ku paraburgimi të përdoret vetëm si masë e fundit.

Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara duhet të mbrohen në mënyrë efektive, duke përfshirë kalimin e tyre drejt kujdesit të bazuar në komunitet dhe jetesës së pavarur, në përputhje me kërkesat e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Mbrojtja e **pakicave** dhe pjesëmarrja e tyre në jetën publike gjithashtu kërkon vëmendje të vazhdueshme. Romët vazhdojnë të jenë të pafavorizuar në krahasim me fqinjët e tyre jo-romë dhe romët e cenusur u prekën në mënyrë disproporcionale nga kriza COVID-19 dhe masat kufizuese.

Qeveritë në rajon duhet të adresojnë të gjitha rekomandimet e organeve ndërkombëtare dhe rajonale të monitorimit të të drejtave të njeriut, përfshirë ato për **kushtet e burgjeve** dhe parandalimin e keqtrajtimit.

Drejtësia, liria dhe siguria

Krimi i organizuar vazhdon të jetë një kërcënim për rajonin, duke prekur njerëzit, bizneset, institucionet shtetërore dhe ekonominë në tërësi. Organizatat e fuqishme kriminale me shtrirje globale operojnë lehtësisht përtej kufijve, duke përfshirë edhe BE-në. Organizatat kriminale aktive në Ballkanin Perëndimor janë treguar shumë të afta në shfrytëzimin e evolucionit të pandemisë COVID-19. Përgjigjet e qeverive kanë përfshirë rritjen e bashkëpunimit operacional policor me BE-në, veçanërisht përmes platformës EMPACT¹⁰ dhe me Agjencitë e BE-së në fusha të tilla si kontrabanda e drogës (veçanërisht kanabisi dhe drogat sintetike), kontrabanda e migrantëve, trafikimi i qenieve njerëzore, krimi i organizuar i pronës, kontrabanda e mallrave të akcizës (kryesisht cigare) dhe armëve të zjarrit. Strategjia e re e BE-së për të trajtuar krimin e organizuar 2021-2025¹¹ konfirmoi angazhimin e BE-së për të vazhduar prioritizimin e projekteve të ndërtimit të kapaciteteve në vendet e treta, duke përfshirë vendet e zgjerimit. Qëllimi është të mbështesë bashkëpunimin operacional dhe të ndihmojë në pajisjen e partnerëve me mjete që i mundësojnë atyre çrrënjosjen e strukturave komplekse kriminale.

Progres i mirë po bëhet në trajtimin e posedimit, keqpërdorimit dhe trafikimit të paligjshëm të armëve të vogla dhe të lehta në përputhje me planin e veprimit të BE-së për trafikimin e armëve të zjarrit 2020-2025. Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për përafrim ligjor me acqius të BE-së dhe marrëveshje ndërkombëtare, forcim i sigurisë kufitare dhe kapaciteteve për hetime lidhur me armët e zjarrit, rritje e efektivitetit të sistemeve gjyqësore në lidhje me krimet lidhur me armët e zjarrit, lehtësim i mëtejshëm i bashkëpunimit operacional dhe shkëmbimit të informatave ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit, reduktim i mbajtjes pa leje të armëve të zjarrit dhe zvogëlim të rrezikut të shumimit dhe diversionit të armëve të zjarrit, municionit dhe eksplozivëve.

Gjithashtu kanë vijuar investimet në strukturat për luftimin e krimin të organizuar, duke çuar në forcimin e organeve të specializuara të gjyqësorit dhe policisë. Megjithatë, të dhënat mbi **dënimet përfundimtare** për krimin e organizuar tregojnë se kapaciteti i autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit për të hetuar, ndjekur penalisht dhe gjykuar me sukses raste të rëndësishme të krimin të organizuar, dhe për rrjedhojë për t'i kthyer mendjen autorëve potencial, mbetet i pamjaftueshëm. Kjo gjithashtu aplikohet edhe lidhur me luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, që nënkupton edhe ofrimin e mbrojtjes dhe mbështetjes për viktimat.

Në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, autoritetet duhet të gjejnë një përgjigje efektive për të parandaluar infiltrimin e krimin të organizuar në ekonomi. Gjithashtu nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përshpejtuar gjurmimin e aseteve që vijnë nga krimi me anë të hetimeve financiare dhe për të siguruar konfiskim dhe rikthim më efektiv të fitimeve kriminale. Përveç kësaj, agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të rrisin kapacitetin e tyre për të trajtuar shfaqjen e variacioneve të reja në aktivitete kriminale, në veçanti forma të ndryshme të kriminalitetit kibernetik. Bashkëpunimi për krimin kibernetik po rritet.

Shembuj pozitivë në rajon janë shënuar në **Shqipëri**, ku u arrit progres i mirë në bashkëpunimin ndërkombëtar policor që çoi në arrestime të figurave të profilit të lartë dhe në luftën kundër prodhimit dhe trafikimit të drogës. **Maqedonia e Veriut** ka shënuar progres të

¹⁰EMPACT (Platforma Multidisiplinare Evropiane kundër Kërcënimeve Kriminale) është një iniciativë e sigurisë e drejtuar nga Shtetet Anëtare të BE-së për të identifikuar, prioritarizuar dhe trajtuar kërcënimet që vijnë nga krimi i organizuar dhe i rëndë ndërkombëtar. EMPACT tani është një instrument i përhershëm, siç përcaktohet në [Konkluzionet e Këshillit për EMPACT 2022+](#). Në maj 2021, Këshilli miratoi [konkluzionet që përcaktojnë prioritetet EMPACT për ciklin e ardhshëm EMPACT](#) (Janar 2022 - Dhjetor 2025).

¹¹ Komunikimi mbi Strategjinë e BE-së për të luftuar krimin e organizuar 2021-2025, COM(2021) 170 final, 14.4.2021

lehtë në luftën kundër krimit të organizuar, duke përfshirë edhe atë në nivel operacional. **Mali i Zi** gjithashtu ka shënuar progres të lehtë në përmirësimin e qasjes së agjencive të zbatimit të ligjit në bazat kryesore të të dhënave dhe rritjen e numrit të hetuesve dhe ekspertëve në fushat kryesore. Për më tepër, bashkëpunimi i mirëvendosur ndërkombëtar policor vazhdoi të jepte rezultate, me konfiskim të paprecedentë droge. Megjithatë, **Kosova, Serbia dhe Turqia** shënuan progres të kufizuar në luftën kundër krimit të organizuar, kurse **Bosnja dhe Hercegovina** nuk shënoi fare progres, ku pika e kontaktit për bashkëpunim me Europolin nuk është ende funksionale.

Bashkëpunimi me Ballkanin Perëndimor për luftën **kundër terrorizmit** dhe parandalimin e radikalizimit vazhdon të jetë i një rëndësie kyçe. Ndërsa ideologjitë ekstreme fetare dhe politike mbeten të pranishme në rajon dhe rritja e forumeve të radikalizimit online në përgjithësi është shqetësuese, gjatë periudhës së raportimit nuk u raportuan incidente të natyrës ekstreme ose të dhunshme (terrorizëm, ekstremizëm, radikalizëm) dhe situata e sigurisë në rajon ka mbetur stabile.

Forumi Ministror BE-Ballkani Perëndimor për Drejtësi dhe Punë të Brendshme, i mbajtur në tetor 2020, përsëriti vlefshmërinë e Planit të Përbashkët të Veprimit (PPV) për luftën kundër terrorizmit për Ballkanin Perëndimor dhe ripohoi angazhimin për të zbatuar objektivat e tij përtej vitit 2020. Prandaj PPV-ja dhe aranzhimet zbatuese përkatëse, mbeten një kornizë për punën e përbashkët për parandalimin e radikalizimit që çon në ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm bazuar në pesë objektivat dhe të mbështetur nga bashkëpunimi i fortë rajonal. Ndërsa pandemia ka ngadalësuar zbatimin, në pjesën më të madhe të rajonit ka pasur progres të lehtë në zhvillimin e strategjive kundër terrorizmit, miratimin e legjislacionit përkatës, forcimin e kapaciteteve përkatëse institucionale dhe futjen e masave kundër radikalizimit, dhe progres i mëtijshëm është i nevojshëm për të siguruar zbatimin e plotë të objektivave dhe veprimeve të dakorduara. Në përgjithësi, nevojiten më shumë përpjekje për të parandaluar të gjitha format e radikalizimit, duke përfshirë ato të natyrës fetare, etno-nacionaliste ose politike.

Shqipëria miratoi një strategji të re kombëtare ndërsektoriale kundër terrorizmit dhe planin e veprimit në dhjetor 2020 dhe përmbushi detyrimet e saj në kuadër të PPV-së. Për luftën kundër pastrimit të parave, Shqipëria ka vazhduar të harmonizojë më tej legjislacionin e saj me acquis të BE-së. **Mali i Zi** po zbaton strategjinë e saj 2020-2024 për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm, me fokus të veçantë në qendrat e paraburgimit, me mbështetjen e shoqërisë civile. **Maqedonia e Veriut** vazhdon të zbatojë strategjinë kombëtare (2018-2022) për luftimin e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. **Bosnja dhe Hercegovinë** dhe **Serbia** do të përfitonin nga një qasje më strategjike kundër-terrorizmit. Strategjia e Bosnjës dhe Hercegovinës në këtë fushë ka skaduar, kështu që duhet miratuar dhe zbatuar një strategji vijuese për 2021-2025 që përputhet me politikën e BE-së, veçanërisht për parandalimin dhe kundërvënien e ekstremizmit të dhunshëm. Kjo do të kërkojë krijimin e strukturave më efektive kundër terrorizmit. Bosnja dhe Hercegovina ka nevojë për një ligj të ri kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në përputhje me standardet ligjore të BE-së (dmth. direktiva e katërt kundër pastrimit të parave). Në Serbi, legjislacioni kryesor kundër terrorizmit është ende në përgatitje. **Kosova** po planifikon të miratojë një strategji të re të përbashkët kundër-terrorizmit dhe trajtimin e ekstremizmit të dhunshëm. Ndërkohë që Ministri i Punëve të Brendshme mbetet Koordinator Kombëtar, ekziston nevoja për të rithemeluar një zyrë që mbështet koordinatorin dhe për të luajtur një rol më të fortë në koordinimin ndërinstitutional.

Disa partnerë në rajon (Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut) po riatdheshojnë sistematikisht **luftëtarët e huaj terroristë** dhe anëtarët e familjeve. Në pjesën më të madhe të Ballkanit Perëndimor, riatdheshimi i luftëtarëve të huaj terroristë që kthehen nga ish-zonat luftarake, dhe bërja bë shumë për riintegrimin dhe risocializimin e tyre efektiv dhe sistematik,

është një çështje shqetësuese. **Kosova** ka bërë progres të mirë në rehabilitimin dhe riintegrimin e luftëtarëve të huaj terroristë dhe familjeve të tyre, megjithëse ka shqetësime për lirim të parakohshëm me kusht nga burgu të kundërvajtësve të dhunshëm ekstremistë. Në të gjithë Ballkanin Perëndimor, monitorimi i masave të riintegritimit dhe risocializimit, duke përfshirë edhe burgjet, mbetet për t'u përmirësuar. Kjo përfshin veçanërisht bashkëpunimin ndërmjet institucioneve në nivel kombëtar dhe lokal. Shkëmbimi i informatave përmes Aplikacionit të Rrjetit të Shkëmbimit të Sigurt të Informacionit (SIENA) ka bërë progres të rëndësishëm. Partnerët e Ballkanit Perëndimor duhet të vazhdojnë të transmetojnë në mënyrë proaktive informacionin për kthimin e luftëtarëve të huaj terroristë dhe familjeve të tyre përmes kanaleve të duhura. **Mali i Zi** ka një shkëmbim të mirë informacioni me EUROPOL dhe EUROJUST lidhur me luftëtarët e huaj terroristë. **Maqedonia e Veriut** miratoi, në qershor 2020, një plan kombëtar për riintegrimin, risocializimin dhe rehabilitimin e luftëtarëve të huaj të kthyer dhe anëtarëve të familjeve të tyre.

Turqia vazhdon të përballet me kërcënime nga grupet terroriste. Ndërkohë që qeveria ka të drejtën dhe përgjegjësinë legjitime për të luftuar terrorizmin, korniza ligjore dhe përgjigja e saj duhet të sillen në përputhje me standardet e BE-së dhe *acquis* të BE-së. Masat kundër terrorizmit duhet të jenë proporcionale dhe të ndërmerren në përputhje me sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Turqia duhet të pushojë së përdoruri interpretimin e gjerë të ligjit të saj kundër terrorizmit për të arrestuar dhe mbajtur në paraburgim gazetarë, shkrimtarë, avokatë, politikanë, akademikë, mbrojtës të të drejtave të njeriut dhe zëra kritikë. Turqia priorizoi luftën kundër PKK-së, të cilën mbetën në listën e BE-së të personave, grupeve dhe entiteteve të përfshira në aktet e terrorizmit, dhe shpërbërjen e lëvizjes Guleniste. Turqia ka aftësi institucionale të zhvilluara mirë, por vazhdon të përballet me rreziqe të rënda të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Ndërsa ka bërë progres në forcimin e kornizës së saj kundër pastrimit të parave/kundër financimit të terrorizmit, rekomandimet e papërbushura të Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF) mbeten për t'u përbushur. Vendi duhet të zhvillojë një strategji gjithëpërfshirëse dhe plan veprimi për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Efektiviteti dhe afati kohor i mekanizmit të Turqisë për ngrirjen e aseteve u përmirësuan dhe vendi vazhdoi përpjekjet e tij për të luftuar celulat e terroristëve vendas dhe të huaj. Bashkëpunimi policor dhe gjyqësor me shtetet anëtare të BE-së dhe agjencitë e BE-së në luftën kundër terrorizmit mbeti i kufizuar për shkak të mungesës së një ligji kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale që përputhet me standardet evropiane dhe *acquis* të BE-së, si dhe për dallimet në përkufizimin dhe dënimet për veprat penale terroriste. Turqia duhet të vazhdojë përpjekjet e saj për të parandaluar dhe luftuar në mënyrë efektive radikalizimin që çon në ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm, në përputhje të plotë me të drejtat themelore.

Kërcënimet hibride, duke përfshirë sulmet kibernetike dhe, mbi të gjitha, dezinformimin dhe keqinformimin kanë vazhduar të jenë një çështje serioze në vendet në zgjerim. Në rajonin e Ballkanit Perëndimor në veçanti, akterët shtetërorë dhe joshetërorë, duke përfshirë edhe jashtë rajonit, vazhduan të përhapin dezinformata për të sfiduar besueshmërinë e BE-së, për të minuar besimin e publikut në institucionet demokratike dhe për të thelluar polarizimin. Fushatat e dezinformimit dhe keqinformimit kanë qenë veçanërisht intensive gjatë pandemisë COVID-19, por edhe në prag të zgjedhjeve. Pjesa më e madhe e dezinformatave në rajon prodhohet dhe shpërndahet nga akterë vendas për qëllime të brendshme, megjithëse përfaqësuesit e shteteve të treta janë gjithashtu aktive.

Në përputhje me prioritetet e BE-së në kuadër të Kornizës së Përbashkët për përballimin e kërcënimeve hibride¹², Strategjinë e Ballkanit Perëndimor dhe Deklaratën e Zagrebit¹³, EEAS dhe Komisioni kanë thelluar dialogun e tyre të politikave me partnerët e zgjerimit për të luftuar kërcënimet hibride, veçanërisht për reziliencën kibernetike, mbrojtjen e infrastrukturës kritike, komunikimin strategjik dhe trajtimin e dezinformimit. Komunikimi strategjik vazhdoi të përqëndrohet në fushatat tematike të komunikimit që theksojnë përfitimet e mbështetjes së BE-së për qytetarët dhe për ekonomitë, dhe në veprimet e diplomacisë publike me kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët, veçanërisht të rinjtë, për të nxitur debatin për të ardhmen e përbashkët evropiane. Paralelisht, BE-ja vazhdoi të komunikojë zhvillimet politike dhe të politikave në marrëdhëniet BE-Ballkani Perëndimor përmes kanaleve të uebsajteve dhe mediave sociale. Promovimi i lirisë së shprehjes dhe gazetarisë së pavarur në rajonin e zgjerimit mbetet një prioritet, ndërsa ngritja e kapaciteteve të sigurisë kibernetike është një pjesë thelbësore e Agjendës Digjitale për Ballkanin Perëndimor,¹⁴ dhe një prioritet në strategjinë e re të BE-së për sigurinë kibernetike¹⁵.

Migrimi i parregullt vazhdoi të ishte një sfidë kryesore për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë. Bashkëpunimi u zhvillua më tej përgjatë rrugëve migratore të Mesdheut Lindor/Ballkanit Perëndimor. Kontrabanda e migrantëve, të miturve të pashoqëruar, trafikimi i qenieve njerëzore dhe kapaciteti i pamjaftueshëm i sistemeve kombëtare të azilit mbeten shqetësuese. Kriza në Afganistan mund të rezultojë në një rritje të mëtejshme të refugjatëve afganë dhe kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm të ngushtë midis BE-së dhe vendeve partnere.

Në vitin 2021, numri i përgjithshëm i ardhjeve të parregullta nga **Ballkani Perëndimor** në BE po rritet në krahasim me vitin 2020, me rreth 23,000 detektime të kalimeve të parregullta kufitare të regjistruara vetëm gjatë 7 muajve të parë të vitit, krahasuar me rreth 27,000 arritje të parregullta për të gjithë vitin 2020. Lëvizjet intensive migratore kanë vazhduar të rezultojnë në një numër të madh refugjatësh dhe migrantësh të pranishëm në rajon, veçanërisht në Serbi dhe Bosnje dhe Hercegovinë. Aktualisht, ka rreth 20,000 emigrantë dhe refugjatë në rajon. Përveç kësaj, vlerësohet se mijëra janë të pranishëm jashtë objekteve të pritjes.

Ndërkohë që po arrihet progres, nevojiten përpjekje të mëtejshme në Ballkanin Perëndimor për krijimin e institucioneve, ligjeve dhe procedurave të reja ose më të fuqishme në fushat e azilit, kthimit dhe menaxhimit të kufijve, gjithashtu në funksion të transpozimit të acquis komplekse dhe kërkuese të BE-së. Partnerët e Ballkanit Perëndimor gjithashtu duhet të marrin përgjegjësinë dhe pronësinë për të gjitha aspektet e migracionit. Ekziston nevoja për të forcuar sistemet e azilit, për të rritur kthimet vullnetare dhe jo vullnetare dhe bashkëpunimin për ripranimin me vendet e origjinës, si dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në luftën kundër grupeve të kriminit të organizuar të përfshirë në kontrabandën e migrantëve dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Bashkëpunimi rajonal dhe koordinimi me BE-në mbeten kyçe.

Kanë përfunduar negociatat për marrëveshjet e statusit me pesë vende të rajonit që lejojnë Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare (Frontex) të vendosë ekipet evropiane të rojeve kufitare dhe bregdetare me fuqi ekzekutive në zonat në kufi me kufirin e jashtëm të BE-së në mbështetje të autoriteteve të kufirit kombëtar, megjithatë, me Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Maqedoninë e Veriut ato nuk janë nënshkruar ende. Për të forcuar menaxhimin e kufijve dhe mbrojtjen e kufijve, hyrja në fuqi dhe zbatimi efektiv i të gjitha marrëveshjeve të statusit është një prioritet kyç. Marrëveshjet me Shqipërinë, Malin e Zi dhe Serbinë kanë hyrë tashmë në fuqi dhe kanë pasuar vendosjet e ekipeve.

¹² JOIN (2016) 18 finale

¹³ [Deklarata e Zagrebit, 6 maj 2020 \(europa.eu\)](#)

¹⁴ [Lansimi i Agjendës Digjitale për Ballkanin Perëndimor \(europa.eu\)](#)

¹⁵ JOIN (2020) 18 final

Turqia vazhdon të presë popullsinë më të madhe të refugjatëve në botë me përafërsisht 4 milionë refugjatë nga Siria dhe vende të tjera të pranishëm në territorin e saj. Në tetë muajt e parë të vitit 2021, numri i përgjithshëm i arritjeve nga Turqia në BE ishte 9703 krahasuar me 12331 në të njëjtën periudhë të vitit 2020. Megjithatë, megjithëse presioni migrator në kufijtë tokësorë dhe detarë turko-grek mbeti gjithashtu i ulët, në të njëjtën periudhë 4739 persona arritën nga Turqia në Itali, krahasuar me 1111 në vitin 2020. Në të njëjtën periudhë, numri total i arritjeve të parregullta në Qipro ishte 5553 (4957 pasi kishin kaluar vijën e gjelbër) krahasuar me 3800 në 2020.

Marrë parasysh situatën në Afganistan dhe perceptimin e emigrantëve në mesin e popullatës turke, autoritetet turke po përforcojnë infrastrukturën e tyre kufitare përgjatë kufirit me Iranin. Autoritetet turke po rrisin gjithashtu burimet në parandalimin dhe luftimin e kontrabandës së emigrantëve, por ka nevojë për një bashkëpunim më të madh ndërkombëtar të zbatimit të ligjit në të gjithë rrugën e migracionit, nga vendet e origjinës në Turqi, Ballkanin Perëndimor dhe BE, për të luftuar rrjetet e kontrabandës. Bashkëpunimi i vazhdueshëm i ngushtë në fushën e menaxhimit të kufijve dhe luftimit të kontrabandës së migrantëve mbetet një prioritet kyç.

Funksionimi i institucioneve demokratike

Sigurimi i reformave të besueshme dhe të qëndrueshme në fushën e demokracisë mbetet një sfidë urgjente për vendet në zgjerim. Mungesa e vullnetit të mirëfilltë politik vazhdoi të ishte arsyeja kryesore për mungesën e progresit thelbësor, apo edhe për ngecjen.

Polarizimi i fortë politik, bojkotimi i zgjedhjeve dhe puna parlamentare nga opozita, dhe në disa raste mosbesimi i dukshëm në të gjithë spektrin politik - veçanërisht brenda parlamenteve - pengojnë ende funksionimin e sistemeve dhe institucioneve demokratike në partnerët e **Ballkanit Perëndimor**. Në **Serbi**, parlamenti dhe forcat politike vazhduan të angazhohen në dialogun ndërpartiak të udhëhequr nga Parlamenti Evropian, për të krijuar konsensus të gjerë ndërpartiak mbi reformat në lidhje me BE-në, të cilat janë jetike për progresin e vendit në rrugën e tij drejt BE-së. Në mbledhjen plenare të shtatorit, bashkë-lehtësuesit nga Parlamenti Evropian dhe ai serb arritën një marrëveshje për një dokument pune që përmban 16 masa për rritjen e besimit dhe konfidencës në procesin zgjedhor, me një sërë veprimesh dhe afatesh konkrete. Gjuhë nxitëse ndaj kundërshtarëve politikë, gazetarëve dhe shoqërisë civile u përdor gjatë debateve plenare në disa vende. Puna parlamentare vazhdoi pavarësisht kufizimeve të COVID-19. Një shoqëri demokratike e bazuar në sundimin e ligjit kërkon trajtimin e paqartë të korrupsionit dhe garantimin e pavarësisë dhe efikasitetit të sistemeve gjyqësore.

Në **Mal të Zi**, zgjedhjet parlamentare rezultuan në një ndryshim në koalicionin qeverisës dhe u shfaq një peizazh i ri politik. Fërkimet midis pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ kanë ngadalësuar reformat, me legjislacionin e ri të paraqitur nga shumica parlamentare që vë në pikëpyetje arritjet e mëparshme. Në **Kosovë**, fitorja dërrmuese e një aleance opozitare në zgjedhjet parlamentare përfaqësoi një ndryshim të madh politik dhe çoi në një qeveri që gëzonte një shumicë solide në Kuvend. Më 17 tetor 2021 u mbajtën zgjedhjet lokale në Kosovë, me një Mision Vëzhgues të Zgjedhjeve të BE-së, i cili do të lëshojë një vlerësim pas zgjedhjeve. Megjithëse zgjedhjet në rajon ishin përgjithësisht të mirëorganizuar, duke përfshirë përdorimin më të madh të TI-së në **Shqipëri**, rekomandimet e shumta të misioneve të mëparshme të vëzhgimit të zgjedhjeve në rajon për numërimin e votuesve, listat e votuesve, financimin e fushatës, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe sanksionet për shkeljet zgjedhore mbeten për t'u zbatuar siç duhet dhe dobësitë strukturore duhet të adresohen. Në veçanti, transparenca dhe llogaridhënia më e madhe për financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore, si dhe një qasje të barabartë në media, kanë nevojë për përpjekje të mëtejshme thelbësore në të gjithë rajonin. Në **Bosnje dhe Hercegovinë**, në maj 2021 u krijua një grup pune ndër-institucional për të diskutuar reformat zgjedhore dhe kushtetuese. Akterët politikë

dhe institucionet duhet të angazhohen në një dialog transparent dhe gjithëpërfshirës për të adresuar mangësitë e kahmotshme elektorale përpara zgjedhjeve të përgjithshme të ardhshme në tetor 2022.

Në **Turqi**, ngecja demokratike vazhdoi gjatë periudhës së raportimit. Turqia duhet të sjellë korrnizën e saj kushtetues në përputhje me standardet evropiane. Pavarësisht përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme në korrik 2018, disa dispozita ligjore që u jepnin autoriteteve qeveritare kompetenca të jashtëzakonshme dhe ruanin disa elemente kufizuese të gjendjes emergjente mbetën të integruara në sistemin ligjor, gjë që prekte demokracinë dhe të drejtat themelore. Në korrik 2021, parlamenti i Turqisë miratoi një projekt-ligj që zgjat edhe një vit kohëzgjatjen e këtyre elementeve kufizuese të gjendjes emergjente. Qasja në drejtësi mbeti e kufizuar për ata që u prekën negativisht nga dekretet-ligjet e emergjencës. Sistemi presidencial ekzekutiv nuk siguron një ndarje të shëndoshë dhe efektive të pushteteve, duke ulur përgjegjësinë demokratike të ekzekutivit. Kryetarët e komunave të shkarkuar me forcë në juglindje vazhduan të zëvendësohen nga administrues të besuar të emëruar nga qeveria, gjë që është kundër mendimit të Komisionit të Venecias të qershorit 2020¹⁶. Targetimi i partive opozitare dhe mediave nga gjyqësori rrezikoi seriozisht legjitimitetin e institucioneve demokratike turke dhe pluralizmin politik. Në këtë drejtim, vendimi i Gjykatës Kushtetuese për pranimin e aktakuzës që synon mbylljen e partisë së dytë më të madhe opozitare dërgon një sinjal të mëtejshëm shqetësues. Politizimi i administratës publike vazhdoi. Shoqëria civile përballej me presion të vazhdueshëm dhe hapësira e tyre për të vepruar lirisht vazhdoi të zvogëlohej.

Reforma e administratës publike

Administratat publike hartojnë dhe ofrojnë politika publike, menaxhojnë investimet publike dhe ofrojnë shërbime publike thelbësore që rrisin mirëqenien e të gjithë qytetarëve. Për të ndërtuar besimin, administratat publike duhet të jenë transparente, të përgjegjshme dhe efektive. Ndërsa ka pasur një progres të mirë gjatë vitit të kaluar, mangësitë kryesore lidhen me format e ndryshme të politizimit.

Planifikimi i politikave është përmirësuar disi, por nevojiten përpjekje të mëtejshme për të siguruar një kontroll të fortë të cilësisë nga qeveritë qendrore dhe për të forcuar kapacitetet për politikëbërje të bazuar në dëshmi dhe për të përmirësuar një kulturë të politikëbërjes së bazuar në dëshmi në administratën publike. Kapacitetet e **monitorimit të politikave** duhet të rriten.

Në Mal të Zi, cilësia e përgjithshme e dokumenteve strategjike të prodhuara gjatë periudhës së raportimit është përmirësuar. Maqedonia e Veriut miratoi një metodologji të re për përgatitjen, monitorimin dhe raportimin mbi strategjitë sektoriale që synon të forcojë planifikimin e politikave. Në Shqipëri, është bërë një progres i lehtë në zbatimin e vlerësimeve të ndikimit rregullator, përmirësimin e aranzhimeve të qeverisjes për konsultimet publike dhe krijimin e sistemeve të TI-së për planifikim të integruar. Në përgjithësi, politikat, legjislacioni dhe investimet publike në rajon ende përgatiten shpesh pa vlerësime të ndikimit.

Llogaridhënia e administratës publike mbetet një prioritet kryesor. Organet publike jo gjithmonë krijohen dhe organizohen në mënyrë efektive. Në Mal të Zi, riorganizimet e fundit të administratës publike çuan në ndryshime thelbësore të stafit, duke përfshirë edhe nivelet e larta, duke rrezikuar kapacitetin e Malit të Zi për të mbajtur staf me përvojë në çështjet që lidhen me procesin e anëtarësimit në BE në shumë sektorë. Në Shqipëri, vitet e fundit janë

¹⁶ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2020\)011-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2020)011-e)

krijuar agjencitë vartëse pa planifikim strategjik. Në Kosovë, ka pasur vonesa në zbatimin e kornizës legislative të miratuar së fundmi, që synon të përmirësojë organizimin dhe llogaridhënien e administratës. Në Maqedoninë e Veriut, Ligji i ri për organizimin shtetëror, që synon riorganizimin e kornizës institucionale, eliminimin e kompetencave të mbivendosura dhe rritjen e efikasitetit të administratës, ende nuk është miratuar.

Burimet njerëzore dhe menaxhimi i shërbimit civil, duke përfshirë llogaridhënien menaxheriale dhe rritjen e profesionalizmit të shërbimit civil, ende duhet të sigurohen në shumicën e vendeve, duke fuqizuar menaxherët dhe mbikëqyrësit e lartë dhe duke deleguar vendimmarrjen tek ata. Procedurat transparente dhe të bazuara në meritë për rekrutimin, ngritjen në detyrë, uljen në detyrë dhe shkarkimin nga puna duhet të përfshihen në kornizat legislative dhe të zbatohen në mënyrë konsistente në të gjitha shërbimet publike në nivel qendror dhe lokal. Struktura e administratës shtetërore duhet të sigurojë linja efektive të llogaridhënies. Shqipëria ka përfunduar hapat kyç duke digjitalizuar plotësisht procesin e rekrutimit të nëpunësve civilë për të siguruar transparencë më të lartë. Në Serbi, nuk pati progres në zvogëlimin e numrit të tepërt të pozitive të menaxherëve të lartë ushtrues detyre. Në Bosnje dhe Hercegovinë, kushtet e ndryshme të punës që rrjedhin nga legjislati i ndryshëm i shërbimit civil si dhe praktikat e ndryshme në nivele të qeverisjes vazhdojnë të pengojnë lëvizshmërinë e nëpunësve civilë dhe krijimin e një hapësire administrative me standarde të barabarta. Shumica e vendeve kanë bërë përpjekje për të përmirësuar shërbimet për bizneset dhe publikun e gjerë. Serbia, Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut filluan iniciativat dhe shërbimet e qeverisjes elektronike si reagim ndaj pandemisë COVID-19. Llogaridhënia e administratës dhe menaxhimit të burimeve njerëzore mbetën një burim shqetësimi në Turqi. Ndërsa politizimi i administratës vazhdoi, ende mungon vullneti politik për reformë

Roli i autoriteteve rajonale dhe lokale në procesin e harmonizimit me BE-në dhe zbatimin eventual të rregullave të BE-së duhet të merret parasysh. Prandaj, duhet të sigurohet një ekuilibër i duhur ndërmjet qeverisjes qendrore, rajonale dhe vendore. Në Turqi, vendimet dhe veprimet e synuara të ndërmarra nga autoritetet kundër komunave me kryetarë të zgjedhur nga partitë opozitare mbeten thellësisht shqetësuese.

Kapaciteti administrativ dhe standardet profesionale të organeve përgjegjëse për zbatimin e *acquis* të BE-së duhet të forcohen dhe të ruhet pavarësia e organeve rregullatore.

Funksionimi i sistemeve të **prokurimit publik** dhe **sistemeve të menaxhimit të financave publike** mbetet një sfidë. Në përgjithësi, transparenca dhe llogaridhënia për masat lidhur me COVID-19 ishin shumë të kufizuara.

Kosova, Mali i Zi dhe Serbia kanë avancuar digjitalizimin e sistemeve të tyre të prokurimit. Ndërkohë, anashkalimi i standardeve të prokurimit të BE-së në Serbi është bërë shqetësim pasi 54% e vlerës kumulative të të gjitha kontratave të prokurimit publik në vitin 2020 është përjashtuar nga zbatimi i ligjit për prokurimin publik. Koncesioni i aeroporteve të Malit të Zi duhet ende të tenderohet në përputhje me standardet e BE-së për prokurimin publik të drejtë dhe transparent. Maqedonia e Veriut dhe Serbia kanë forcuar disi kapacitetet në sistemet e tyre të prokurimit, por zhvillimi i kapaciteteve duhet të ketë prioritet në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kosovë. Shqipëria dhe Mali i Zi përmirësuan ligjet e tyre të prokurimit publik dhe Shqipëria miratoi strategjinë e saj të parë të prokurimit publik. Për pjesën më të madhe të periudhës raportuese, Bosnja dhe Hercegovina u dha trajtim preferencial ofertuesve vendas gjatë dhënies së kontratave publike, në kundërshtim me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Turqia vazhdon të shënojë boshllëqe të mëdha në përafrimin e saj me *acquis* të BE-së, pasi mbulimi i rregullave të prokurimit publik është reduktuar ndjeshëm nga përjashtime të

ndryshme, si dhe nga avantazhet diskriminuese të çmimeve të brendshme dhe praktikat e kompensimit. Përdorimi i sistemit të prokurimit elektronik u katërfishua në Turqi.

Reformimi i sistemeve kombëtare të qeverisjes për të rritur llogaridhënien menaxheriale, **menaxhimin e shëndoshë financiar** dhe auditimin e jashtëm të fondeve publike, është thelbësor. Progresi në kontrollet e brendshme publike dhe llogaridhënien menaxheriale ishte i ngadaltë gjatë COVID-19, por Shqipëria dhe Serbia bënë progres të dukshëm në përcaktimin e kornizës strategjike dhe zhvillimin e metodologjisë për zbatimin e reformave të tyre. Shqipëria bëri përpjekje për të zbatuar më shumë nga rekomandimet e Zyres Shtetërore të Auditimit në vitin 2020, veçanërisht për të adresuar dobësitë që kufizuan ndikimin e auditimeve të jashtme, shqyrtimin e kufizuar legjislativ dhe angazhimin e pamjaftueshëm me publikun. Mali i Zi përmirësoi shumë respektimin e rekomandimeve të auditimit dhe arriti një komunikim më të hapur dhe transparent me Parlamentin dhe me publikun e gjerë. Shqipëria ka ndërmarrë veprime vendimtare për fuqizimin e kontrollit të brendshëm financiar publik (KBFP), me masa për delegimin e përgjegjësive financiare, për monitorimin dhe përcjelljen e auditimeve të brendshme.

Edhe pse forcimi i sistemeve dhe kapaciteteve të **menaxhimit të investimeve publike** është përcaktuar si prioritet për të gjitha vendet në zgjerim, veçanërisht në kontekstin e Planit Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor, vitin e fundit është bërë pak progres. Megjithatë, ndërsa Mali i Zi po kryen një vlerësim të menaxhimit të investimeve publike në vitin 2021, të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor tani kanë rekomandime të bazuara në dëshmi se si t'i bëjnë investimet publike më efektive.

Të gjitha vendet candidate dhe ato candidate potenciale duhet të forcojnë kapacitetin e tyre për të prodhuar **statistika** me cilësi të mirë, në përputhje me parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, që bazohen në pavarësinë profesionale, paanshmërinë, besueshmërinë, transparencën dhe konfidencialitetin. Është gjithashtu kritike të rritet ofrimi i të dhënave për Eurostat. Në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, regjistrimet e popullsisë dhe banesave janë fokusi kryesor i zyrave statistikore dhe duhet të ndahen burime të mjaftueshme për kryerjen e regjistrimeve. Një sektor specifik ku të gjithë duhet të bëjnë progres është ESA 2010, Sistemi Evropian i Llogarive (statistikat makroekonomike).

Ekonomia

Pandemia COVID-19 ka pasur një ndikim të theksueshëm negativ në rritjen ekonomike në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi në vitin 2020. Aktiviteti ekonomik në Ballkanin Perëndimor u tkurr me 3.4%. Turqia tregoi ekspansioni në vitin 2020 (1.8% rritje reale e BPV-së). Në të gjithë Ballkanin Perëndimor, thellësia e rënies ndryshoi gjerësisht në vitin 2020, duke filluar nga një rënie relativisht e lehtë prej 1% e BPV-së në Serbi në një humbje shumë të madhe prej 15.2% në Mal të Zi, dhe me Bosnjen dhe Hercegovinën (4.6%), Shqipërinë (3.8%), Maqedonia e Veriut (4.5%) dhe Kosova (4.1%) duke shënuar nivele të ndërmjetme tkurjeje. Struktura sektoriale e ekonomive, në veçanti pjesa e turizmit, luajti një rol qendror në ashpërsinë e pasojave ekonomike, duke llogaritur, në veçanti, tkurrjen shumë të madhe në Mal të Zi. Sezonet e forta bujqësore patën ndikim lehtësues, veçanërisht në Serbi dhe Shqipëri. Dallimet në politikat e reagimit ndaj krizës, pjesërisht për shkak të nivelit të ndryshëm të hapsirës në dispozicion për politikën, patën ndikim në rezultate ekonomike. Në Turqi, rritja ekonomike erdhi me vazhdimin e inflacionit të lartë, rritjen e deficiteve të jashtme dhe zhvlerësimin e vazhdueshëm të valutës, që lidhet kryesisht me perceptimin e rritur të rrezikut të shkaktuar nga ndryshimet e shpeshta të guvernatorit të bankës qendrore.

Shumica e ekonomive parashikojnë që rritja ekonomike të rimëkëmbet në vitin 2021 dhe më pas të rikuperohet ose tejkalojë ritmet e zgjerimit para pandemisë. Pas deficiteve të larta

fiskale lidhur me krizën dhe rritjeve të konsiderueshme të raportit të borxhit ndaj BPV-së në vitin 2020, konsolidimi gradual fiskal është planifikuar të fillojë në vitin 2021 ose 2022.

Megjithatë, për të nxitur një rimëkëmbje të qëndrueshme në periudhën afatmesme, zbatimi i **reformave strukturore** duhet të përshpejtohet më tej. Kjo është thelbësore për të përmbushur dy kriteret ekonomike për anëtarësimin në BE: për të siguruar ekonomi tregu funksionale dhe për të demonstruar kapacitetin për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së. Përderisa rezultati mesatar për zbatimin e masave të PRE ishte vetëm 2.7 (nga 5) në vitin 2020, niveli i zbatimit të rekomandimeve të miratuara bashkërisht u rrit ndjeshëm, nga 35.5% për udhëzimet e politikave të miratuara në 2019, në 50.8% në 2020. Ky përmirësim lidhet kryesisht me karakterin e veçantë afatshkurtër të shumë masave të rekomanduara për zbutjen e krizës COVID-19.

Tregjet e punës në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi vazhdojnë të karakterizohen nga aktiviteti dhe punësimi i ulët në përgjithësi, si dhe informaliteti i lartë dhe papunësia. Normat e aktivitetit u ulën në të gjitha vendet në vitin 2020 pasi njerëzit prireshin të tërhiqeshin nga forca e punës gjatë krizës COVID-19. Shkalla e ulët e integritit të grave dhe të rinjve në tregun e punës mbetet një sfidë serioze. Në korrik 2021, Ballkani Perëndimor miratoi një Deklaratë për sigurimin e integritit të qëndrueshëm të të rinjve në tregun e punës dhe marrjen e hapave konkretë për të krijuar, zbatuar dhe përmirësuar gradualisht skemat e Garancisë për Rininë. Reformat dhe investimet në sistemet arsimore dhe ngritja e aftësive dhe rikualifikimi janë kyçe për të trajtuar sfidat e tregut të punës.

Digjitalizimi i sektorit industrial dhe zhvillimi i aftësive **digjitale** i të gjitha segmenteve të shoqërisë janë thelbësore për rritjen e punësimit dhe avancimin e ekonomisë digjitale. Plani i veprimit për arsimin digjital 2021-2027¹⁷ i miratuar në shtator 2020 synon të ndihmojë sistemet e arsimit dhe trajnimit, të adresojnë sfidat e krizës COVID-19 dhe të mbështesë transformimin digjital afatgjatë. Peizazhi mediatik gjithashtu ka ndryshuar, duke kërkuar veprime për të mbështetur pavarësinë rregullatore dhe për të mbrojtur të miturit në mediat digjitale.

III. AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT

Metodologjia e rishikuar organizon kapitujt e negociatave në grupime tematike me qëllim që të injektojë dinamizëm të mëtejshëm dhe të nxisë ndërthurje të tyre. Kjo qasje e re reflektohet edhe në prezantimin e mëposhtëm të përfrimit me *acquis* të BE-së.

Grupimi i **tregut të brendshëm** mbulon: lëvizjen e lirë të mallrave (Kapitulli 1); liria e lëvizjes për punëtorët (Kapitulli 2); e drejta e krijimit dhe liria për të ofruar shërbime (Kapitulli 3); lëvizja e lirë e kapitalit (Kapitulli 4); ligji për kompanitë (Kapitulli 6); ligji për pronësinë intelektuale (Kapitulli 7); politika e konkurrencës (Kapitulli 8); shërbimet financiare (Kapitulli 9); dhe mbrojtja e konsumatorëve dhe shëndetit (Kapitulli 28). Përfrimi në këto fusha është thelbësor për të përfutur plotësisht nga Marrëveshjet e Stabilizim Asociimit dhe për të rritur më tej integritimin tregtar me BE-në - partneri kryesor tregtar i rajonit. Gjithashtu ky do t'i bëjë investimet e BE-së më tërheqëse dhe do të lehtësojë sinergjitë e zinxhirit të furnizimit, krijimin e vendeve të punës dhe qasjen në kapital.

Në përgjithësi, Ballkani Perëndimor është mesatarisht i përgatitur në shumë fusha të tregut të brendshëm. Sa i përket lëvizjes së lirë të mallrave, Kosova ka bërë progres të lehtë, kurse partnerët e tjerë të Ballkanit Perëndimor kanë bërë progres të kufizuar. Mali i Zi dhe Serbia bënë progres të lehtë në lëvizjen e lirë të shërbimeve, ndërsa sa i përket lëvizjes së lirë të kapitalit Shqipëria, Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut bënë progres të lehtë, siç bënë

¹⁷ COM/2020/624 finale

Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Mali i Zi në fushën e politikës së konkurrencës. Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Mali i Zi gjithashtu kanë bërë progres në fushën e shërbimeve financiare.

Bashkëpunimi rajonal dhe kornizat gjithëpërfshirëse të bashkëpunimit rajonal si Strategjia e BE-së për Rajonin Adriatik-Jon (EUSAIR) ose Strategjia e BE-së për Rajonin e Danubit (EUSDR) vazhduan të lehtësojnë përgatitjet për pjesëmarrjen eventuale në tregun e brendshëm të BE-së. Tregu i Përbashkët Rajonal i Ballkanit Perëndimor, i cili bazohet në rregullat dhe standardet e BE-së, është një hap për integrimin më të ngushtë të rajonit me tregun e përbashkët të BE-së përpara anëtarësimit. Në Samitin e Sofjes më 10 nëntor 2020, liderët e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor miratuan planin e veprimit të tregut të përbashkët rajonal dhe Deklaratën për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor.

Turqia ka bërë progres në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit, shërbimeve financiare dhe politikës së konkurrencës, ku megjithatë shqetësimet serioze vazhdojnë në lidhje me ndihmën shtetërore. Ajo është mjaft e avancuar në fushën e ligjit për shoqëritë tregtare, dhe ka një nivel të mirë përgatitjeje në fushat e lëvizjes së lirë të mallrave, shërbimeve financiare, mbrojtjes së konsumatorëve dhe shëndetit, si dhe ligjit të pronësisë intelektuale. Ajo mbetet në një fazë të hershme të përgatitjes në fushat e lëvizjes së lirë të shërbimeve dhe lëvizjes së lirë të punëtorëve, ku nuk është shënuar fare progres.

Grupimi i **konkurrueshmërisë dhe rritjes gjithëpërfshirëse** mbulon: shoqërinë e informacionit dhe median (Kapitulli 10); tatimet (Kapitulli 16); politikat ekonomike dhe monetare (Kapitulli 17); politikat sociale dhe punësimin (Kapitulli 19); politikat industriale (Kapitulli 20); shkencën dhe hulumtimin (Kapitulli 25); arsimin dhe kulturën (Kapitulli 26); dhe doganën (Kapitulli 29). Reformat në këto fusha janë jashtëzakonisht të rëndësishme për Programet e Reformës Ekonomike të Ballkanit Perëndimor dhe marrin mbështetje përmes Planit Ekonomik dhe të Investimeve, pasi ato do të ndihmojnë në rritjen e konkurrueshmërisë dhe atraktivitetit të rajonit për bizneset dhe do të ndihmojnë në uljen e hendekut ekzistues me ekonominë e BE-së.

Shumica e partnerëve të Ballkanit Perëndimor kanë një nivel mesatar të përgatitjes në fushat që lidhen me këtë grupim. Megjithatë, Bosnja dhe Hercegovina mbetet në një fazë të hershme në disa fusha. Në fushën e tatimit, Serbia ka bërë progres të mirë, Bosnja dhe Hercegovina nuk ka bërë progres, kurse të gjithë partnerët e tjerë kanë bërë pak progres. Në fushën e unionit doganor, Maqedonia e Veriut ka bërë progres të mirë dhe Serbia dhe Shqipëria kanë bërë progres të kufizuar, ndërsa Kosova dhe Mali i Zi kanë bërë pak progres. Në fushën e arsimit dhe kulturës, Mali i Zi, Serbia dhe Shqipëria shënuan progres. Në fushën e shkencës dhe hulumtimit, Shqipëria bëri progres të mirë, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia shënuan pak progres. Partnerët e Ballkanit Perëndimor të cilët kanë bërë progres të lehtë në fushën e shoqërisë së informacionit dhe medias ishin Shqipëria dhe Kosova, në fushën e politikës ekonomike dhe monetare ishin Maqedonia e Veriut, kurse në fushën e politikës sociale dhe punësimin ishin Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.

Për shkak të progresit të saj në këtë grupim, Komisioni konsideron se Serbia i përmbush të gjitha pikat referuese fillestare të këtij grupimi, veçanërisht duke hequr tatimin diskriminues për alkoolin e importuar. Në përgjithësi, rajoni duhet të ndër marrë reforma socio-ekonomike për të adresuar dobësitë strukturore, konkurrueshmërinë e ulët, papunësinë e lartë dhe ndikimin e pandemisë COVID-19. Progresi në përafrimin me rregullat e BE-së në fushat e TVSH-së, akcizave dhe tatimeve direkte do të ndihmonte në inkurajimin e tregtisë ndërrajonale dhe ndërkombëtare. Rajoni gjithashtu duhet të forcojë ndjeshëm ekosistemin e tij të hulumtimit dhe inovacionit për t'i mundësuar ekonomitë t'i arrijnë zhvillimet, duke përfshirë teknologjitë digjitale dhe të gjelbra. Përsa i përket arsimit dhe kulturës, Mali i Zi dhe Serbia janë kryesuesit në rajon, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova duhet të fillojnë të arrijnë hapin.

Turqia vazhdoi të përafrohet me *acquis* të BE-së në një shkallë të kufizuar dhe pati një ngecje në fushat e shoqërisë së informacionit dhe medias, politikës ekonomike dhe monetare, politikës sociale dhe punësimit si dhe politikës industriale. Turqia ka bërë progres të lehtë në fushat e shkencës dhe hulumtimit, dhe arsimit dhe kulturës, ku vendi duhet të vazhdojë ta bëjë arsimin më gjithëpërfshirës, veçanërisht për vajzat. Përgatitjet e Turqisë në fushën e shkencës dhe hulumtimit janë avancuar mirë. Integrimi tregtar i Turqisë me BE-në është i lartë dhe Turqia mban një nivel të mirë të përgatitjes për unionin doganor, por progresi ishte i kufizuar, përfshirë zbatimin e tij. Devijimet e Turqisë nga detyrimet e saj sipas Unionit Doganor BE-Turqi vazhdojnë, duke kontribuar në një numër të lartë të irrituesve tregtarë.

Agjenda e gjelbër dhe konektiviteti i qëndrueshëm janë kyçe për një rimëkëmbje të qëndrueshme dhe rezistente në të ardhmen, si dhe për integrimin ekonomik brenda rajonit dhe me BE-në, nga të cilat do të përfitojnë bizneset dhe publiku më i gjerë.

Ky grupim mbulon: politikën e transportit (Kapitulli 14); energjinë (Kapitulli 15); rrjetet trans-evropiane (Kapitulli 21); dhe mjedisin dhe ndryshimet klimatike (Kapitulli 27).

Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia janë mesatarisht të përgatitura në fushën e energjisë, ndërsa Mali i Zi është në një nivel të mirë të përgatitjes. Në fushën e rrjeteve trans-evropiane, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova kanë një nivel të përgatitjes, Serbia është mesatarisht e përgatitur dhe Maqedonia e Veriut ka një nivel të mirë të përgatitjes. Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia kanë një nivel të përgatitjes për sa i përket mjedisit dhe ndryshimeve klimatike. Shqipëria dhe Bosnja dhe Hercegovina shënuan progres të lehtë në fushën e politikës së transportit, ndërsa Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia shënuan progres të kufizuar, kurse në Mal të Zi nuk u vu re fare progres. Për shkak të progresit të saj në këtë grupim, Komisioni konsideron se Serbia i përmbush të gjitha pikat referuese fillestare të këtij grupimi, në veçanti duke miratuar udhërrëfyesin e ndarë për sektorin e gazit.

Për sa i përket energjisë, Serbia ka bërë progres të mirë, Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Shqipëria kanë bërë progres të lehtë kurse Mali i Zi ka bërë progres të kufizuar. Në rrjetet trans-evropiane, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia kanë bërë progres të lehtë, ndërsa progres i kufizuar është shënuar në Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi. Sa i përket mjedisit dhe ndryshimeve klimatike, u arrit vetëm progres i kufizuar në të gjitha vendet në Ballkanin Perëndimor. Prandaj nevojitet veprim urgjent në të gjithë rajonin për të përshpejtuar përafrimin me *acquis* të BE-së dhe për të forcuar zbatimin, zbatimin e ligjit dhe investimet. Kapacitetet administrative në sektor duhet të forcohen ndjeshëm dhe duhet të zbatohen reforma strukturore.

Në vitin 2020, Komisioni përmbushi zotimin e tij prej 1 miliard euro për të mbështetur konektivitetin në rajon. Portofoli i konektivitetit nën Kornizën e Investimeve të Ballkanit Perëndimor tani përfshin 45 projekte me vlerë 1 miliardë euro, të cilat do të leverazhojnë më shumë se 3.8 miliardë euro në investime. Kjo ka çuar në udhëtime më të sigurta dhe më të shkurtra dhe ulje të kohës së pritjes në kufij, si dhe një rritje të vëllimeve të tregtisë dhe furnizime energjie më të sigurta, më të besueshme, më të larmishme dhe më të gjelbra, me shmangje rreth 300 mijë ton emetim të CO₂. Grupi i parë i projekteve për të ndihmuar në zbatimin e iniciativave të investimeve të Planit Ekonomik dhe të Investimeve ka filluar. Këto investime u shoqëruan me punë rregullatore në kuadër të Komunitetit të Transportit dhe Komunitetit të Energjisë. Në fushën digjitale, marrëveshja rajonale e roamingut për Ballkanin Perëndimor hyri në fuqi më 1 korrik 2021. Agjenda e konektivitetit u rinovua me miratimin e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, e cila fokusohet në zhvillimin e zgjidhjeve të qëndrueshme të transportit dhe energjisë në rajon.

Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor përafrohet me pesë fushat e gjera të mbuluara nga Marrëveshja e Gjelbër: (i) dekarbonizimi, (ii) ndotja e ajrit, ujit dhe tokës, (iii) ekonomia

rrethore, (iv) bujqësia dhe prodhimi i ushqimit dhe (v) mbrojtja e biodiversitetit. Rritja ekonomike dhe mundësitë e reja të biznesit do të lidhen me praktikat më të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit, duke përfshirë promovimin e një ekonomie rrethore, efikasitetin e burimeve dhe ripërdorimin më të mirë të produkteve të mbeturinave në të gjithë sektorët ekonomikë, përfshirë planifikimin urban dhe rural, me qëndrueshmërinë e ekosistemit si një parakusht për sukses.

Turqia është mesatarisht e përgatitur për sa i përket politikës së saj të transportit dhe energjisë. Ajo duhet të punojë më tej në liberalizimin e tregut të gazit dhe të zhvillojë bashkëpunimin për sigurinë dhe sigurinë bërthamore. Ajo ka bërë progres të lehtë në rjetet e energjisë dhe transportit, me ndërtimin e linjës hekurudhore Halkali-Kapikule që lidh kufirin bullgar me Stambollin, i cili është ende në vazhdim e sipër. Turqia ka një nivel të lehtë të përgatitjes në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike dhe përballet me sfida kritike mjedisore dhe klimatike, si për sa i përket zbutjes ashtu edhe përshtatjes. Turqia e ka ratifikuar Marrëveshjen e Parisit për ndryshimet klimatike (është në pritje të dorëzimit të instrumentit të saj të ratifikimit në Kombet e Bashkuara). Turqia ka shprehur gjithashtu gatishmërinë për të bashkëpunuar me BE-në për objektivat e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane. Këto janë zhvillime të mirëseardhura. Megjithatë, integrimi i veprimit klimatik në politikat e tjera mbetet ende i kufizuar.

Për **burimet, bujqësinë dhe kohezionin**, përgatitjet janë në stagnim. Ky grupim mbulon: bujqësinë dhe zhvillimin rural (Kapitulli 11); sigurinë ushqimore, politikat veterinarë dhe fitosanitare (Kapitulli 12); peshkimin (Kapitulli 13); politikat rajonale dhe koordinimin e instrumenteve strukturore (Kapitulli 22); dhe dispozitat financiare dhe buxhetore (Kapitulli 33).

Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia janë të përgatitura mesatarisht në shumicën e kapitujve të këtij grupimi. Shqipëria dhe Kosova kryesisht kanë një nivel të lehtë të përgatitjes, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina është ende në një fazë të hershme në shumicën e kapitujve.

Në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut bënë progres të lehtë, kurse Bosnja dhe Hercegovina nuk bëri fare progres. Në fushën e sigurisë ushqimore, politikës veterinarë dhe fitosanitare, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi bënë progres të mirë, Shqipëria progres të lehtë dhe Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Serbia progres të kufizuar. Për sa i përket peshkimit, vetëm Shqipëria ka bërë progres të mirë. Mali i Zi ka bërë progres të lehtë. Për sa i përket politikës rajonale dhe koordinimit të instrumenteve strukturore, Bosnja dhe Hercegovina nuk bëri progres ndërsa vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor bënë progres të kufizuar.

Politika e mbështetjes bujqësore e Turqisë është larguar nga parimet e politikës së përbashkët bujqësore të BE-së. Vendi ka bërë progres të mirë në peshkim, progres të lehtë në politikën rajonale dhe koordinimin e instrumenteve strukturore, dhe progres të kufizuar në fushën e sigurisë ushqimore, politikën veterinarë dhe fitosanitare, ku ka shqetësime për nivelin e mbetjeve të pesticideve në eksportet e produkteve ushqimore drejt BE-së.

Grupimi i **marrëdhënieve të jashtme** mbulon marrëdhëniet e jashtme (Kapitulli 30) dhe politikën e jashtme, të sigurisë dhe mbrojtjes (Kapitulli 31).

Të gjithë partnerët e Ballkanit Perëndimor ose kanë një nivel të mirë të përgatitjes ose mesatar në fushën e marrëdhënieve me jashtë, me përjashtim të Bosnjës dhe Hercegovinës, e cila ka një nivel të përgatitjes. Në fushën e **politikës së jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes**, Shqipëria dhe Mali i Zi kanë nivel të mirë të përgatitjes, Maqedonia e Veriut dhe Serbia janë mesatarisht të përgatitura dhe Bosnja dhe Hercegovina ka një nivel të përgatitjes.

Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë arritur progres të lehtë fushën e marrëdhënieve të jashtme, me përjashtim të Bosnjës dhe Hercegovinës, e cila ka bërë progres të kufizuar. Në politikën e jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes, Shqipëria bëri progres të mirë, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia arritën progres të lehtë, Bosnja dhe Hercegovina nuk pati fare progres. Partnerët e Ballkanit Perëndimor kanë vazhduar të bashkëpunojnë ngushtë me BE-në për çështjet e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë/politikës së përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes (CFSP/CSDP), veçanërisht përmes kontributeve të tyre të rëndësishme në misionet dhe operacionet e CSDP të BE-së. Përafrimi me CFSP-në e BE-së (deklaratat e Përfaqësuesit të Lartë në emër të BE-së dhe vendimeve të Këshillit për masat kufizuese) është një aspekt i rëndësishëm i procesit të integritimit në BE, duke nënvizuar drejtimin strategjik të vendeve. Shqipëria dhe Mali i Zi kanë ruajtur me vendosmëri përafrimin 100% konsistent, gjë që është një shenjë e përkushtimit dhe orientimit të tyre strategjik. Shkalla e përafrimit e Maqedonisë së Veriut u rrit nga 94% në 2020 në 96% në gusht 2021. Shkalla e përafrimit e Serbisë u rrit nga 56% në 2020 në 61% në gusht 2021, gjë që është një hap fillestar drejt kthimit të trendit negativ të mëparshëm në lidhje me kërkesën për përafrim progresiv i përfshirë në kornizën negociatore të vendit. Një rënie e dukshme në shkallën e përafrimit të Bosnjë dhe Hercegovinës nga 70% në 2020 në 43% në gusht 2021 është shqetësuese. Përmbysja e këtij trendi do të sinjalizonte përkushtimin e Bosnjë-Hercegovinës në rrugën e saj evropiane.

Turqia është e përgatitur mesatarisht në fushën e marrëdhënieve të jashtme dhe ka një nivel të përgatitjes në fushën e politikës së jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes. Turqia ka bërë progres të kufizuar në marrëdhëniet e jashtme. Turqia ka mbajtur një shkallë shumë të ulët të përafrimit me CFSP prej 14% në gusht 2021 (11% në 2020 dhe 21% në 2019). Politika e jashtme gjithnjë e më e vendosur e Turqisë vazhdoi të ishte në kundërshtim me prioritetet e CFSP të BE-së, veçanërisht për shkak të qasjes konfliktuale të Turqisë ndaj Libisë, refuzimit të saj për të bashkëpunuar me Operacionin IRINI dhe mbështetjes së saj për veprimet ushtarake në Kaukaz, Siri dhe Irak. Ndërsa këtë vit Turqia ka treguar gatishmëri për t'u përfshirë në dialog me BE-në për politikën e jashtme dhe të sigurisë dhe për çështjet rajonale, ajo duhet të marrë ende hapa vendimtarë për të përmirësuar ndjeshëm përafrimin me deklaratat e BE-së dhe vendimet e Këshillit.

IV. BASHKËPUNIMI RAJONAL DHE MARRËDHËNIET E FQINJËSISË SË MIRË

Në Ballkanin Perëndimor, marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimi rajonal janë elementë thelbësorë të proceseve të Stabilizim-Asociimit dhe të zgjerimit. Ato kontribuojnë në stabilitetin, pajtimin dhe një klimë të favorshme për adresimin e çështjeve të hapura dypalëshe dhe trashëgimive të së kaluarës.

Si pjesë e përpjekjeve rajonale të integritimit ekonomik, Marrëveshja Rajonale e Roamingut për **Ballkanin Perëndimor** e nënshkruar në prill 2019 çoi në uljen progresive të tarifave të roamingut që nga korriku 2019 dhe më pas në eliminimin e tyre me futjen e skemës 'roam like at home' më 1 korrik 2021. Ky është një hap i madh në bashkëpunimin rajonal dhe ka sjellë përfitime të dukshme për qytetarët. Ka filluar puna për të eksploruar mënyra për të reduktuar kostot e roaming-ut ndërmjet partnerëve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së, dhe për të zhvilluar një udhërrëfyes mbi procesin, siç përcaktohet në Agjendën Digjitale për Ballkanin Perëndimor.

Nën Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal dhe CEFTA, dhe me ndihmën e Komisionit, u krye punë e rëndësishme teknike për të mundësuar lirinë e lëvizjes për personat, profesionistët dhe ofrimin e shërbimeve elektronike, si dhe për të lehtësuar tregtinë dhe lehtësimin e procedurave doganore brenda rajonit si pjesë e nismës së Tregut të Përbashkët Rajonal. Megjithatë, këto masa nuk janë miratuar për shkak të mosmarrëveshjeve që nuk kanë lidhje

me thelbin e tyre. Rajoni tani duhet të tregojë lidhshmëri politike për të përfunduar këtë punë dhe për të miratuar marrëveshje ose vendime ligjrisht të detyrueshme midis të gjithë partnerëve të Ballkanit Perëndimor, për të mirën e qytetarëve dhe bizneseve të tyre. Kjo kërkon një fokus të përbashkët në krijimin e Tregut të Përbashkët Rajonal, duke u bazuar mbi rregullat dhe standardet e BE-së dhe duke shmangur hapat e njëanshëm që rrezikojnë këtë punë.

Pavarësisht kufizimeve të COVID-19, Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor vazhdoi të luajë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore duke ofruar mundësi bashkëpunimi dhe shkëmbimi për të rinjtë nga Ballkani Perëndimor. Të rinjtë vazhduan të bashkëpunojnë përmes një sërë nismash të tjera rajonale online dhe fizikisht, duke përfshirë Laboratorin Rajonal të Rinisë.

Samiti BE-Ballkani Perëndimor në Bërdo pasqyroi rëndësinë që BE-ja i kushton rajonit dhe rikonfirmoi perspektivën e saj evropiane. Udhëheqësit mirëpritën progresin në **iniciativat** kyçe, veçanërisht progresin në roaming, Agjendën e Gjelbër, Korsitë e Gjelbërta në kufijtë midis BE-së dhe rajonit, Agjendën e Inovacionit dhe miratimin e kornizës ligjore IPA III. Këto nisma që pasqyrojnë prioritetet e politikave të BE-së, së bashku me Planin Ekonomik dhe të Investimeve, do ta çojnë rajonin drejt një rikuperimi më të shpejtë dhe më të qëndrueshëm pas pandemisë, si dhe do të sigurojnë një integrim më të madh me Bashkimin Evropian. Komisioni njoftoi synimin e tij për të propozuar një paketë investimi prej 600 milionë euro në kuadër të IPA 2021 për zbatimin e Planit Ekonomik dhe të Investimeve, që i nënshtrohet procedurave në përputhje me kuadrin e programimit IPA III dhe rregullat zbatuese. Së bashku me propozimin prej 500 milionë euro të shpallur në korrik, kjo do të sigurojë gjithsej 1.1 miliardë euro për zbatimin e Planit Ekonomik dhe të Investimeve deri në fund të vitit 2021. BE-ja dhe partnerët e Ballkanit Perëndimor ranë dakord të forcojnë bashkëpunimin e tyre në një sërë fushash, duke përfshirë çështjet kryesore të sigurisë.

Normalizimi gjithëpërfshirës i marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës përmes Dialogut të lehtësuar nga BE-ja mbetet kryesor për të ardhmen e tyre evropiane dhe për stabilitetin e të gjithë rajonit. Pas zgjedhjeve në Kosovë në fillim të vitit 2021, procesi vazhdoi me dy takime të nivelit të lartë në qershor dhe korrik 2021, por marrëdhëniet mes Beogradit dhe Prishtinës mbeten të tensionuara. Të dyja palët duhet të angazhohen në mënyrë konstruktive drejt objektivit të përfundimit të një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse ligjrisht të detyrueshme që trajton të gjitha çështjet e pazgjidhura ndërmjet tyre.

Pas tensioneve në veri të Kosovës, në Dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja më 30 shtator 2021 u arrit një marrëveshje për de-eskalimin dhe masën e përkohshme për çështjet e targave. Palët ranë dakord gjithashtu të krijojnë një grup pune të udhëhequr nga BE-ja, për të gjetur një zgjidhje të përhershme brenda 6 muajve bazuar në standardet dhe praktikën e BE-së. BE-ja pret që palët të angazhohen në mënyrë konstruktive në këtë proces për të garantuar lirinë e lëvizjes për qytetarët.

Marrëveshjet dypalëshe ekzistuese, duke përfshirë marrëveshjen e Prespës ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë, si dhe Traktatin e Miqësisë, Fqinjësisë së Mirë dhe Bashkëpunimit me Bullgarinë, duhet të zbatohen me mirëbesim nga të gjitha palët.

Marrëdhëniet dypalëshe midis Malit të Zi dhe Serbisë janë shënuar nga tensione, një rritje e retorikës nacionaliste dhe pretendime për ndikim të jashtëm gjatë periudhave zgjedhore, por bashkëpunimi në disa fusha si në sektorin e shëndetësisë është intensifikuar.

Tejkalimi i ngjarjeve të ndodhura në të kaluarën dhe adresimi i mosmarrëveshjeve që lindin nga konfliktet e viteve 1990 janë gjëra vendimtare. Në BE nuk ka vend për mohim të gjenocidit, glorifikim të kriminelëve të luftës apo retorikë nxitëse, nga asnjëra anë. Ka pasur progres të kufizuar në adresimin e çështjeve të rëndësishme dypalëshe të pazgjidhura, duke përfshirë çështjet e kufirit dhe dhënien e drejtësisë për viktimat e krimeve të luftës,

identifikimin e personave të mbetur të zhdukur dhe krijimin e një regjistrimi të saktë të mizorive të kaluara në nivel rajonal.

Nuk duhet të ketë pengesë për pjesëmarrjen e plotë dhe gjithëpërfshirëse të të gjithë partnerëve të Ballkanit Perëndimor në nismat dhe ngjarjet e bashkëpunimit rajonal, duke përfshirë programet e financuara nga BE-ja.

Bashkëpunimi territorial i ka mundësuar vendeve të Ballkanit Perëndimor të bashkëpunojnë me shtetet anëtare fqinje për shumë çështje. Përtej kontributit për rritje, vende të punës dhe mbrojtje të mjedisit, ajo ka luajtur gjithashtu një rol të rëndësishëm në rritjen e bashkëpunimit rajonal në shumë nivele, zgjidhjen e çështjeve të ndryshme dypalëshe dhe sjelljen e stabilitetit. Më konkretisht bashkëpunimi ndërkuftar (BNK) përbën një pjesë kritike të procesit të pajtimit në rajon. Për shkak të konflikteve të viteve 1990 (në ish-Jugosllavi), forcimi i marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, duke përfshirë zonat kufitare, mbetet një parakusht për rritje dhe prosperitet për rajonet si dhe për përfituesit e përfshirë. Programet BNK përqendrohen në tejkalimin e ngjarjeve të konflikteve të së kaluarës dhe në ndërtimin e pajtimit duke krijuar kontakte të drejtpërdrejta ndërmjet subjekteve dhe administratave në të gjitha nivelet në të dy anët e kufirit.

Për shkak të aktiviteteve të vazhdueshme dhe ato të reja të paautorizuara të ndërmarra nga ana e **Turqisë** lidhur me eksplorimin e hidrokarbureve në zonat detare të Qipros dhe Greqisë, në gjysmën e dytë të 2020 u rritën tensionet në Mesdheun Lindor dhe Detin Egje. BE-ja i ka kërkuar vazhdimisht Turqisë të përmbahet nga kërcënimet, të mos krijojë burime fërkimi ose të ndërmarrë veprime që dëmtojnë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve. Në konkluzionet e tij të dhjetorit 2020, Këshilli Evropian dënoi ashpër veprimet, provokimet dhe retorikën e përshkallëzuar të njëanshme të Turqisë kundër BE-së, shteteve anëtare të BE-së dhe liderëve evropianë. Gjithashtu Këshilli theksoi se oferta e një agjende pozitive BE-Turqi mbetet në tryezë, me kusht që Turqia të tregojë gatishmëri për të promovuar një partneritet të vërtetë me Bashkimin Evropian dhe Shtetet Anëtare të tij dhe për të zgjidhur mosmarrëveshjet përmes dialogut dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Tensionet në Mesdheun Lindor u ulën në fillim të vitit 2021. Turqia ndaloi aktivitetet e paligjshme të shpimit në zonat detare të Qipros. Megjithatë, incidente të reja u raportuan në fillim të tetorit 2021 në lidhje me kërkimet nga ana e Qipros dhe Turqisë.

Bisedimet kërkimore ndërmjet Greqisë dhe Turqisë rifilluan, dhe gjithashtu u zhvilluan kontakte të nivelit të lartë. Këshilli Evropian në mars 2021 ripohoi se BE-ja do të mbetet e përkushtuar për të mbrojtur interesat e saj dhe ato të shteteve anëtare, si dhe për ruajtjen e stabilitetit rajonal. BE-ja zgjeroi kornizën ekzistuese për masat kufizuese si përgjigje e aktiviteteve të paautorizuara të shpimit të Turqisë në Mesdheun Lindor, miratuar në nëntor 2019¹⁸.

Të drejtat sovraane të Shteteve Anëtare të BE-së përfshijnë, ndër të tjera, të drejtën për të hyrë në marrëveshje dypalëshe dhe për të eksploruar dhe shfrytëzuar burimet natyrore në përputhje me *acquis* të BE-së dhe të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën e OKB-së për të Drejtën e Detit. Sovraniteti dhe të drejtat sovraane mbi zonat detare të të gjitha shteteve bregdetare fqinje, duke përfshirë ato që u takojnë ishujve të tyre, duhet të respektohen dhe përcaktimi i zonave ekskluzive ekonomike dhe shelfit kontinental duhet të adresohet në përputhje me të drejtën ndërkombëtare përmes dialogut në mirëbesim dhe në ndjekje të marrëdhënieve të mira fqinjësore. Ndjekja e dialogut në mirëbesim dhe përmbajtja nga veprimet e njëanshme që bien ndesh me interesat e BE-së dhe që shkelin të drejtën ndërkombëtare dhe të drejtat sovraane të shteteve anëtare të BE-së është një kërkesë absolute për të siguruar një mjedis të qëndrueshëm dhe të sigurt në Mesdheun Lindor dhe zhvillimin e

¹⁸ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32020D1657&from=EN>

një marrëdhënie bashkëpunuese dhe reciproke të dobishme midis BE-së dhe Turqisë. Të gjitha mosmarrëveshjet duhet të zgjidhen përmes dialogut paqësor dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

Angazhimi dhe kontributi i vazhdueshëm i Turqisë në terma konkretë në negociatat për një zgjidhje të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të çështjes së Qipros brenda kornizës së OKB-së dhe në përputhje me rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KSKB) është me rëndësi të madhe. Një takim jozyrtar 5+1 për Qipron u zhvillua në muajin prill të vitit 2021. Është e rëndësishme që Turqia ta ripohojë zotimin dhe angazhimin e saj konstruktiv në **bisedimet për zgjidhjen e çështjes së Qipros të udhëhequra nga Kombet e Bashkuara** në përputhje me rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, duke përfshirë aspektet e tyre të jashtme. Nuk duhet të ndërmerren veprime të njëanshme që mund t'i rrisin tensionet në ishull dhe ta minojnë kthimin në bisedime. Në lidhje me Varoshën, Turqia duhet t'i ndryshojë menjëherë veprimet e njëanshme të shpallura më 20 korrik 2021 dhe të gjitha hapat e ndërmarra në Varosha që nga muaji tetor i vitit 2020 që bien ndesh me rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Turqia duhet ta përmbushë urgjentisht detyrimin e saj për zbatimin e plotë të Protokollit Shtesë të Marrëveshjes së Asociimit BE-Turqi dhe të bëjë progres drejt normalizimit të marrëdhënieve me Republikën e Qipros.

Marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe pajtimi janë të lidhura në thelb me sundimin e ligjit, qeverisjen ekonomike dhe bashkëpunimin rajonal. Objektivi specifik i **IPA III** në këtë fushë është të kontribuojë në kohezionin dhe rezilencën sociale duke trajtuar trashëgiminë e konflikteve të së kaluarës dhe duke sjellë drejtësi për të gjitha viktimat e konflikteve. Po kështu, përmirësimi i marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë nxit besimin e qytetarëve dhe kontribuon në heqjen e pengesave ndaj shkëmbimeve dhe bashkëpunimit politik, ekonomik dhe social. Në vazhden e kësaj, IPA III do t'i japë prioritet veprimeve që kontribuojnë në ndërtimin e besimit, kohezionin social dhe forcimin e marrëdhënieve fqinjësore, veçanërisht (1) luftimin e mosndëshkimit për krimet e rënda ndërkombëtare, duke përfshirë bashkëpunimin e fortë rajonal dhe ndjekjet e brendshme penale efektive; (2) promovimin e të drejtave të viktimave; (3) promovimin e rritjes së dialogut politik dhe të politikave në nivele politike dhe teknike dhe përpjekjeve të ndërmjetësimit për t'i adresuar çështjet e pazgjidhura të trashëgimisë; promovimin e arsimit dhe rinisë, duke përfshirë dialogun ndërkulturor, si vektorë për kohezionin social dhe marrëdhënie paqësore, si dhe nxitës të zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik; dhe (4) zhvillimin e shkëmbimeve lokale dhe ndërmjet njerëzve në fusha të ndryshme, duke përfshirë bashkëpunimin ekonomik dhe mjedisor, qeverisjen e mirë dhe drejtësinë, median, përfshirjen sociale, të drejtat e njeriut, në veçanti barazinë gjinore, të drejtat e fëmijëve, pjesëmarrjen e të rinjve, të drejtat sociale dhe të drejtat e personave që u përkasin pakicave.

V. KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Bazuar në analizën e mësipërme dhe vlerësimet në përmbledhjet për vendin në shtojcë, Komisioni nxjerr konkluzionet dhe rekomandimet e mëposhtme:

I.

1. Një **politikë kredibile zgjerimi** është një investim gjeostrategjik në **paqen, stabilitetin, sigurinë dhe rritjen ekonomike në të gjithë Evropën**. Me çdo zgjerim të njëpasnjëshëm, BE-ja ka qenë në gjendje t'i zgjerojë përfitimet e saj për më shumë qytetarë. Çelësi për arritjen e kësaj është të sigurohet që procesi të vazhdojë të bazohet në **kushtëzimin e rreptë por të drejtë dhe parimin e meritave të veta**. Këto kushte duhet të jenë objektive, të sakta, të detajuara, strikte dhe të verifikueshme. Kjo ndihmon në përgatitjen e vendeve në fjalë për t'i përmbushur të gjitha kërkesat për anëtarësim, që është një nga prioritetet kryesore politike të BE-së.
2. Metodologjia e zgjerimit e rishikuar në vitin 2020 synon **ta forcojë më tej procesin e anëtarësimit** duke e bërë atë më të parashikueshëm, më kredibil, më dinamik dhe subjekt i drejtimit më të fortë politik. Procesi i anëtarësimit bazohet në besim, mirëbesim reciprok dhe angazhimet e qarta nga Bashkimi Evropian dhe Ballkani Perëndimor.
3. Vonesat në nisjen zyrtare të negociatave për anëtarësim me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut po ndikojnë negativisht në kredibilitetin e BE-së. Çështjet dypalëshe të mbetura midis Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut duhet të zgjidhen si çështje prioritare. Është thelbësore që shtetet anëtare të BE-së t'i përfundojnë diskutimet mbi Kornizat Negociuese pa vonesa të mëtejshme dhe që konferencat e para ndërqeveritare me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut të mbahen sa më shpejt dhe para fundit të këtij viti. Në konferencat ndërqeveritare me Malin e Zi dhe Serbinë të mbajtura në muajin qershor të vitit 2021 u miratua aplikimi i metodologjisë së rishikuar me këto dy vende.
4. **Deklarata e Bërdos e datës 6 tetor 2021** u ka dërguar një sinjal të rëndësishëm partnerëve të Ballkanit Perëndimor të BE-së se e ardhmja e tyre qëndron në Bashkimin Evropian. BE-ja e ripohoi mbështetjen e saj të qartë për perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor dhe mirëpriti angazhimin e partnerëve të Ballkanit Perëndimor ndaj perspektivës evropiane, si një interes strategjik reciprok dhe një zgjedhje e përbashkët strategjike. BE-ja përshëndeti angazhimin e ritheksuar të partnerëve të Ballkanit Perëndimor **ndaj parësisë së demokracisë, vlerave themelore dhe sundimit të ligjit**.
5. Marrëveshja për mbajtjen e **samiteve BE-Ballkani Perëndimor si ngjarje të rregullta** është një angazhim i rëndësishëm që do të sigurojë një format për dialog politik në nivelin më të lartë dhe për lidhjen e rajonit më afër politikave të BE-së përderisa lëviz drejt BE-së. Iniciativat që u ranë dakord në samitin e Bërdos pasqyrojnë prioritetet e politikave të BE-së dhe ofrojnë mundësi dhe përfitime të reja për qytetarët e rajonit. Në samit u lansua **Agjenda e dedikuar për Ballkanin Perëndimor për Inovacionin, Hulumentimin, Arsimin, Kulturën, Rininë dhe Sportin** ("Agjenda e Ballkanit Perëndimor për Inovacionin") e cila do ta promovojë ekselencën shkencore, reformimin e sistemeve arsimore të rajonit, do të krijojë mundësi të mëtejshme për të rinjtë dhe do të ndihmojë në parandalimin e "ikjes së trurit". Në këtë samit u mirëprit udhërrëfyesi, i cili do t'i krijojë kushtet dhe do të përcaktojë objektiva të qarta për **uljen e kostove të roaming** ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor. Për më tepër, në këtë samit u mirëprit edhe marrëveshja për një plan të detajuar veprimi për **Agjendën e Gjelbër** dhe udhëheqësit ranë dakord ta forcojnë bashkëpunimin në një sërë fushash, duke përfshirë sigurinë.
6. **Turqia** mbetet një partner kyç për Bashkimin Evropian në fusha thelbësore me interes të përbashkët, si p.sh migrimi, luftimi i terrorizmit, ekonomia, tregtia, energjia dhe transporti.

Në këtë kontekst u mbajtën dialogë të nivelit të lartë për klimën dhe migracionin, që do të pasohen nga një dialog për shëndetin së shpejti. Në muajin qershor të vitit 2019, Këshilli përsëriti se Turqia vazhdon të largohet më tej nga Bashkimi Evropian dhe se negociatat për anëtarësimin e Turqisë në fakt kanë ngecur dhe se asnjë kapitull tjetër nuk mund të konsiderohet për hapje apo mbyllje. Faktet themelore që çojnë në këtë vlerësim ende qëndrojnë. Megjithatë, dialogu dhe bashkëpunimi me Turqinë u rritën në vitin 2021.

7. **Pandemia COVID-19** vazhdoi ta godasë fort Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë gjatë gjithë periudhës raportuese. Autoritetet në vendet e zgjerimit vazhduan të marrin masa për ta kufizuar përhapjen e pandemisë dhe ndikimin e saj në shëndet, si dhe për t'i zbutur pasojat socio-ekonomike. Çdo masë për t'i kufizuar infektimet duhet të jetë proporcionale, e kufizuar në kohë dhe t'i respektojë liritë themelore, përfshirë lirinë e shprehjes. Ndikimi i pandemisë në ekonomi vazhdoi të ishte thelbësor, gjë që në përgjithësi la hapësirë të kufizuar fiskale për ndërhyrjen e qeverive.
8. BE, e prekur rëndë nga kjo krizë, ka mobilizuar **një pako prej mbi 3.3 miliardë eurosh**, duke përfshirë mbështetje të menjëhershme për t'i adresuar sfidat shëndetësore dhe një financim të konsiderueshëm për rimëkëmbjen ekonomike të rajonit. BE-ja po e trajton gjithashtu Ballkanin Perëndimor si partner të privilegjuar duke vazhduar t'u japë atyre qasje në shumë iniciativa dhe instrumente që zakonisht rezervohen për shtetet anëtare të BE-së; duke siguruar sasi të konsiderueshme vaksinash me rishitje ose donacione nga shtetet anëtare (pothuajse 2.9 milionë doza në total deri në fund të muajit gusht të vitit 2021); dhe duke u mundësuar atyre të sigurojnë përputhshmërinë e certifikatave të tyre COVID me **certifikatën digjitale të BE-së për COVID** (Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Turqia janë të parat që e bëjnë këtë). Kjo mbështetje nga BE-ja **shkon shumë përtej dhe është shumë më gjithëpërfshirëse se sa ajo që i jepet rajonit nga ndonjë partner tjetër**. Ashtu si BE-ja që është investitori, donatori dhe partneri tregtar më i madh i Ballkanit Perëndimor, ky është një tjetër pasqyrim i qartë i ankorimit strategjik të rajonit në BE.
9. **Plani Ekonomik dhe i Investimeve** i BE-së për Ballkanin Perëndimor do të ofrojë një stimul të madh për rajonin me 9 miliardë euro grante dhe garanci që janë vendosur për të nxitur investime deri në 20 miliardë euro. Ky plan me pothuajse 30 miliardë euro, që përfaqëson rreth një të tretën e BPV-së së rajonit, do të ofrojë fonde për infrastrukturë të qëndrueshme (transport, energji, infrastrukturë digjitale), duke lidhur rajonin brenda dhe me BE-në, tranzicionin binjak të gjelbër dhe digjital, si dhe rimëkëmbjen pas pandemike të sektorit privat. Do të sjellë një ndryshim të vërtetë në kapërcimin e hendekut socio-ekonomik midis Ballkanit Perëndimor dhe BE-së. Pas miratimit të kornizës ligjore për Rregulloren për Instrumentin e Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA III) për periudhën 2021-2027, e cila është burimi kryesor i financimit, tani është thelbësore që të përshpejtohet përgatitja e projekteve të matura dhe të qëndrueshme.
10. Miratimi i **kornizës ligjore të IPA III parashikon** një qasje solide të nxitur nga politikat, me shpërndarje strategjike dhe dinamike të asistencës, duke vendosur kërkesat themelore për anëtarësim, veçanërisht sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë, në thelb të instrumentit.
11. Plani Ekonomik dhe i Investimeve iu bën thirrje vendeve të Ballkanit Perëndimor që t'i integrojnë më mirë ekonomitë e tyre dhe t'i ndjekin reformat rregullatore, në mënyrë që të lirohet potenciali i rritjes së integritit të tregut. Në Samitin e Sofjes të mbajtur në muajin nëntor të vitit 2020, liderët e Ballkanit Perëndimor ranë dakord të krijojnë një **Treg të Përbashkët Rajonal**, bazuar në rregullat dhe standardet e BE-së, të strukturuar rreth katër lirive (lëvizja e lirë e mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve) dhe që mbulon aspekte të politikës së digjitalizimit, investimeve, inovacionit dhe industrisë. BE-ja mbështet plotësisht zbatimin e kësaj iniciative gjithëpërfshirëse, e cila do të mbetet vendimtare për shfrytëzimin e plotë të potencialit të rajonit dhe të Planit Ekonomik dhe të Investimeve.

12. Që nga miratimi i Tregut të Përbashkët Rajonal, gjashtë partnerët e Ballkanit Perëndimor kanë arritur progres të mirë në negociimin në këtë kuadër të disa marrëveshjeve rajonale për ta lehtësuar lëvizjen e personave, profesionistëve dhe shërbimeve në të gjithë rajonin. Pavarësisht këtij progresi teknik, këto marrëveshje nuk mund të miratoheshin për shkak të divergjencave politike që nuk kishin lidhje me thelbin e tyre. Këto pengesa duhet të tejkalohen me prioritet. Në vend të masave të njëanshme, bashkëpunimi rajonal gjithëpërfshirës mbetet një domosdoshmëri politike dhe ekonomike për Ballkanin Perëndimor.
13. Tregu i Përbashkët Rajonal paraqet një hap përpara për integrimin më të ngushtë të rajonit me tregun e vetëm të BE-së tashmë përpara anëtarësimit duke siguruar mundësi të barabarta. Ky është çelësi për rajonin që t'i përdorë marrëdhëniet e tij të privileguara me BE-në dhe përpjekjet e tij për përafrim me rregullat dhe standardet e BE-së. Komisioni Evropian do të vazhdojë ta ndihmojë rajonin për ta arritur uljen e kostove të pagesave ndërkufitare, për ta lehtësuar lëvizjen e mallrave industriale dhe të konsumit, dhe tregtinë elektronike midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor.
14. Një bashkëpunim i tillë rajonal është vendimtar edhe në kuadër të **forcimit të marrëdhënieve të mira fqinjësore**. Tejkalimi i ngjarjeve të së kaluarës dhe adresimi i mosmarrëveshjeve që lindin nga konfliktet e viteve 1990 është vendimtar. Në BE nuk ka hapësirë për mohimin e gjenocidit, glorifikimin e kriminelëve të luftës apo retorikën nxitëse, nga asnjëra anë.
15. Dialogu i ndërmjetësuar nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës mbetet kyç për të ardhmen e tyre evropiane dhe për stabilitetin e të gjithë rajonit. Të dyja palët duhet të angazhohen në mënyrë konstruktive drejt objektivit të përfundimit të një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse ligjërish të detyrueshme. Duhet të shmangen veprimet e njëanshme dhe të pakoordinuara që rrezikojnë stabilitetin.

II

16. Në **Mal të Zi, angazhimi politik publik** i autoriteteve drejt drejtimit strategjik të vendit për në BE dhe angazhimi i tij në procesin e anëtarësimit është deklaruar rregullisht dhe në vazhdimësi si prioritet kyç për vendin dhe është pasqyruar përgjithësisht në vendimet përkatëse të politikave. Kjo përfshinte ndër të tjera një normë të vazhdueshme të përafrimit 100% me Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së.

Vlerësimi i Komisionit është se, në përputhje me kornizën negociuese, aktualisht sigurohet një **ekuilibër i përgjithshëm** ndërmjet progresit sipas kapitujve të sundimit të ligjit, nga njëra anë, dhe progresit në **negociatat për anëtarësim** nëpër kapituj, nga ana tjetër. Prioriteti për progres të mëtejshëm të përgjithshëm në negociatat për anëtarësim - dhe përpara se të shkohet drejt mbylljes së përkohshme të kapitujve ose grupimeve të tjera - mbetet përmbushja e standardeve të përkohshme të sundimit të ligjit të përcaktuara në kapitujt 23 dhe 24. Për ta arritur këtë pikë kyçe, Malit të Zi i duhet t'i intensifikojë më tej përpjekjet e tij për adresimin e çështjeve të pazgjidhura, duke përfshirë fushat kritike të lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias, si dhe luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, pa i përmbysur arritjet e mëparshme në reformën në drejtësi. Kjo kërkon që autoritetet të demonstrojnë në praktikë përkushtimin e tyre ndaj agjendës së reformës së BE-së të Malit të Zi.

17. Qeveria **serbe** vazhdoi ta deklarojë integrimin evropian si objektiv të saj strategjik. Qeveria i dha prioritet reformave në lidhje me BE-në në gjysmën e parë të vitit 2021 dhe realizoi një sërë zotimesh të rëndësishme të mbetura, veçanërisht për tatimet dhe energjinë. Serbia mbetet një partner i rëndësishëm në misionet dhe operacionet e CSDP-së së BE-së

dhe ka përmirësuar përafrimin me politikën e jashtme të BE-së, duke arritur në 61% në muajin gusht të vitit 2021, nga 56% në vitin 2020; ende priten përpjekje të mëtejshme. Për **normalizimin e marrëdhënieve** me Kosovën, Serbia u angazhua në procesin e Dialogut. Serbia duhet të vazhdojë të angazhohet në mënyrë konstruktive dhe të kontribuojë në arritjen e një marrëveshjeje ligjërish të detyrueshme gjithëpërfshirëse të normalizimit me Kosovën. Një marrëveshje e tillë është urgjente dhe vendimtare në mënyrë që Serbia dhe Kosova të mund të avancojnë në rrugët e tyre evropiane. Serbia duhet gjithashtu t'i mbështesë dhe zbatojë plotësisht të gjitha marrëveshjet e dialogut të arritura në të kaluarën.

Vlerësimi i Komisionit është se, në përputhje me kornizën negociuese, **ekuilibri i përgjithshëm** aktualisht sigurohet ndërmjet progresit sipas kapitujve të sundimit të ligjit dhe normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën, nga njëra anë, dhe progresit në negociatat për anëtarësim nëpër kapituj, nga ana tjetër. Serbia duhet t'i vazhdojë dhe t'i përshpejtojë dhe thellojë reformat për pavarësinë e gjyqësorit, luftën kundër korrupsionit, lirinë e medias, trajtimin e brendshëm të krimeve të luftës dhe luftën kundër krimit të organizuar. Në veçanti, autoritetet serbe duhet ta finalizojnë procesin e reformës kushtetuese në fushën e gjyqësorit deri në fund të këtij viti. Progresi i Serbisë në sundimin e ligjit dhe normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën është thelbësor dhe do të vazhdojë ta përcaktojë ritmin e përgjithshëm të negociatave për anëtarësim. Krahas reformave, autoritetet serbe duhet ta vënë theksin më shumë në komunikimin proaktiv dhe objektiv mbi BE-në, i cili është parteri kryesor politik dhe ekonomik i Serbisë.

Komisioni mirëpret faktin që Serbia i ka përmbushur standardet për **hapjen e grupimit 3** (konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse) dhe **grupimit 4** (agjenda e gjelbër dhe konektiviteti i qëndrueshëm). Komisioni mbështet ambicien e Serbisë për të hapur sa më shpejt grupe të reja të aderimit, mbi bazën e progresit të vazhdueshëm të reformave.

18. **Maqedonia e Veriut** vazhdon t'i përmbushë kushtet për **hapjen e negociatave për anëtarësim** dhe autoritetet kanë demonstruar publikisht angazhimin e tyre të vendosur për të avancuar në rrugën e tyre drejt BE-së. Vendi ka mbajtur një ritëm të qëndrueshëm dhe të vendosur në avancimin e reformave të BE-së dhe ka rritur përpjekjet e tij për të dhënë rezultate të mëtejshme të prekshme. Qëndrueshmëria e këtyre reformave strukturore është një proces afatgjatë, i cili kërkon angazhim të vazhdueshëm si nga qeveria ashtu edhe nga opozita, si dhe nga pjesë të tjera të shoqërisë. Maqedonia e Veriut ka vazhduar ta përmirësojë shkallën e përafrimit me politikën e jashtme dhe të sigurisë të BE-së, duke arritur në 96% në muajin gusht të vitit 2021, nga 94% në vitin 2020. Në muajin mars të vitit 2020, anëtarët e Këshillit Evropian miratuan njëzëri vendimin për hapjen e negociatave për anëtarësim me Maqedoninë e Veriut.

Vonesat në nisjen zyrtare të negociatave për anëtarësim po ndikojnë negativisht në kredibilitetin e BE-së. Çështjet dypalëshe të mbetura midis Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut duhet të zgjidhen me prioritet. Komisioni pret dhe thekson rëndësinë e zbatimit të vazhdueshëm të Marrëveshjes së Prespës me Greqinë dhe të Traktatit të Miqësisë, Fqinjësisë së Mirë dhe Bashkëpunimit me Bullgarinë nga të gjitha palët. Në përputhje me konkluzionet e Këshillit, Komisioni ka vazhduar punën e nevojshme përgatitore dhe pret konferencën e parë ndërqeveritare, sa më shpejt që të jetë e mundur pas miratimit të kornizës negociuese nga Këshilli dhe para fundit të këtij viti.

19. **Shqipëria** vazhdon t'i përmbushë kushtet për **hapjen e negociatave për anëtarësim**. Vazhdoi të tregonte **angazhimin** e saj për të avancuar në rrugën drejt BE-së dhe për të dhënë rezultate të prekshme dhe të qëndrueshme në reforma. Zbatimi i reformës gjithëpërfshirëse në drejtësi ka vazhduar. Me emërimin e tre gjyqtarëve të rinj në Gjykatën Kushtetuese, Gjykata rifitoi kuorumin e nevojshëm për mbajtjen e seancave plenare dhe u bë plotësisht funksionale, duke përmbushur kështu kushtin e pazgjidhur për mbajtjen e

IGC-së (Konferencës Ndërqeveritare) të parë. Vendi tani duhet të ruajë angazhimin e tij për agjendën e tij të reformave, duke përfshirë sundimin e ligjit. Shqipëria ka ruajtur përafrimin 100% me politikën e jashtme dhe të sigurisë të BE-së.

Në muajin mars të vitit 2020, anëtarët e Këshillit Evropian miratuan njëzëri vendimin për hapjen e negociatave për anëtarësim me Shqipërinë. Miratimi i Kornizës Negociuese me Shqipërinë dhe mbajtja e Konferencës së parë Ndërqeveritare (IGC) është vonuar. Në përputhje me konkluzionet e Këshillit, Komisioni ka vazhduar punën e nevojshme përgatitore dhe pret konferencën e parë ndërqeveritare, sa më shpejt që të jetë e mundur pas miratimit të kornizës negociuese nga Këshilli dhe para fundit të këtij viti.

20. Në **Bosnje dhe Hercegovinë, angazhimi politik publik** i autoriteteve në të gjitha nivelet e qeverisjes ndaj qëllimit strategjik të integritetit evropian nuk është kthyer në veprim konkret, pasi liderët politikë vazhduan të përfshiheshin në retorikë përçarëse dhe mosmarrëveshje politike jokonstruktive, të cilat kanë penguar në përgjithësi progresin në 14 prioritetet kryesore. Bllokimi i institucioneve shtetërore është një shqetësim i thellë dhe mund të tejkalohet vetëm me dialog politik. Megjithatë, disa hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë për t'i adresuar disa prioritetet kryesore nga Opinioni. Asnjë progres nuk është bërë për sa i përket funksionimit të gjyqësorit. Shenjat e vazhdueshme dhe evidente të përkeqësimit vazhdojnë të kërkojnë masa urgjente për ta forcuar integritetin e gjyqësorit dhe për ta rifituar besimin e qytetarëve. Shkalla e harmonizimit nga Bosnje dhe Hercegovina me politikën e jashtme dhe të sigurisë të BE-së ka rënë në 43% në muajin gusht të vitit 2021, nga 70% në vitin 2020.

Bosnja dhe Hercegovina duhet t'i adresojë **14 prioritetet kryesore** nga Opinioni i Komisionit në muajin maj të vitit 2019 mbi aplikimin e vendit për anëtarësim në BE, në përputhje me Konkluzionet relevante të Këshillit të muajit dhjetor të vitit 2019. Bosnja dhe Hercegovina duhet ta përmirësojë rrënjësisht kornizën e saj legjislative dhe institucionale, duke përfshirë në nivel kushtetues aty ku është e nevojshme, për t'i përmbushur kërkesat për anëtarësim në BE. Akterët politikë dhe institucionet duhet të angazhohen në një dialog transparent dhe gjithëpërfshirës, duke përfshirë këtu reformat zgjedhore dhe kushtetuese për t'i adresuar mangësitë e vjetra zgjedhore. Bosnja dhe Hercegovina do të duhet ta kryejë një masë kritike të reformave përpara se Komisioni të rekomandojë dhënien e statusit të kandidatit për vendin. Përmbushja e 14 prioritetëve kryesore do t'i mundësojë Komisionit ta rekomandojë hapjen e negociatave për praninë në BE.

21. Në **Kosovë**, në përgjithësi, për shkak të ndryshimit të kontekstit politik dhe fokusit në reagimin dhe rimëkëmbjen nga pandemia, është bërë progres i kufizuar në reformat e lidhura me BE-në dhe zbatimin e MSA-së. Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në muajin shkurt të vitit 2021 rezultuan në formimin e një qeverie të re që gëzon shumicën parlamentare. Miratimi i një faze të dytë të Agjendës së Reformës Evropiane (ARE 2) dhe Planit të saj të Veprimit, të miratuar nga Kuvendi në muajin tetor të vitit 2021, konfirmoi **angazhimin e ripërtërirë** të Kosovës ndaj reformave të lidhura me BE-në. Zbatimi i plotë dhe efektiv i planit të veprimit gjatë periudhës së ardhshme do të jetë thelbësor.

Sa i përket normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë, Kosova u angazhua në procesin e Dialogut. Kosova duhet të angazhohet në mënyrë konstruktive dhe të kontribuojë në arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse ligjërish të detyrueshme për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë. Një marrëveshje e tillë është urgjente dhe vendimtare në mënyrë që Kosova dhe Serbia të mund të avancojnë në rrugët e tyre evropiane. Kosova gjithashtu duhet t'i mbështesë dhe zbatojë plotësisht të gjitha marrëveshjet e dialogut të arritura në të kaluarën.

Propozimi i Komisionit për liberalizimin e vizave është ende në pritje në Këshill dhe duhet të trajtohet si çështje urgjente. Komisioni e mbështetë vlerësimin e muajit korrik të vitit 2018 se Kosova ka përmbushur të gjitha standardet për liberalizimin e vizave.

22. Këshilli Evropian deklaroi në mënyrë të përsëritur se BE-ja ka një interes strategjik për një mjedis të qëndrueshëm dhe të sigurt në Mesdheun Lindor dhe në zhvillimin e një marrëdhënieje bashkëpunuese dhe reciprokisht të dobishme me **Turqinë**. Ai përsëriti de-eskalimin e tensioneve në Mesdheun Lindor. BE-ja është gati për t'u angazhuar me Turqinë në faza, në mënyrë proporcionale dhe të kthyeshme për ta rritur bashkëpunimin në një sërë fushash me interes të përbashkët, duke përfshirë bashkëpunimin ekonomik, dialogët e nivelit të lartë për klimën, migracionin, shëndetin publik, luftën kundër terrorizmit dhe çështjet rajonale, forcimin e bashkëpunimit për kontaktet dhe lëvizshmërinë njerëz me njerëzit, me kusht që de-eskalimi aktual të jetë i qëndrueshëm dhe që Turqia të angazhohet në mënyrë konstruktive dhe në varësi të kushteve të përcaktuara në konkluzionet e Këshillit Evropian. Në rast të ripërtëritjes së veprimeve ose provokimeve të njëanshme në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, BE-ja do t'i përdorë të gjitha instrumentet dhe opsionet që ka në dispozicion për t'i mbrojtur interesat e saj dhe të shteteve anëtare.

Turqia pritet t'i mbështesë në mënyrë aktive negociatat për një zgjidhje të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të çështjes së Qipros brenda kornizës së OKB-së, në përputhje me rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe në përputhje me parimet mbi të cilat është themeluar BE-ja. Është e rëndësishme që Turqia ta ripohojë zotimin dhe angazhimin e saj konstruktiv ndaj bisedimeve për zgjidhje të udhëhequra nga Kombet e Bashkuara për Qipron, në përputhje me rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Nuk duhet të ndërmerren veprime të njëanshme që mund t'i rrisin tensionet në ishull dhe ta minojnë kthimin në bisedime. Është urgjente që Turqia ta përmbushë detyrimin e saj për të siguruar zbatimin e plotë dhe jodiskriminues të Protokollit Shtesë të Marrëveshjes së Asociimit BE-Turqi dhe t'i heqë të gjitha pengesat për lëvizjen e lirë të mallrave, përfshirë kufizimet në lidhjet direkte të transportit me Republikën e Qipros.

Ka mangësi serioze në funksionimin e institucioneve demokratike të Turqisë. Shqetësimet serioze të BE-së për përkeqësimin e vazhdueshëm të sundimit të ligjit, të drejtave themelore dhe pavarësisë së gjyqësorit nuk janë adresuar në mënyrë kredibile nga Turqia. Turqia duhet ta kthejë këtë trend negativ si çështje prioritare duke adresuar dobësimin e kontrolleve dhe balancave efektive në sistemin politik. Krerët e BE-së konfirmuan se dialogu mbi sundimin e ligjit dhe të drejtat themelore mbetet një pjesë integrale e marrëdhënieve BE-Turqi.

Deklarata BE-Turqi e muajit mars të vitit 2016 vazhdoi të jepte rezultate dhe Turqia vazhdoi të luante një rol kyç në adresimin e migracionit përgjatë rrugës së Mesdheut Lindor dhe pritjen e popullsisë më të madhe të refugjatëve në botë. Komisioni propozoi që të ndahen 3 miliardë euro ndihmë shtesë për refugjatët dhe komunitetet pritëse në Turqi. Komisioni rikujton rëndësinë e zbatimit të vazhdueshëm të deklaratës duke përfshirë kthimet dhe parandalimin e rrugëve të parregullta të migrimit. BE-ja mirëpret ratifikimin e Marrëveshjes së Parisit për ndryshimet klimatike nga Turqia dhe pret angazhimin me Turqinë për zbatimin e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane. BE-ja dhe Turqia vazhdojnë të përfitojnë nga Unioni Doganor BE-Turqi. Turqia duhet të vazhdojë angazhimin e intensifikuar me Komisionin për t'i trajtuar pengesat e saj tregtare që pengojnë funksionimin normal të Unionit Doganor.

**

VI. SHTOJCAT

- 1. Përmbledhje e gjetjeve të raporteve**
- 2. Të dhëna statistikore**
- 3. Treguesit e palëve të treta në lidhje me statusin e demokracisë, qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit në vendet kandidate dhe kandidatët potencialë**



EUROPEAN
COMMISSION

Strasbourg, 19.10.2021
KOM(2021) 644 final

SHTOJCA

të

KOMUNIKATËS NGA KOMISIONI PËR PARLAMENTIN EVROPIAN, KËSHILLIN, KOMITETIN EKONOMIK DHE SOCIAL EVROPIAN DHE KOMITETIN E RAJONEVE

Komunikatë e vitit 2021 mbi politikën e zgjerimit të BE-së

{DPS(2021) 288 finale} - {DPS(2021) 289 finale} - {DPS(2021) 290 finale} –
{DPS(2021) 291 finale} - {DPS(2021) 292 finale} - {DPS(2021) 293 finale} –
{DPS(2021) 294 finale}

SHQ

SHQ

SHTOJCA 1 - Përmbledhje e gjetjeve të raporteve

Mali i Zi

Sa i përket **kritereve politike**, periudha raportuese u karakterizua nga tensione dhe mosbesim ndërmjet akterëve politikë. Polarizimi i thellë midis shumicës së re qeverisëse dhe opozitës vazhdoi gjatë gjithë vitit 2020 dhe u intensifikua në periudhën paszgjedhore. Marrëdhëniet e nxehta dhe mosbesimi nxitën përshkallëzime të shpeshta dhe përkeqësuan më tej ndarjet politike, duke përfshirë edhe brenda shumicës qeverisëse. Zgjedhjet parlamentare rezultuan me ndryshimin e koalicionit qeverisës dhe transformimin e dinamikës ndërmjet organeve të shtetit dhe treguan nevojën për të gjetur një ekuilibër në peizazhin e ri politik, duke përfshirë çështjet në lidhje me komunitetet fetare dhe përkatësitë etnike, të cilat dominuan agjendën politike gjatë periudhës raportuese. Fërkimi midis pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ ka ngadalësuar punën e reformave. Në muajin dhjetor të vitit 2020, Parlamenti zgjodhi qeverinë e 42-të të Malit të Zi, numri i ministrive u reduktua ndjeshëm. Është qeveria e parë në Mal të Zi e përbërë kryesisht nga ekspertë që nuk janë të lidhur politikisht.

Në raportin e saj përfundimtar për zgjedhjet parlamentare të vitit 2020 nga misioni i kufizuar për vëzhgimin e zgjedhjeve, Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) rekomandoi një reformë gjithëpërfshirëse për ta harmonizuar kornizën ligjore zgjedhore dhe për t'i rregulluar të gjitha aspektet kryesore të zgjedhjeve, përmes një procesi gjithëpërfshirës, para zgjedhjeve të ardhshme. Në muajin dhjetor të vitit 2020, Parlamenti krijoi komisionin për reformën gjithëpërfshirëse zgjedhore, i ngarkuar për t'i kryer reformat legjislative deri në fund të vitit 2021. Progresi ka qenë i ngadaltë për shkak të vonesave fillestare dhe bojkoteve periodike. Parlamenti shkarkoi Kryetarin e Komisionit Shtetëror Zgjedhor (SEC) në muajin qershor të vitit 2021, ku emërimi i një kryetari të ri është ende në pritje në Kuvend. Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të rritur profesionalizmin, transparencën dhe llogaridhënien e SEC-së.

Në vitin 2021 u zhvilluan zgjedhjet lokale në dy komuna. Pavarësisht marrëveshjes ndërpartiake për t'i mbajtur të gjitha zgjedhjet vendore në të njëjtën ditë, korniza ligjore ende parashikon zhvillimin e tyre në baza rotative, duke çuar në një fushatë pothuajse të vazhdueshme parazgjedhore në nivel kombëtar dhe lokal. Mbetet për t'u siguruar një përgjigje institucionale e besueshme, e pavarur dhe efektive ndaj të ashtuquajturës “afëra zarfi”.

Mungesa e angazhimit konstruktiv të të gjithë akterëve parlamentarë pengoi një dialog politik kuptimplotë, duke polarizuar më tej peizazhin politik. Bojkoti i seancave plenare nga shumica e deputetëve, nga opozita dhe shumica qeverisëse shkaktoi një pezullim të vendimmarrjes në Parlament në vitin 2021. Parlamenti përmirësoi transparencën e punës së tij, duke komunikuar me publikun dhe rriti rolin e tij legjislativ dhe mbikëqyrës në përgjithësi.

Shumica qeverisëse shpesh inicioi ose miratoi legjislacionin përmes procedurës së shpejtë, pa konsultime të nevojshme publike dhe pa marrë parasysh siç duhet kërkesat për anëtarësim në BE. Parlamenti duhet të demonstrojë ende në praktikë përkushtimin e tij ndaj agjendës së reformës së BE-së të Malit të Zi dhe ta përmirësojë koordinimin me qeverinë për nismat legjislative. Parlamenti duhet ta forcojë kapacitetin profesional dhe ekspert të stafit të tij administrativ dhe ta përmirësojë përfaqësimin politik të grave.

Përbërja e Parlamentit aktual është e paprecedentë në historinë e Malit të Zi. Ajo duhet të përpiqet të gjejë një konsensus të gjerë ndërpartiak dhe shoqëror për reformat e lidhura me BE-në, gjë që është jetike për vendin që të bëjë progres në rrugën e tij drejt BE-së. Është e qartë se pjesëmarrja aktive dhe konstruktive nga të gjitha palët kërkohet për të rritur llogaridhënien parlamentare, mbikëqyrjen e ekzekutivit, kontrollin demokratik, për ta përmirësuar cilësinë e legjislacionit dhe për emërimet kyçe. Deri më tani, Kuvendi nuk ka mundur të sigurojë shumicën e kërkuar prej 2/3 për emërimet të

rëndësishme në gjyqësor dhe për këtë arsye funksionet kyçe të sistemit gjyqësor janë ende të plotësuara me ushtrues të detyrës.

Për sa i përket **qeverisjes**, ekziston nevoja për ta forcuar pjesëmarrjen e akterëve dhe kapacitetin e qeverisë për t'i zbatuar reformat. Në muajin dhjetor të vitit 2020, Parlamenti zgjodhi qeverinë e 42-të të Malit të Zi. Numri i ministrive u reduktua në 12; gratë kryesojnë katër prej tyre. Përbërja e re e qeverisë është qeveria e parë eksperte në Mal të Zi, vetëm postin e zëvendëskryeministrit e mban një lider partie politike. Qeveria miratoi gjithashtu një program të ri kombëtar për anëtarësimin në BE për periudhën 2021-2023. Struktura e negociatave u dobësua ndjeshëm nga dorëheqja ose shkarkimi i 110 anëtarëve të saj, duke përfshirë 16 negociatorë të kapitujve dhe 24 kryetarë të grupeve punuese. Shumica e këtyre pozitave kyçe mbeten vakante. Disa ministri kryesore nuk arritën të tregonin përkushtim të mjaftueshëm dhe angazhim konstruktiv në procesin e anëtarësimit në BE nën udhëheqjen e tyre të re.

Roli i **shoqërisë civile** njihet dhe promovohet, megjithatë korniza aktuale ligjore dhe institucionale duhet të përmirësohet më tej për t'i forcuar mekanizmat e konsultimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile në kontekstin e procesit të anëtarësimit në BE.

Mali i Zi është mesatarisht i përgatitur për reformën e **administratës së tij publike**. Në përgjithësi, është bërë progres i kufizuar në periudhën raportuese. Ndryshimi i qeverisë dhe i shumicës parlamentare preku rëndë shërbimin civil: ndryshimet në ligjin për nëpunësit civilë dhe punonjësit shtetërorë ulën kërkesat për kompetencë, pavarësi dhe rekrutim të bazuar në merita të nëpunësve civilë. Për më tepër, riorganizimet e fundit të administratës publike çuan në ndryshime thelbësore të stafit, duke përfshirë në nivele të larta, duke rrezikuar kapacitetin e Malit të Zi për të mbajtur staf me përvojë në çështjet që lidhen me procesin e anëtarësimit në BE në shumë sektorë. Nevojitet një vullnet i fortë politik për ta depolitizuar në mënyrë efektive shërbimin publik, për ta optimizuar administratën shtetërore dhe për ta zbatuar llogaridhënien menaxheriale.

Mali i Zi mbetet mesatarisht i përgatitur për ta zbatuar *acquis* të BE-së dhe standardet evropiane në fushën e **gjyqësorit dhe të drejtave themelore** dhe ka bërë përparim të kufizuar në përgjithësi, me regjistër të rasteve të kufizuar në llogaridhënie. Nuk është bërë progres në fushën e gjyqësorit dhe zbatimi i reformave kyçe në drejtësi është duke ngecur. Angazhimi vendimtar politik i nevojshëm për të zhbllokuar segmente të rëndësishme të atyre reformave është ende i pazgjidhur, me një numër emërimesh në gjyqësor që mbeten pezull në Parlament për shkak të pamundësisë për të siguruar një shumicë të kualifikuar. Pavarësisht një qasjeje më proaktive të Agjencisë Kundër Korrupsionit, korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe kjo është një çështje shqetësuese. Për të drejtat themelore, Mali i Zi vazhdoi t'i përmbushë detyrimet që dalin nga instrumentet dhe legjislacioni ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Megjithatë mbeten sfida në sigurimin e zbatimit efektiv të legjislacionit kombëtar për të drejtat e njeriut. Ka pasur progres të kufizuar në fushën e lirisë së shprehjes.

Mali i Zi ka arritur një nivel të vogël të përgatitjes në **luftën kundër korrupsionit**. Ai bëri progres të kufizuar, me rekomandimet e vitit të kaluar që u përmbushën pjesërisht në lidhje me rezultatet e mëtejshme në regjistrat e rasteve mbi represionin dhe parandalimin e korrupsionit dhe përpjekjet e Agjencisë Kundër Korrupsionit për t'i adresuar sfidat e saj. Regjistri i sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive duhet të përmirësohet më tej. Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) nën menaxhimin e ri demonstroi një qasje më proaktive, veçanërisht në rritjen e aktiviteteve të saj të komunikimit dhe kontaktimit me publikun e gjerë, median dhe shoqërinë civile dhe në adresimin e ngarkesës së rasteve në pritje nga vitet e mëparshme. Përkundër këtij trendi pozitiv, sfidat që lidhen me pavarësinë e Agjencisë, përcaktimin e prioritetëve, qasjen selektive dhe cilësinë e vendimeve të saj mbeten dhe kërkojnë përpjekje të vazhdueshme në këtë drejtim. Korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha. Ekziston nevoja për vullnet të fortë politik për ta trajtuar në mënyrë efektive këtë çështje, si dhe një përgjigje të fortë të drejtësisë penale ndaj korrupsionit të nivelit të lartë.

Mali i Zi ka nivel të përgatitjes/është e përgatitur mesatarisht në **luftën kundër krimit të organizuar**. Ai bëri progres të lehtë në adresimin e rekomandimeve të vitit të kaluar, veçanërisht në përmirësimin e qasjes për agjencitë e zbatimit të ligjit në bazat kryesore të të dhënave dhe rritjen e numrit të hetuesve dhe ekspertëve në fushat kryesore. Numri i rasteve të krimit të organizuar të hetuara dhe ndjekur penalisht vazhdoi të rritet dhe numri i rasteve të gjykuara në gjykata pothuajse u trefishua. Bashkëpunimi ndërkombëtar policor është krijuar mirë dhe ka vazhduar të japë rezultate, me konfiskim të paprecedentë të drogës jashtë vendit. Megjithatë, kapaciteti për ta trajtuar kontrabandën e duhanit dhe pastrimin e parave nuk është ende në nivelin e pritur. Mali i Zi ende duhet t'i adresojë disa mangësi sistemike në sistemin e tij të drejtësisë penale, duke përfshirë mënyrën se si trajtohen rastet e krimit të organizuar në gjykata.

Sa i përket të **drejtave themelore**, Mali i Zi ka në masë të madhe kornizë legislative dhe institucionale dhe ka bërë progres të lehtë në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në instrumentet dhe legjislacionin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Megjithatë, sfidat mbeten në zbatimin efektiv. Efikasiteti i hetimeve për përdorimin e tepruar të forcës nga organet e zbatimit të ligjit dhe krimet e urrejtjes duhet të përmirësohet më tej. Grupet e cenueshme, përfshirë romët dhe egjiptianët, dhe personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përjetojnë forma të shumta diskriminimi dhe vështirësi në zbatimin e të drejtave të tyre në procedurat administrative dhe gjyqësore. Gratë vazhdojnë të përjetojnë pabarazi në pjesëmarrjen në jetën politike dhe publike dhe qasjen në mundësitë e punësimit dhe ekonomike. Dhuna me bazë gjinore dhe dhuna ndaj fëmijëve mbeten çështje shqetësuese serioze. Incidentet e sulmeve me motive etnike dhe fetaret, krimet e urrejtjes dhe gjuha e urrejtjes vazhduan të rriteshin. Mali i Zi i ka adresuar vetëm pjesërisht rekomandimet e vitit të kaluar. Qasja në drejtësi, veçanërisht për grupet e cenueshme, mbetet për t'u përmirësuar. Ndryshimet në ligjin për lirinë e besimit fetar u miratuan pas konsultimeve të kufizuara dhe jo plotësisht gjithëpërfshirëse me bashkësitë fetare.

Mali i Zi ka arritur një nivel të përgatitjes në fushën e **lirisë së shprehjes**. Në përgjithësi, ai ka bërë progres të kufizuar gjatë periudhës raportuese dhe ka adresuar vetëm pjesërisht rekomandimet e vitit të kaluar. Ka pasur disa zhvillime të reja në hetimin e vrasjes së një gazetari hetues në vitin 2018, por mbetet për t'u siguruar një ndjekje e plotë dhe efektive gjyqësore si për këtë rast ashtu edhe për raste të tjera të rëndësishme të vjetra. Në muajin prill të vitit 2021, qeveria krijoi një komision të ri ad hoc për monitorimin e dhunës ndaj medias, por ende nuk i ka adresuar plotësisht ose në mënyrë efektive rekomandimet e rëndësishme të bëra nga komisioni i mëparshëm. Një rishikim i kornizës ligjore është në vazhdim e sipër, për t'i adresuar çështjet shpesh të identifikuara në ligjin e vitit 2020 për median dhe ligjin për transmetuesin publik RTCG, për ta plotësuar atë me një ligj të ri për mediat audio-vizuale dhe për ta siguruar përafrimin e tyre të plotë me *acquis* të BE-së dhe standardet evropiane. Kërkohen më shumë përpjekje për t'i kufizuar efektet e dezinformimit dhe ngacmimit në internet dhe gjuhës së urrejtjes, duke siguruar që masa të tilla të mos kufizojnë në mënyrë disproporcionale lirinë e shprehjes. Parlamenti emëroi Këshillin e ri të RTCG në muajin qershor të vitit 2021 pa mbështetje të gjerë ndërpartiake. Pas këtij ndryshimi dhe ndryshimeve të mëvonshme të menaxhmentit të RTCG, transmetuesi publik filloi të shfaqte përmbajtje politikisht më të larmishme. Skena mediatike në përgjithësi mbetet shumë e polarizuar, shpesh e shënuar nga raportime të njëanshme politike dhe të pabalancuara, duke përfshirë përfshirjen e gjerë të mediave të huaja nga rajoni, e cila ishte veçanërisht e dukshme gjatë periudhave zgjedhore. Mekanizmat vetërregullues mbeten të dobët.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, Mali i Zi ka bërë progres dhe është mesatarisht i përgatitur në zhvillimin e një **ekonomie funksionale të tregut**. Vendi përjetoj një recesion të mprehtë në vitin 2020 pasi pandemia COVID-19 shkaktoi dëm të madh në ekonominë e tij të varur nga turizmi. Kjo krijoi efekte të mëdha negative në konsumin privat, investimet, punësimin, tregtinë dhe financat publike. Për t'i mbështetur qytetarët dhe ekonominë, autoritetet zbatuan disa pako të mbështetjes ekonomike. Këto masa ishin, në një masë të madhe, të synuara mirë, transparente dhe të një karakteri të përkohshëm. Pavarësisht disa vonesave për shkak të pandemisë, qeveria vazhdoi zbatimin e disa prej reformave të parashikuara për përmirësimin e mjedisit të biznesit. Tranzicioni i rregullt i qeverisë në mes të krizës ruajtiti efektivitetin e politikës për përgjigje ndaj COVID-19. Qeveria e re arriti t'i zbusë rreziqet fiskale

duke grumbulluar buferë të konsiderueshëm fiskalë për t'i mbuluar nevojat e financimit të vitit 2021, duke përfshirë programet shtesë të mbështetjes për COVID-19. Sektori financiar mbeti i qëndrueshëm gjatë krizës, si rezultat i pozicionit të tij të fortë para krizës dhe masave mbështetëse të zbatuara nga autoritetet, por ndikimi i vonuar i krizës në bilancet bankare kërkon monitorim të ngushtë të institucioneve financiare.

Mali i Zi ka bërë progres dhe është mesatarisht i përgatitur për ta **përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së**. Pandemia e COVID-19 tregoi se mungesa e diversifikimit e bën ekonominë e Malit të Zi të varur nga turizmi shumë të ndjeshme ndaj goditjeve. Janë bërë disa përpjekje për t'i përmirësuar kapacitetet për inovacion dhe për t'i futur standardet e BE-së në kompanitë vendore falë granteve publike, por këto mbeten modeste duke pasur parasysh shkallën e sfidës. Cilësia e sistemit arsimor dhe preferencat e kurrikulave duken joadekuate për ta rritur kapitalin njerëzor dhe për t'i adresuar mospërputhjet e aftësive. Infrastruktura moderne e telekomunikacionit dhe energjisë është duke u vendosur me shpejtësi, por ka një deficit të konsiderueshëm në infrastrukturën e transportit, duke penguar integrimin me tregjet rajonale dhe të BE-së. Përveç kësaj, niveli i ulët i sofistikimit të produkteve vendase, kompanitë vendore të vogla dhe niveli i ulët i pjesëmarrjes në tregjet e jashtme paraqet pengesa të mëdha për rritjen e konkurrueshmërisë dhe diversifikimit të ekonomisë.

Sa i përket **marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe bashkëpunimit rajonal**, Mali i Zi mbeti i përkushtuar në mënyrë konstruktive për marrëdhëniet dypalëshe me vendet e tjera të zgjerimit dhe shtetet anëtare fqinje të BE-së, ndonëse marrëdhëniet dypalëshe me Serbinë u prishën nga tensionet, me rritjen e retorikës nacionaliste. Mali Zi është përgjithësisht pjesëmarrës aktiv në bashkëpunimin rajonal.

Lidhur me **aftësinë** e Malit të Zi për t'i **marrë përsipër detyrimet për anëtarësim**, punë e rëndësishme për përafrimin dhe përgatitjen për zbatimin e *acquis* të BE-së është bërë në shumë fusha, megjithëse me një ritëm më të ngadaltë se më parë.

Grupimi i **tregut të brendshëm** është kyç për përgatitjet e Malit të Zi për t'i përmbushur kërkesat e tregut të brendshëm të BE-së dhe është me rëndësi të lartë për masat e mundshme të integritit të hershëm dhe zhvillimin e tregut të përbashkët rajonal. Është arritur progres në mbikëqyrjen, akreditimin dhe standardizimin e tregut; parakushtet legjislative të regjistrimit elektronik të shoqërive tregtare; parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit; ligjin për shoqëritë tregtare; ndihmën shtetërore dhe transparencën e ndihmës; shërbimet bankare; mbrojtje e konsumatorit dhe shëndetit. Mali i Zi tani duhet të fokusohet në: përafrimin me *acquis* të BE-së që rregullon metrologjinë dhe standardizimin, zhvillimin e kapaciteteve operacionale të Agjencisë së Punësimit; profesionet e rregulluara, lëvizjet e kapitalit dhe pagesat, duke përfshirë përvetësimin e të drejtave pronësore, largimin në faza të skemës së shtetësisë së investitorit; ligjin e shoqërive tregtare dhe kontabilitetin e korporatave; pronën intelektuale; konkurrencën dhe ndihmën shtetërore; mbrojtjen e konsumatorit dhe mbrojtjen e shëndetit dhe zbatimin e ligjeve në përputhje me kërkesat për kapital nën *acquis* të BE-së në sektorin bankar.

Grupimi i **konkurrencës dhe rritjes gjithëpërfshirëse** ka lidhje të rëndësishme me Programin e Reformës Ekonomike të Malit të Zi. Është bërë progres në kontrollin e duhanit; pensionet; politikat industriale, specializimin e mençur, arsimin dhe aftësimin profesional dhe lehtësimin e tregtisë. Për politikën ekonomike dhe monetare, puna për zbatimin e planit të veprimit për përafrimin me *acquis* të BE-së është në vazhdim e sipër. Mali i Zi tani duhet të fokusohet në: pavarësinë e sektorit të medias; koordinimin e TVSH-së, akcizave dhe tatimeve direkte për çështjet ekonomike dhe monetare; ligjin e punës dhe ligjin kundër diskriminimit, sigurinë në punë; politikat industriale, kërkimin dhe inovacionin, arsimin dhe trajnimin dhe sistemin e kompjuterizuar të transitit në pajtim me BE-në.

Grupimi për **agjendën e gjelbër dhe konektivitetin e qëndrueshëm** ka lidhje të rëndësishme me Programin e Reformës Ekonomike të Malit të Zi, Planin Ekonomik dhe të Investimeve të Komisionit dhe Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Është bërë progres në krijimin e një tregu energjie

një ditë përpara (ang. a day-ahead); Strategjinë e Zhvillimit të Transportit, mbrojtjen e natyrës dhe Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës. Mali i Zi tani duhet të fokusohet në: sektorin e energjisë; Rregulloret e rrjeteve trans-evropiane, telekomunikacionin, TEN-T dhe TEN-E; tranzicionin e gjelbër, menaxhimin e mbeturinave, cilësinë e ujit, mbrojtjen e natyrës dhe ndryshimet klimatike.

Grupimi i **burimeve, bujqësisë dhe kohezionit** përfshin politika të lidhura me fondet strukturore dhe fondet e investimeve të BE-së dhe zhvillimin e kapaciteteve për të marrë përgjegjësitë e një shteti të ardhshëm anëtar të BE-së. Është bërë progres në bujqësi, ushqim dhe peshkim, politikë rajonale dhe instrumente strukturore, dispozita financiare dhe buxhetore dhe menaxhim të burimeve vetanake. Mali i Zi tani duhet të fokusohet në: zbatimin e programit IPARD, bujqësinë dhe zhvillimin rural, si dhe peshkimin, përmirësimin e stabilimenteve ushqimore dhe kontrolleve të sigurisë ushqimore, kërkesat e politikës së kohezionit të BE-së, kapacitetin për trajtimin e programeve të menaxhimit indirekt në IPA dhe rregullat e administrimit për sistemin e burimeve vetanake.

Sa i përket grupimit të **marrëdhënieve të jashtme**, Mali i Zi vazhdoi të përafrohet plotësisht me të gjitha qëndrimet, deklaratat për CFSP-në e BE-së dhe qëndrimet e përbashkëta të BE-së. Ai gjithashtu vazhdoi të zbatojë veprime në tregun e përbashkët rajonal bazuar në rregullat e BE-së, duke përfshirë bashkëpunimin brenda CEFTA-s dhe Këshillit për Bashkëpunim Rajonal. Përafrimi me integritetin e Statutit të Romës do të lejonte mbylljen e përkohshme të kapitullit 31 të mbetur të hapur nën këtë grupim.

Forcimi i **kapaciteteve administrative** për ta zbatuar *acquis* të BE-së mbetet një sfidë e rëndësishme për Malin e Zi, duke përfshirë nevojën urgjente për të rindërtuar një strukturë funksionale negociuese.

Sa i përket **migracionit**, migrimi i ligjshëm dhe i parregullt ra ndjeshëm në vitin 2020 në sfondin e pandemisë COVID-19. Ardhja e emigrantëve të parregullt ka rënë me 60% krahasuar me vitin 2019, me 3149 emigrantë të kapur në vitin 2020. Prokuroria Speciale ka kryer dy hetime për kontrabandimin e emigrantëve në vitin 2020. Në një rast janë shqiptuar dënime të formës së prerë për tetë persona. Megjithëse kapaciteti i Malit të Zi për t'i menaxhuar flukset e përziera të migracionit dhe integrimin e refugjatëve po përmirësohet, nevojiten përpjekje të vazhdueshme në mënyrë që vendi të përballet me presionin e emigrantëve, duke rritur më tej kapacitetin e tij të pritjes dhe duke ngritur standardet në qendrat e pritjes. Kjo do të përfshijë gjithashtu zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit të saj ndërkombëtar për ripranimin, mbështetjen e riintegrimit të suksesshëm të të kthyerve, rritjen e kapacitetit për ndjekjen penale të rrjeteve të kontrabandës së emigrantëve dhe krijimin e një sistemi modern për mbledhjen e të dhënave për emigrantët.

Serbia

Sa i përket **kritereve politike**, parlamenti serb dhe forcat politike vazhduan të angazhohen në dialogun ndërpartiak të udhëhequr nga Parlamenti Evropian, me synimin për të krijuar konsensus të gjerë ndërpartiak mbi reformat në lidhje me BE-në, të cilat janë jetike për progresin e vendit në rrugën e tij drejt BE-së. Megjithatë, klima politike gjatë periudhës raportuese mbeti e polarizuar. Që procesi të jetë i suksesshëm, të gjithë akterët politikë duhet të angazhohen në mënyrë konstruktive dhe me mirëbesim dhe t'i zbatojnë masat e identifikuar në muajin shtator të vitit 2021 nga bashkëndërmjetësuesit nga Parlamenti Evropian dhe ai serb gjatë dialogut ndërpartiak.

Për zgjedhjet, Serbia filloi t'i adresojë rekomandimet e kahershme të Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE/ODIHR) dhe qeveria rivendosi grupin përkatës punues për zgjedhjet. Të gjitha rekomandimet kryesore duhet të zbatohen në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente, bazuar në konsensus më të gjerë politik dhe shumë përpara zgjedhjeve të ardhshme.

Mandati i Parlamentit serb, i cili u konstituua zyrtarisht në muajin gusht të vitit 2020, ka qenë i kufizuar në kohë që nga fillimi, pasi udhëheqja politike shpalli zgjedhje të reja që do të mbahen deri në pranverën e vitit 2022. Në përgjithësi, Parlamenti reduktoi ndjeshëm përdorimin e procedurave urgjente dhe miratoi një kod të ri të sjelljes për deputetët. Megjithatë, gjuhë nxitëse kundër

kundërshtarëve politikë dhe përfaqësuesve të institucioneve të tjera që shprehin pikëpamje të ndryshme politike u përdor ende gjatë debateve parlamentare. Të gjithë politikanët duhet ta kundërshtojnë gjuhën e urrejtjes dhe të kontribuojnë në një dialog politik mbi reformat e lidhura me BE-në, veçanërisht mbi bazat e demokracisë dhe sundimit të ligjit.

Ministria e sapokrijuar për të drejtat e njeriut dhe të pakicave dhe dialogun social inicioi një sërë dialogë publikë. Megjithatë, nevojiten ende përpjekje të mëtejshme për të siguruar bashkëpunim sistematik ndërmjet qeverisë dhe **shoqërisë civile**. Një mjedis mundësues për zhvillimin dhe financimin e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) ende duhet të krijohet në terren, pasi sulmet verbale kundër OSHC-ve vazhduan, duke përfshirë edhe në Parlament.

Serbia është mesatarisht e përgatitur në fushën e **reformës së administratës publike**. Në përgjithësi është bërë progres i kufizuar gjatë periudhës raportuese. Serbia ende duhet të sigurojë (i) rekrutim të bazuar në merita dhe reduktim të numrit të tepërt të pozitave të ushtruesve të detyrës të menaxherëve të lartë, (ii) një rol të fortë kontrolli të cilësisë për Sekretariatën e Politikave Publike në zhvillimin dhe koordinimin e politikave, dhe (iii) një mekanizëm të vetëm për prioritizimin e të gjitha investimeve pavarësisht nga lloji dhe burimi i financimit.

Sistemi gjyqësor i Serbisë ka nivel të përgatitjes. Është bërë progres i kufizuar gjatë periudhës raportuese. Reforma kushtetuese e gjyqësorit ka rifilluar në muajin dhjetor të vitit 2020 dhe është planifikuar të finalizohet deri në fund të vitit 2021. Sistemi për emërimet në drejtësi dhe për vlerësimin e punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet të rishikohet tërësisht pas miratimit të amendamenteve në kushtetutë, për të mundësuar rekrutime dhe karriera në sektorin gjyqësor të bazuara në merita, pasi korniza ligjore aktuale nuk ofron garanci të mjaftueshme kundër ndikimit të mundshëm politik mbi gjyqësorin.

Serbia ka një nivel përgatitjeje në **luftën kundër korrupsionit**. Është bërë progres i kufizuar gjatë periudhës raportuese. Për sa i përket parandalimit të korrupsionit, Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit të Këshillit të Evropës (GRECO) arriti në përfundimin se rekomandimi i tij për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit ishte përmbushur në mënyrë të kënaqshme. Ky rekomandim kishte të bënte me nevojën për një shkallë adekuate të pavarësisë dhe burimeve financiare dhe të personelit, si dhe për zgjerimin e kompetencave të Agjencisë. Serbia duhet të miratojë ende një strategji të re kundër korrupsionit të shoqëruar me një plan veprimi dhe të krijojë një mekanizëm efektiv koordinues për t'i funksionalizuar qëllimet e politikave të parandalimit ose shtypjes dhe për ta trajtuar në mënyrë efektive korrupsionin. Numri i aktakuzave dhe numri i dënimeve në shkallë të parë për rastet e korrupsionit të nivelit të lartë është ulur më tej në krahasim me vitet e kaluara. Serbia duhet t'i rrisë përpjekjet për adresimin e këtyre mangësive dhe ta rrisë parandalimin dhe represionin e korrupsionit.

Në **luftën kundër krimit të organizuar**, Serbia ka nivel të përgatitjes. Është bërë progres i kufizuar gjatë periudhës raportuese. Serbia nuk ka krijuar ende regjistër bindës të rasteve të hetimeve efektive, ndjekjeve penale dhe dënimeve përfundimtare në rastet e krimit të rëndë dhe të organizuar, duke përfshirë hetimet financiare që çojnë në një regjistër të rasteve të ngrirjes dhe konfiskimit të pasurive kriminale. Numri i dënimeve për krim të organizuar është ulur në krahasim me vitin 2019. Serbia duhet ta përshtatë qasjen e saj nga ajo e bazuar në raste në një strategji kundër organizatave dhe nga fokusimi në rastet e rëndësisë së ulët ose të mesme në rastet e profilit të lartë që synojnë shuarjen e organizatave të mëdha dhe të përhapura ndërkombëtarisht dhe sekuestrimin e pasurisë.

Serbia ka kornizë të gjerë legjislativë dhe institucionale për mbrojtjen e të **drejtave themelore**. Megjithatë, duhet të sigurohet që korniza të zbatohet në mënyrë konsistente dhe efikase. Institucionet e të drejtave të njeriut duhet të forcohen dhe të garantohet pavarësia e tyre, duke përfshirë shpërndarjen e burimeve të nevojshme financiare dhe njerëzore. Për sa i përket **lirisë së shprehjes**, është bërë progres i kufizuar duke miratuar dhe filluar zbatimin e një numri të kufizuar masash sipas planit të veprimit në lidhje me strategjinë e medias. Megjithatë, sulmet verbale kundër gazetarëve nga zyrtarë të nivelit të lartë vazhduan dhe rastet e kërcënimeve dhe dhunës mbeten shqetësuese. Shumica e shoqatave të medias u tërhoqën nga grupi për sigurinë e gazetarëve në muajin mars të vitit 2021, duke përmendur

gjuhën e urrejtjes dhe fushatat e shpifjeve kundër gazetarëve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, përfshirë nga kreu i grupit parlamentar të partisë në pushtet në Parlament. Këto sulme verbale në Parlament ndodhën edhe pas miratimit të kodit të sjelljes në muajin dhjetor të vitit 2020. Mjedisi i përgjithshëm për ushtrimin pa pengesa të lirisë së shprehjes duhet të forcohet më tej në praktikë.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, Serbia ka bërë progres të lehtë dhe është mesatarisht e përgatitur/në një nivel të mirë përgatitjeje në **zhvillimin e një ekonomie funksionale të tregut**. Ekonomia serbe regjistroi vetëm një tkurrje të lehtë në vitin 2020 pasi ndikimi i krizës nga COVID-19 u zbut nga një momentum i fortë para krizës, gjegjësisht masa të konsiderueshme dhe në kohë të mbështetjes fiskale dhe monetare, struktura sektoriale e ekonomisë dhe rreptësia mesatare relativisht e ulët e masave të kontrollit. Disbalancat e jashtme u ngushtuan në krizë, ndërkohë që financimi i tyre vazhdoi të mbulohej plotësisht nga flukset hyrëse të Investimeve të Huaja Direkte (IHD). Hapësira fiskale e krijuar para krizës i mundësoi Serbisë të sigurojë mbështetje të konsiderueshme fiskale për zbutjen e krizës në vitin 2020 dhe 2021 dhe t'i rrisë ndjeshëm shpenzimet kapitale. Stabiliteti i sektorit bankar u ruajt dhe rritja e kreditimit ishte e fortë, mbështetur nga lehtësimi monetar, moratoriumet e kredive dhe masat për rritjen e likuiditetit. Tregu i punës ka regjistruar një ulje të mëtejshme të papunësisë në vitin 2020, duke reflektuar veçanërisht përqindjet më të ulëta të pjesëmarrjes gjatë krizës.

Është bërë progres i lehtë me reformat e administratës tatimore dhe privatizimin e bankave shtetërore. Megjithatë, reformat e tjera të mëdha strukturore të administratës publike dhe Ndërmarrjeve Shtetërore (NSH) vazhduan të përparojnë ngadalë, duke zgjatur joefikasitetin afatgjatë. Nuk ka pasur progres në forcimin e rregullave fiskale për ta ankoruar politikën fiskale. Shteti ruan një gjurmë të fortë në ekonomi dhe sektori privat është i pazhvilluar dhe i penguar nga dobësitë në sundimin e ligjit, në veçanti korrupsioni dhe joefikasiteti gjyqësor, dhe në zbatimin e konkurrencës së ndershme.

Serbia ka bërë progres të lehtë dhe është mesatarisht e përgatitur për t'u **përballur me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së**. Struktura e ekonomisë u përmirësua më tej dhe integrimi ekonomik me BE-në mbeti i lartë. Megjithatë, pavarësisht se është bërë progres i lehtë, cilësia dhe rëndësia e arsimit dhe aftësimin nuk i plotëson plotësisht nevojat e tregut të punës. Investimet publike kanë vazhduar të rriten me synimin për t'i adresuar boshllëqet serioze në infrastrukturë pas viteve të investimit të pamjaftueshëm. Megjithëse kostoja e huamarrjes për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) ka rënë, ato ende përballen me një sërë sfidash, duke përfshirë një mjedis të paqëndrueshëm biznesi dhe konkurrencë të pandershme.

Sa i përket **marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit rajonal**, Serbia në përgjithësi mbeti e përkushtuar ndaj marrëdhënieve dypalëshe me vendet e tjera të zgjerimit dhe shtetet anëtare fqinje të BE-së. Megjithatë, marrëdhëniet me Malin e Zi janë shënuar nga tensione të vazhdueshme. Në përgjithësi, Serbia merr pjesë në mënyrë aktive në bashkëpunimin rajonal.

Sa i përket **normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën**, dialogu i ndërmjetësuar nga BE-ja ka vazhduar me takime të nivelit të lartë më 15 qershor dhe 19 korrik 2021, si dhe me tri takime të kryenegociatorëve. Gjatë periudhës raportuese, të dyja palët emëruan kryenegociatorë dhe ekipe të reja negociuese. Serbia duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme thelbësore për zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të kaluara dhe të kontribuojë në arritjen e një marrëveshjeje ligjërish të detyrueshme gjithëpërfshirëse të normalizimit me Kosovën. Një marrëveshje e tillë është urgjente dhe vendimtare në mënyrë që Kosova dhe Serbia të mund të avancojnë në rrugët e tyre evropiane.

Lidhur me **aftësinë e Serbisë për t'i marrë përsipër detyrimet për anëtarësim në BE**, vendi ka kryer punë të rëndësishme në përafrimin me *acquis* të BE-së në shumë fusha, veçanërisht në tatimet dhe energjinë.

Grupimi për **tregun e brendshëm** është kyç për përgatitjet e Serbisë për përmbushjen e kërkesave të tregut të brendshëm të BE-së dhe është shumë e rëndësishme për masat e mundshme të integritetit të hershëm dhe zhvillimin e tregut të përbashkët rajonal. Është bërë progres në përafrimin legjislativ për ligjin e shoqërive tregtare, lirinë e lëvizjes për punëtorët dhe krijimin dhe lirinë për të ofruar shërbime.

Megjithatë, nuk është bërë progres në fushat e lëvizjes së lirë të kapitalit, shërbimeve financiare dhe mbrojtjes së konsumatorëve dhe shëndetit.

Grupimi për **konkurrueshmërinë dhe rritjen gjithëpërfshirëse** ka lidhje të rëndësishme me Programin e Reformës Ekonomike të Serbisë. Është bërë progres në fushat e tatimit, politikës sociale dhe punësimit, politikës industriale, zhvillimit shkencor dhe teknologjik dhe arsimit. Sa i përket tatimit, politikës sociale dhe punësimit, Serbia ka përmbushur gjithashtu pika referente fillestare. Megjithatë, nuk është bërë progres në forcimin e rregullave fiskale për ta ankoruar politikën fiskale.

Grupimi për **agjendën e gjelbër dhe konektivitetin e qëndrueshëm** është në qendër të Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor të miratuar nga Serbia në muajin nëntor të vitit 2020 dhe e lidhur ngushtë me Programin e Reformës Ekonomike të Serbisë dhe Planin Ekonomik dhe të Investimeve të Komisionit. Serbia i ka përmbushur pikat referente fillestare për energjinë. Vendi ka bërë progres në sigurinë rrugore dhe reformën hekurudhore. Ai miratoi gjithashtu një ligj për klimën, si dhe një pako ligjesh kryesore për energjinë, duke përfshirë ligje të reja për burimet e ripërtërishme dhe eficiencën e energjisë.

Grupimi për **burimet, bujqësinë dhe kohezionin** përfshin politika të lidhura me fondet strukturore të BE-së dhe me zhvillimin e kapaciteteve për të marrë përgjegjësitë e një shteti anëtar të ardhshëm. Ai gjithashtu përfshin disa nga fushat kyçe të politikave thelbësore për sigurimin e sistemeve të qëndrueshme ushqimore dhe për t'i ndihmuar komunitetet rurale të zhvillohen dhe të diversifikohen ekonomikisht. Serbia ka bërë progres në sigurinë ushqimore duke rekrutuar staf në laboratorët kombëtarë të referencës dhe duke hartuar një plan veprimi për peshkimin; në aspektin financiar dhe buxhetor për sa i përket menaxhimit të burimeve vetanake; dhe në politikën rajonale për sa i përket menaxhimit financiar.

Sa i përket grupimit për **marrëdhëniet e jashtme**, modelet e përgjithshme të Serbisë në përafrimin me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së mbetën përgjithësisht të pandryshuara. Një sërë veprimesh nga Serbia ishin në kundërshtim me qëndrimet e BE-së për politikën e jashtme. Në vitin 2020, shkalla e përafrimit të Serbisë me deklaratat përkatëse të Përfaqësuesit të Lartë në emër të Vendimeve të BE-së dhe Këshillit ishte 56%, por u rrit në 61% që nga muaji gusht i vitit 2021. Serbia vazhdoi të marrë pjesë në misionet dhe operacionet e BE-së për menaxhimin e krizave nën politikën e përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes. Nuk u arrit asnjë progres konkret drejt finalizimit të negociatave për anëtarësim me Organizatën Botërore të Tregtisë.

Serbia vazhdoi të ndihmojë ndjeshëm në menaxhimin e flukseve të përziera të **migracionit** drejt BE-së, duke luajtur një rol aktiv dhe konstruktiv dhe duke bashkëpunuar në mënyrë efektive me fqinjët e saj dhe shtetet anëtare të BE-së. Gjithashtu vazhdoi zbatimin efektiv të strategjisë së menaxhimit të integruar të kufirit dhe planit të saj të veprimit.

Maqedonia e Veriut

Sa i përket **kritereve politike**, Maqedonia e Veriut vazhdoi përpjekjet e saj për ta forcuar demokracinë dhe sundimin e ligjit, duke përfshirë aktivizimin e kontrolleve dhe balancave ekzistuese dhe kontaktimin mbi çështjet kryesore të politikave dhe legjislativë. Vendi ka treguar përkushtimin e tij për të dhënë rezultate në fushat themelore, duke përfshirë agjendën “Evropa në shtëpi” dhe “Plani i Veprimit 21” për luftën kundër korrupsionit. Raundi i parë i zgjedhjeve lokale u zhvillua më 17 tetor. Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE/ODIHR) ka vendosur një Mision Vëzhgimi të Zgjedhjeve. Është bërë progres i kufizuar në adresimin e rekomandimeve të mbetura nga OSBE/ODIHR dhe Komisioni i Venecias gjatë periudhës raportuese. Shqyrtimi gjithëpërfshirës i legjislacionit për zgjedhjet dhe miratimi i ligjeve relevante duhet ende të finalizohet në kohë dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Partitë opozitare mbetën të angazhuara në mënyrë aktive në Parlament dhe në disa raste mbështetën ligjet kyçe të ndërlidhura me BE-në. Puna parlamentare megjithatë u pengua nga polarizimi politik, i shoqëruar nga COVID-19, i cili me raste prekte funksionet e tij të zakonshme. Nevojiten përpjekje për

ta forcuar rolin e Parlamentit si një forum për dialog politik konstruktiv, veçanërisht në agjendën e reformave të BE-së. Parlamenti vazhdoi t'i ushtrojë funksionet e tij legjislativ. Duhet treguar shumë kujdes në përdorimin e procedurave të shpejta, të cilat duhet të kufizohen për të siguruar një shqyrtim dhe konsultim efektiv të legjislacionit. Parlamenti vazhdoi të ushtrojë mbikëqyrjen e duhur të ekzekutivit. Propozimet për reformën e brendshme të Parlamentit, të rëna dakord gjatë raundit të tretë të "Dialogut Jean Monnet"¹⁹ në fillim të vitit 2020, ende nuk janë zbatuar. Përgjegjësia penale për ata që orkestruan ose kryen dhunë në sulmin ndaj Parlamentit më 27 prill 2017 vazhdoi të përcaktohet, duke përfshirë edhe vendimet e shkallës së parë. Qeveria duhet të vazhdojë me vullin e reformave dhe të fokusohet në zbatimin e kornizës ekzistuese ligjore në vend që të nisë nisma të reja sporadike. Zbatimi në kohë dhe thelbësor i agjendës së reformës kërkon mbështetje të qëndrueshme nga shoqëria në tërësi. Marrëdhëniet ndëretnike mbetën të qëndrueshme dhe Marrëveshja Kornizë e Ohrit vazhdoi të zbatohet.

Organizatat e shoqërisë civile kanë vazhduar të jenë aktive dhe kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur në procesin e reformës. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të siguruar një proces konsultimi më në kohë, kuptimplotë dhe transparent me shoqërinë civile. Në kuadër të sfidave me të cilat përballet rimëkëmbja nga kriza e COVID-19, akterët qeveritarë dhe joqeveritarë pritet të krijojnë partneritete afatgjata dhe ta forcojnë bashkëpunimin ekzistues.

Reforma në sektorin e inteligjencës, duke rezultuar në krijimin e strukturave të reja dhe zhvillimin e një kornize ligjore, pothuajse ka përfunduar. Vendi duhet ta forcojë kapacitetin për mbikëqyrje parlamentare mbi shërbimet e inteligjencës.

Maqedonia e Veriut është mesatarisht e përgatitur në reformën e administratës së saj publike. Është bërë **progres i lehtë** në finalizimin e rishikimit funksional horizontal të administratës shtetërore. Është e rëndësishme që rishikimi funksional horizontal të miratohet nga qeveria. Janë dhënë rekomandime për organizimin e ri të organeve të administratës shtetërore me linja të përmirësuara të llogaridhënies. Këto duhet të futen në legjislacionin përkatës, i cili duhet të miratohet dhe zbatohet. Maqedonia e Veriut aktualisht është duke rishikuar kornizën legjislativë për menaxhimin e burimeve njerëzore përmes rishikimit të ligjit për nëpunësit administrativë dhe ligjit për punonjësit e shërbimeve publike, dhe po prezanton një ligj të ri për shërbimin e menaxhimit të lartë. Korniza e re duhet ta përmirësojë menaxhimin e burimeve njerëzore në të gjithë administratën dhe do të kontribuojë në sigurimin e respektimit më të mirë për rekrutimet, promovimet dhe shkarkimet e bazuara në merita, duke përfshirë në nivelin e menaxhimit të lartë. U prezantuan raportet e monitorimit të zbatimit të Strategjisë së Reformës në Administratën Publike dhe Programit të Reformës së Menaxhimit të Financave Publike. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (SCPC) vazhdoi t'i trajtojë rastet e nepotizmit të pretenduar, miqësisë dhe ndikimit politik në procesin e rekrutimit të punonjësve të sektorit publik dhe në procesin e emërimit të anëtarëve të bordeve mbikëqyrëse dhe menaxhuese. Gjetjet dhe rekomandimet e tij duhet të ndiqen sistematikisht nga institucionet përkatëse.

Sistemi gjyqësor i Maqedonisë së Veriut ka nivel të përgatitjes/është i përgatitur mesatarisht. Është arritur progres i lehtë në lidhje me zbatimin e strategjisë së reformës në drejtësi, duke adresuar më tej rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe Grupit të Ekspertëve të Lartë për çështjet sistematike të Sundimit të Ligjit. Nevojiten ende përpjekje për të siguruar zbatimin sistematik të planit të veprimit të përditësuar mbi strategjinë e reformës në drejtësi dhe strategjitë e burimeve njerëzore për gjyqësorin dhe prokurorinë. Institucionet gjyqësore vijojnë zbatimin e rregullave të reja për emërimin, ngritjen në detyrë, disiplinimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Shumica e legjislacionit zbatues të Ligjit të rishikuar për Këshillin e Prokurorëve Publikë është miratuar. Një projektligj i ri për

¹⁹ Objektivi i "Dialogut Jean Monnet", i iniciuar nga Parlamenti Evropian në vitin 2018 me Parlamentin e Maqedonisë së Veriut, synon ndërtimin e besimit ndërmjet partive politike dhe forcimin e kulturës dhe praktikave demokratike në Parlament.

Akademinë për Gjyqtarët dhe Prokurorët duhet ta mbajë Akademinë si pikën e vetme hyrëse në gjyqësor dhe prokurori dhe duhet të sigurojë një qasje të drejtë dhe transparente në këto profesione.

Maqedonia e Veriut ka nivel të përgatitjes/është mesatarisht e përgatitur në **parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit**. Është bërë progres i lehtë, pasi vendi vazhdoi ta konsolidojë regjistrin e tij të rasteve për hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e disa rasteve të korrupsionit, përfshirë në nivel të lartë, dhe forcoi kornizën e tij institucionale, veçanërisht Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (SCPC) dhe Prokurorin për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (OCCPO). Në muajin prill të vitit 2021, Parlamenti miratoi Strategjinë Kombëtare 2021-2025 për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit dhe Planin përkatës të Veprimit, duke konsoliduar angazhimin e vendit për ta parandaluar korrupsionin dhe për t'i sanksionuar sjelljet korruptive. Rastet e iniciuara nga ish-Prokuroria Speciale (SPO) vazhduan të ecin përpara, duke vendosur kështu përgjegjësinë për përgjimet e paligjshme. Një sërë rastesh i janë nënshtruar aktvendimeve të shkallës së parë dhe janë hapur raste të reja në bazë të materialit hetimor nga ish-Prokuroria Speciale. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit ka qenë proaktiv në parandalimin e korrupsionit dhe ka hapur disa raste, përfshirë edhe kundër zyrtarëve të nivelit të lartë. Komisionit Shtetëror iu ndanë objekte të reja. Megjithatë, përpjekjet për përmirësimin e funksionimit të tij duhet të vazhdojnë, veçanërisht duke ndarë fonde shtesë për rekrutimin e stafit ekspert.

Vendi ka nivel të përgatitjes në **luftën kundër krimit të organizuar**. Korniza legislative është gjerësisht në përputhje me standardet evropiane dhe përpjekjet për zbatimin e strategjive kundër krimit të organizuar duhet të vazhdojnë. Është bërë progres i lehtë në nivelin operacional, por duhet bërë më shumë për ta përmirësuar efektivitetin e zbatimit të ligjit në luftimin e formave të caktuara të krimit, si pastrimi i parave dhe krimet financiare. Koordinimi mbetet thelbësor për të gjithë akterët e përfshirë në luftimin e krimit të organizuar.

Është bërë progres i lehtë në **luftën kundër terrorizmit dhe parandalimin/luftimin e ekstremizmit të dhunshëm** në përputhje me objektivat e përcaktuara në Planin e Përbashkët të Veprimit kundër terrorizmit për Ballkanin Perëndimor dhe marrëveshjen zbatuese dypalëshe. Plani kombëtar për riintegrimin, risocializimin dhe rehabilitimin e luftëtarëve të huaj të kthyer dhe anëtarëve të familjeve të tyre u miratua në muajin qershor të vitit 2020, me qëllim zbatimin e prioritetëve të identifikuar për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit.

Korniza ligjore për mbrojtjen e të **drejtave themelore** është kryesisht në përputhje me standardet evropiane. Vendi e ka ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe Komisionin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi. Procesi i deinstitutionalizimit bëri progres të vërtetë dhe pothuajse të gjithë fëmijët e prekur u rivendosën në kujdesin e bazuar në komunitet. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale po investon në shërbimet komunitare, duke përfshirë mbështetjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore. Progres i rëndësishëm është arritur me miratimin e ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, me mbështetje ndërpartiake. Vihet re një përmirësim për sa i përket integritetit gjinor dhe të drejtave të grave, megjithëse gratë janë ndër kategoritë më të prekura nga pandemia. Rekomandimet e organeve evropiane dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, veçanërisht në lidhje me trajtimin e personave të paraburgosur dhe të dënuar duhet të zbatohen plotësisht pa vonesë. Është gjithashtu e rëndësishme që vendi ta përmirësojë zbatimin e legjislacionit për gjuhën e urrejtjes dhe të planit kombëtar të veprimit për zbatimin e dispozitave të Konventës së Stambollit. Mekanizmi i mbikëqyrjes së jashtme civile mbi policinë nuk është plotësisht funksional dhe mungesa e hetuesve të vërtetë të pavarur pengon përpjekjet për ta adresuar mosndëshkimin dhe ndjekjen penale efektive të policisë. Vendi duhet të vazhdojë ta përmirësojë situatën në burgje dhe t'i rrisë më tej alternativat ndaj paraburgimit.

Maqedonia e Veriut ka arritur nivel të përgatitjes/është e përgatitur mesatarisht në fushën e **lirisë së shprehjes**. Në përgjithësi, ka pasur progres të kufizuar gjatë periudhës raportuese. Konteksti i përgjithshëm është i favorshëm për lirinë e medias dhe lejon raportimin kritik të medias edhe pse ka pasur tensione të shtuara gjatë krizës nga COVID-19. Përpjekjet për vetërregullim duhet të rifillojnë dhe të pasohen me rezultate konkrete për avancimin e standardeve profesionale të gazetarisë. Duhet të

sigurohet transparencë më e madhe në lidhje me reklamimin në media nga institucionet shtetërore dhe partitë politike. Autoritetet duhet t'i shtojnë përpjekjet e tyre për reformimin e transmetuesit publik, duke siguruar pavarësinë dhe qëndrueshmërinë e tij financiare. Transmetuesi publik miratoi një strategji zhvillimore pesëvjeçare, por procesi i reformës pengohet nga vonesat në emërimin e anëtarëve në këshillin e tij drejtues dhe të këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audio-vizuale. Kriza nga COVID-19 pati një ndikim të fortë ekonomik në sektorin e medias, veçanërisht në aktorët rajonalë dhe vendorë. Mediat u përfshinë në pakon e ndihmës, por të drejtat e punës së gazetarëve ende duhet të adresohen.

Sa i përket **bashkëpunimit rajonal**, vendi ka mbajtur marrëdhënie të mira me vendet e tjera të zgjerimit dhe ka vazhduar angazhimin e tij në nismat rajonale. Marrëveshjet dypalëshe ekzistuese, përfshirë Marrëveshjen e Prespës ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë, si dhe Traktatin e Miqësisë, Fqinjësisë së Mirë dhe Bashkëpunimit me Bullgarinë, duhet të zbatohen me mirëbesim nga të gjitha palët.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, Maqedonia e Veriut ka bërë progres të lehtë dhe është në një nivel të mirë të përgatitjes në zhvillimin e një ekonomie funksionale të tregut. E goditur rëndë nga pandemia, ekonomia ra në një recesion në vitin 2020. Një rimëkëmbje graduale filloi në pranverën e vitit 2021. Qeveria zbatoi një përgjigje të fortë fiskale për ta zbutur ndikimin e krizës te familjet dhe firmat. Deficiti fiskal u rrit në 8.2% të BPV-së në vitin 2020 ndërsa niveli i borxhit publik u rrit ndjeshëm në 60.2% të BPV-së, pasi duheshin mbuluar nevojat shtesë për financim. Shpenzimet kapitale u shkurtuan në rishikim buxhetor për të krijuar hapësirë për pagesat e transfertave të lidhura me krizën, megjithatë ekzekutimi në masë të madhe nuk ka qenë i mjaftueshëm. Autoritetet morën disa masa shtesë për ta përmirësuar transparencën fiskale, megjithëse regjistri plotësisht funksional i ndihmës shtetërore ende nuk është zhvilluar. Është bërë pak progres në përmirësimin e mobilizimit dhe mbledhjes së të hyrave, si dhe në menaxhimin e investimeve publike, duke përfshirë një kornizë më të fortë për partneritetet publiko-private. Ligji i ri organik për buxhetin, i cili pritet ta përmirësojë ndjeshëm qeverisjen fiskale, ende nuk është miratuar nga Parlamenti dhe zbatimi i tij është vonuar. I mbështetur nga lehtësimi rregullator, sektori financiar mbeti i fortë dhe kreditimi për sektorin privat mbeti konstant. Mjedisi i biznesit vazhdoi të pengohet nga përmasat e mëdha të ekonomisë informale.

Maqedonia e Veriut ka bërë progres të lehtë në adresimin e rekomandimeve të vitit të kaluar dhe është mesatarisht e përgatitur për ta përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Unionit. Integrimi me BE-në në tregti dhe investime vazhdoi edhe gjatë pandemisë. Niveli dhe struktura e tregtisë dhe outputi i prodhimit u ndikuan nga bllokimet dhe ndërprerjet e zinxhirit të furnizimit, brenda dhe në vendet partnere tregtare. Struktura e industrisë po përmirësohet vazhdimisht. Përkeqësimi i produktivitetit të punës dhe konkurrueshmërisë së çmimeve në vitin 2020 reflekton në një shkallë të madhe ndikimin ekonomik të pandemisë dhe masat e qeverisë për ruajtjen e vendeve të punës. Kurrikula e Arsimit dhe Aftësimin Profesional (AAP) është përmirësuar. Megjithatë, mungesa e aftësive, duke reflektuar mangësitë në kurrikulat e arsimit, boshllëqet e investimeve kapitale dhe integrimi i kufizuar i firmave vendase në zinxhirët globalë të furnizimit po e kufizojnë rritjen e mundshme. Digjitalizimi i ekonomisë është duke bërë progres.

Për sa i përket aftësisë së saj për t'i marrë përsipër detyrime për anëtarësim, Maqedonia e Veriut është e përgatitur mesatarisht në shumicën e fushave të mbuluara nga **grupimi 2 për tregun e brendshëm**, përkatësisht lëvizja e lirë e mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, pronësia intelektuale dhe politika e konkurrencës. Ndërkohë, vendi ka një nivel të mirë të përgatitjes për ligjin e shoqërive tregtare, megjithëse është ende në një fazë të hershme për lirinë e lëvizjes së punëtorëve. Në periudhën raportuese, Maqedonia e Veriut ka bërë progres të kufizuar ose fare progres në të gjitha fushat, përveç lëvizjes së lirë të kapitalit, ligjit të shoqërive tregtare dhe pronës intelektuale, ku ka bërë progres. Në përgjithësi, në vitin e ardhshëm nevojitet më shumë progres në fushat që mbulon ky grup, pasi është i rëndësishëm për përgatitjet e Maqedonisë së Veriut për t'i përmbushur kërkesat e tregut të brendshëm të BE-së dhe për zhvillimin e tregut të përbashkët rajonal.

Në përgjithësi, Maqedonia e Veriut është mesatarisht e përgatitur në shumicën e fushave të mbuluara nga grupimi 3 për konkurrencën dhe rritjen gjithëpërfshirëse, duke përfshirë shoqërinë e informacionit dhe mediat, tatimimin, politikën e ndërmarrjeve dhe industriale, arsimin dhe kulturën dhe politikën ekonomike dhe monetare. Megjithatë, nevojiten përpjekje shtesë për t'i sjellë këto fusha në një shkallë më të lartë gatishmërie. Ekziston një nivel i mirë i përgatitjes në fushën e shkencës dhe hulumtimit dhe unionit doganor. Është bërë progres i lehtë në shumicën e këtyre fushave. Nevojiten më shumë përpjekje, veçanërisht në fushat ku është bërë progres i kufizuar, si shoqëria e informacionit dhe media, shkenca dhe hulumtimi, si dhe arsimi dhe kultura.

Sa i përket grupimit 4 për **agjendën e gjelbër dhe konektivitetin e qëndrueshëm**, Maqedonia e Veriut ka një nivel të mirë të përgatitjes në rrjetet trans-evropiane. Ajo është e përgatitur mesatarisht për politikën e transportit dhe energjisë dhe ka nivel të përgatitjes për mjedisin dhe ndryshimet klimatike. Maqedonia e Veriut po merr pjesë në mënyrë aktive në takimet e Komunitetit të Transportit dhe Komunitetit të Energjisë. Ajo ka një nivel të lartë përputhshmërie me Traktatin e Komunitetit të Energjisë, veçanërisht për energjinë elektrike. Si i gjithë Ballkani Perëndimor, Maqedonia e Veriut miratoi Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor në Samitin e Sofjes në muajin dhjetor të vitit 2020. Këtë vit, është bërë progres i lehtë në sektorin e energjisë, veçanërisht me progresin e bërë drejt miratimit të Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës. Megjithatë, u arrit progres i kufizuar në transport, mjedis dhe ndryshime klimatike. Vendi duhet ta rrisë ndjeshëm ambicien e tij për ta zbatuar siç duhet *acquis* të kapitujve 14 dhe 27. Këto përpjekje do ta rrisin efikasitetin e Planit Ekonomik dhe të Investimeve dhe do ta përshpejtojnë zbatimin e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Kapacitetet administrative duhet të forcohen në të gjithë sektorët. Për më tepër, strategjitë, planet e veprimit dhe legjislacioni në këta sektorë duhet të jenë koherente me parimet dhe prioritetet e Agjendës së Gjelbër dhe të sigurojnë konsistencë midis dokumenteve përkatëse sektoriale. Maqedonia e Veriut është e përgatitur mesatarisht në shumicën e fushave të **grupimit 5 për burimet, bujqësinë dhe kohezionin**. Ka një nivel të mirë të përgatitjes në fushën e sigurisë ushqimore, politikës veterinarë dhe fitosanitare dhe është në një fazë të hershme të përgatitjes në dispozitat financiare dhe buxhetore. Gjatë periudhës raportuese, është bërë progres i mirë në fushën e politikës së sigurisë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare²⁰ dhe progres i lehtë është bërë në bujqësi dhe zhvillim rural. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme, veçanërisht në fushat ku është bërë progres i kufizuar ose nuk ka pasur fare progres, si peshkimi, politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore, si dhe dispozitave financiare dhe buxhetore.

Maqedonia e Veriut është e përgatitur mesatarisht në fushat e mbuluara nga **grupimi 6 për marrëdhëniet e jashtme** dhe ka bërë progres të lehtë gjatë periudhës raportuese. Në politikën e saj të përbashkët tregtare, Maqedonia e Veriut vazhdoi përpjekjet e saj për t'i koordinuar qëndrimet e saj dhe për t'i lidhur ngushtë politikën e saj tregtare me ato të BE-së, duke përfshirë edhe brenda OBT-së. Megjithatë, nuk është bërë progres në politikën e zhvillimit dhe ndihmën humanitare. Maqedonia e Veriut është e përgatitur mesatarisht në fushën e politikës së përbashkët të jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes. Vendi ka rritur përafrimin e tij me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së në 96% dhe pjesëmarrjen e tij në misionet dhe operacionet e menaxhimit të krizave të BE-së.

Maqedonia e Veriut mbetet në një nga rrugët kryesore të tranzitit për lëvizjen e migracionit. Vendi vazhdon të luajë një rol konstruktiv në menaxhimin e **flukseve të përziara të migracionit**. Ai bashkëpunon në mënyrë efektive me vendet fqinje dhe shtetet anëtare të BE-së, duke përfshirë zyrtarë të ftuar nga shtetet anëtare të BE-së në terren. Vazhduan përpjekjet për të siguruar kushte bazë jetese dhe shërbime për të gjithë emigrantët që qëndrojnë brenda vendit. Regjistrimi i emigrantëve dhe profilizimi adekuat i ndjeshëm ndaj mbrojtjes u përmirësuan, por duhet të kryhen në një mënyrë më sistematike. Marrëveshja e Statusit me BE-në, e cila do të lejonte vendosjen e trupave të përhershme të Agjencisë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare (Frontex) në vend, nuk është nënshkruar ende

²⁰ Masat për kontrollin e sëmundjeve të bimëve, veçanërisht të kulturave bujqësore.

për shkak të një çështjeje dypalëshe. Vendi duhet ta ndërmarrë një qasje më metodike ndaj luftimit të kontrabandimit të emigrantëve.

Shqipëria

Sa i përket **kritereve politike**, zgjedhjet e përgjithshme u mbajtën më 25 prill 2021, pas marrëveshjes ndërpartiake të datës 5 qershor 2020 që çoi në një reformë të gjerë zgjedhore, në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR. Identifikimi elektronik i votuesve u zbatua në 97% të qendrave të votimit, ndërsa votimi elektronik dhe numërimi elektronik u pilotua me sukses në 32 qendra votimi në Tiranë. Vlerësimi përfundimtar i OSBE/ODIHR zbuloi se zgjedhjet në përgjithësi ishin të organizuara mirë. Administrata e re zgjedhore fitoi besimin e shumicës së akterëve. Shqetësimet mbeten lidhur me keqpërdorimin e burimeve publike ose të funksioneve zyrtare, me akuzat për blerje votash dhe me publikimin e të dhënave të ndjeshme personale që mbulonin preferencat politike të qytetarëve. Këto raste janë duke u hetuar. Parlamenti vazhdoi të punojë nën kufizimet e vendosura për shkak të pandemisë. Në lidhje me reformat e orientuara drejt BE-së, Parlamenti miratoi një disa pjesë të rëndësishme të legjislacionit, në fusha si azili, regjistrimi i popullsisë dhe efikasiteti i gjyqësorit. Gjatë gjithë periudhës raportuese, qeveria ka mbajtur fokusin në reformat e kërkuara për rrugën e vendit drejt BE-së, pavarësisht sfidës së adresimit të ndikimit negativ social dhe ekonomik të pandemisë COVID-19. Në legjislaturën e re, shumica dhe opozita do të duhet ta përmirësojnë dialogun politik dhe të punojnë së bashku me të gjitha pjesët e shoqërisë për ta avancuar më tej agjendën e reformave në BE dhe negociatat për anëtarësim. Koordinimi brenda administratës duhet të përmirësohet, veçanërisht në lidhje me integrimin në BE. Reforma administrative territoriale duhet të konsolidohet më tej si pjesë e agjendës më të gjerë të decentralizimit. Kjo është veçanërisht e nevojshme për të garantuar autonominë fiskale lokale dhe për t'i fuqizuar komunat për të ofruar shërbime publike cilësore. Është bërë progres i kufizuar në zbatimin e udhërrëfyesit për krijimin e një mjedisi të favorshëm për shoqërinë civile. Megjithatë, shoqëria civile shqiptare ka qenë në gjendje të ofrojë mbështetje dhe shërbime për njerëzit më të cënueshëm të prekur nga pandemia COVID-19.

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur për reformën në **administratën e saj publike**. Është bërë progres i lehtë në ngritjen e kapaciteteve në ministritë e linjës për zbatimin e vlerësimeve të ndikimit rregullator, miratimin e udhëzimeve për konsultimet publike, ngritjen e sistemeve të TI-së për planifikimin e integruar, rritjen e shkallës së zbatimit të Planit Kombëtar të Integritit Evropian, rritjen e numrit të shërbimeve elektronike dhe përfundimin e fazës së testimit për ta automatizuar sistemin e listës së pagave. Zbatimi i Reformës së Administratës Publike (RAP) 2015-2022 dhe Strategjive të Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (MFP) 2014-2022 ka vazhduar, pavarësisht ndikimit të pandemisë.

Sistemi gjyqësor i Shqipërisë është gjithashtu mesatarisht i përgatitur. Shqipëria ka vazhduar zbatimin e reformës gjithëpërfshirëse në drejtësi, duke rezultuar në një progres të mirë. Në veçanti, ajo arriti një moment kulmant të rëndësishëm në fund të vitit 2020, me emërimin e tre gjyqtarëve të rinj në Gjykatën Kushtetuese. Me shtatë gjyqtarë në detyrë, Gjykata Kushtetuese rifitoi kuorumin e nevojshëm prej minimumi gjashtë anëtarësh për të mbajtur seancat plenare, duke qenë kështu plotësisht funksionale dhe *duke përmbushur kushtin përkatës të mbetur për KNQ-në e parë, i cili vazhdon të përmbushet*. Gjykata Kushtetuese ka filluar të ushtrojë plotësisht funksionet e saj, duke përfshirë edhe gjykimin e mosmarrëveshjeve kushtetuese ndërmjet institucioneve shtetërore në lidhje me kompetencat përkatëse. Progresi ka vazhduar edhe në emërimet në Gjykatën e Lartë. Gjykata e Lartë rifitoi kuorumin e saj në mars 2020. Me promovimin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të gjashtë gjyqtarëve të rinj në mars dhe korrik 2021, ka arritur në nëntë gjyqtarë në detyrë, të cilët e bëjnë atë plotësisht funksional - *kusht për KNQ-në e parë, i cili vazhdon të përmbushet*. Priten emërimet të mëtejshme në Gjykatën e Lartë. Parlamenti miratoi ndryshime në dhjetë ligje që synojnë të forcojnë më tej efikasitetin e sistemit gjyqësor dhe kapacitetin e tij për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Rivlerësimi i përkohshëm i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve (**procesi i vetingut**) ka përparuar në mënyrë të qëndrueshme, duke vazhduar të japë rezultate të prekshme - *kusht për KNQ-në e parë, i cili vazhdon të përmbushet*. Nën kujdesin e Komisionit Evropian, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit ka vazhduar të mbikëqyrë procesin. Deri më 15 shtator 2021, institucionet e vetingut kishin përfunduar 437 raste në shkallë të parë, përfshirë të gjitha dosjet prioritare. Nga 437 vendime, 298 janë të formës së prerë (dmth pas ankimit). Në përgjithësi, 62% e dosjeve të vetingut të procesuara deri më tani kanë rezultuar me shkarkime dhe pushime kryesisht për shkak të dorëheqjeve nga ana e atyre që janë vlerësuar. Institucionet e vetingut pritet të vazhdojnë t'ia referojnë shërbimeve prokuroriale të gjitha rastet kur ka indicie për vepra penale.

Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), e përbërë nga **Prokuroria e Posaçme (PP)** dhe **Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH)**, janë funksionale. *kusht për KNQ-në e parë, i cili vazhdon të përmbushet*. Përderisa buxheti i vitit 2021 parasheh emërimin e 20 prokurorëve, PP-ja ka arritur objektivin e parë prej 15 prokurorëve, përfshirë edhe kryeprokurorin special. Raundi i parë i rekrutimit për hetuesit e BKH-së rezultoi në emërimin e 28 hetuesve, të cilët, pas një programi intensiv trajnimi, tashmë janë operacionalë. Një raund i dytë për të rekrutuar 32 hetues shtesë u hap në prill 2021 dhe pritet të përfundojë para fundit të vitit.

Shqipëria ka një nivel përgatitjeje në **luftën kundër korrupsionit**. Ka bërë disa përparime në forcimin e luftës kundër korrupsionit - *kusht për KNQ-në e parë, i cili vazhdon të përmbushet*. Në përgjithësi, zbatimi i Strategjisë Ndërsëktoriale kundër Korrupsionit është në rrugën e duhur. Edhe pse vetingu i anëtarëve të gjyqësorit është një proces administrativ, ai po jep rezultate në luftën kundër korrupsionit pasi gjyqtarët dhe prokurorët e shkarkuar, si rezultat i vetingut, po vihen para drejtësisë. Shqipëria ka bërë përpjekje të mëtjshme për të krijuar një historik (regjistër) solid në luftën kundër korrupsionit, megjithëse mbetet një objektiv që kërkon vullnet politik dhe veprime të mëtjshme të strukturuar dhe të qëndrueshme. Dënimet në rastet që përfshijnë zyrtarë të nivelit të lartë mbeten ende të kufizuara, duke nxitur një kulturë të mosndëshkimit brenda niveleve më të larta të shtetit. Strukturat e specializuara kundër korrupsionit (SPAK dhe gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar) duhet të forcojnë ndjeshëm kapacitetin e përgjithshëm të vendit për të hetuar dhe ndjekur penalisht korrupsionin. Në përgjithësi, korrupsioni është i përhapur në shumë fusha të jetës publike dhe të biznesit dhe mbetet një çështje shqetësuese serioze.

Shqipëria ka një nivel përgatitjeje në **luftën kundër krimit të organizuar**. Ka bërë përparim të mirë për të përmbushur rekomandimet e vitit të kaluar. Ajo arriti rezultate të prekshme në luftën kundër krimit të organizuar, duke përfshirë rritjen e bashkëpunimit me shtetet anëtare të BE-së dhe Europol-in - *kusht për KNQ-në e parë, i cili vazhdon të përmbushet*. Vendi vazhdoi të zbatojë Planin e Veprimit të Task Forcës së Veprimit Financiar (TFVF) për të përmirësuar efektivitetin në fushën e luftimit të pastrimit të parave dhe pakon e masave parandaluese të përkohshme për të rritur kapacitetin e tij për të luftuar organizatat kriminale (Operacioni Forca e Ligjit) gjatë gjithë vitit. Shkëmbimi i informacionit cilësor dhe operacionet e përbashkëta policore që përfshijnë partnerë ndërkombëtarë u intensifikuan më tej. Shqipëria ka vazhduar të tregojë angazhimin e saj për të luftuar prodhimin dhe trafikun e drogës, ndërsa monitorimi ajror nga shërbimet ligjzbatuese të shteteve anëtare të BE-së ka vazhduar. Sistemi i ri i specializuar kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit mundëson bashkëpunim të përforcuar ndërmjet policisë dhe shërbimeve të prokurorisë. Hetimet financiare duhet të shoqërojnë në mënyrë sistematike procedurat penale. Duhet të vazhdojnë përpjekjet për të rritur numrin e ndjekjeve penale dhe dënimeve përfundimtare, veçanërisht në nivelet e larta. Shqipëria miratoi një strategji dhe plan veprimi të ri kombëtar ndërsëktorial **kundër terrorizmit** në dhjetor 2020 dhe bëri përparim shumë të mirë në zbatimin e marrëveshjes dypalëshe me BE-në për operacionalizimin e Planit të Përbashkët të Veprimit kundër terrorizmit për Ballkanin Perëndimor. Nevojiten më shumë përpjekje për të trajtuar krimin kibernetik, trafikimin e qenieve njerëzore dhe rastet e pastrimit të parave.

Në lidhje me **të drejtat themelore**, Shqipëria respekton instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe ka ratifikuar shumicën e konventave ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e të drejtave themelore. Shqipëria ka bërë përpjekje për të përmbushur detyrimet e saj sipas këtyre instrumenteve.

Për sa i përket miratimit të legjislacionit të mbetur zbatues në lidhje me ligjin kornizë të vitit 2017 për mbrojtjen e pakicave kombëtare, ajo miratoi një akt nënligjor shtesë për arsimin e pakicave në dhjetor 2020, i cili e çoi numrin e akteve nënligjore të miratuara në tetë sosh. Legjislacioni i mbetur zbatues, duke përfshirë atë mbi vetë-identifikimin dhe përdorimin e gjuhëve të pakicave, mbetet për t'u miratuar. Përpjekjet po vazhdojnë për të zbatuar një reformë gjithëpërfshirëse të sektorit të tokës dhe për të konsoliduar të drejtat pronësisore. U miratua një ligj për regjistrimin e popullsisë. Shqipëria ka një nivel përgatitjeje/është e përgatitur mesatarisht në fushën e **lirisë së shprehjes**. Nuk ka pasur progres gjatë periudhës raportuese. Atmosfera e sulmeve verbale, fushatave shpifëse dhe akteve të frikësimit ndaj gazetarëve nuk është përmirësuar. Tensionet mes aktorëve politik dhe gazetarëve janë rritur gjatë krizës së COVID-19 dhe në kuadër të zgjedhjeve parlamentare. Sulmet e raportuara kundër gazetarëve nuk kanë rezultuar në ndonjë dënim përfundimtar. Duhet të sigurohet vetërregullimi në mediat online. Hapat për të bërë autoritetin rregullator audio-vizual plotësisht funksional duhet të ndërmerren në një mënyrë që të sigurojnë pavarësinë dhe legjitimitetin e tij. Pavarësia e transmetuesit publik, standardet profesionale dhe qëndrueshmëria financiare duhet të forcohen. Pas opinionit të pafavorshëm të Komisionit të Venecias dhe kritikave të gjera për projekt-amendamentet në ligjin për median që synojnë rregullimin e medias online dhe disa aspekte të shpifjes, përfaqësuesit e mazhorancës qeverisëse u përkushtuan publikisht për të garantuar që çdo legjislacion i ri për media do të jetë në përputhje me Rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe të dorëzohet për konsultim me organizatat mediatike. Qeveria e rishqyrtoi çështjen dhe Kuvendi nuk iu rikthye çështjes. Parlamenti dhe qeveria që rezultojnë nga zgjedhjet e 25 prillit duhet të mbështesin angazhimin për të siguruar që çdo ndryshim i mundshëm në ligjin e medias do të jetë në përputhje me Opinionin e Komisionit të Venecias dhe do t'i nënshtrohet konsultimeve të duhura.

Në lidhje me **barazinë gjinore**, zbatimi i strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit 2016-2020 për barazinë gjinore u pengua nga një hendek i vazhdueshëm financimi. Një strategji e re për barazinë gjinore 2021-2030 u miratua në qershor 2021. Shqipëria duhet të bëjë përpjekje për të siguruar financimin e duhur shtetëror për ta zbatuar atë në nivel qendror dhe lokal. Kërkohen gjithashtu përpjekje për të siguruar që të gjitha strategjitë kombëtare në nivel qendror dhe lokal të jenë të integruara përkitazi me aspektin gjinor dhe të aplikojnë buxhetim të përgjegjshëm gjinor.

Sa i përket **migracionit**, kuadri ligjor për migracionin është kryesisht i përafëruar me *acquis* të BE-së, por ka nevojë për përditësim në përputhje me zhvillimet e fundit. Në shkurt 2021, Shqipëria miratoi një ligj të ri për azilin. Strategjitë për një menaxhim të integruar të kufirit dhe diasporën u miratuan në vitin 2020. Zbatimi i strategjisë kombëtare të migracionit dhe planit të veprimit për 2019-2022 ka vazhduar, duke ofruar një kornizë të qartë për menaxhimin dhe koordinimin e flukseve të migracionit dhe Komisioni ka publikuar katër raporte monitorimi. Pavarësisht mbylljes së kufijve gjatë muajve mars-maj 2020, Shqipëria vazhdoi të përjetonte një fluks në rritje të migrantëve të parregullt, kryesisht nga Greqia dhe që largoheshin nga Shqipëria pas disa ditësh, rrugës për në vendet e tjera të BE-së. Numri i migrantëve të parregullt të kapur në Shqipëri në vitin 2020 është rritur me 13% krahasuar me vitin 2019.

Sipas të dhënave të Eurostat, numri i **shtetasve shqiptarë që kanë paraqitur kërkesa për azil** në shtetet anëtare të BE-së është ulur me 66% në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, nga 20,415 në 6,935 aplikime. Pandemia e COVID-19 kontribuoi në një masë të madhe në këtë rënie të theksuar, por mund të vërehet se rënia mesatare e aplikimeve nga pjesa tjetër e botës në BE është shumë më e vogël (-33%). 'Norma e njohjes' në 2020 ishte rreth 4.4% krahasuar me 5.3% në 2019. Që kur aplikimet arritën kulmin në 2017 në Shtetin anëtar më të prekur, numri i aplikimeve ka rënë nga 12,130 në 2017 në 2,985 në 2020. Tre oficerë ndërlihdës të policisë shqiptare janë vendosur në BE dhe një oficer ndërlihdës nga BE-ja punon në Tiranë për të ndihmuar me kontrollet e daljes. Çështja e shtetasve shqiptarë që bëjnë kërkesa të pabazuara për azil në shtetet anëtare të BE-së dhe vendet e lidhura me Shengenin kërkon ende përpjekje të konsiderueshme nga autoritetet shqiptare. Përveç fushatave informuese, kontrollet e thella kufitare, ndërgjegjësimi për të drejtat dhe detyrimet nën regjimin pa viza, identifikimi dhe adresimi i arsyeve themelore, dialogu dhe bashkëpunimi me vendet më të

prekura kanë vazhduar. Komisioni po monitoron nga afër trendin në kuadër të mekanizmit monitorues pas liberalizimit të vizave.

Për sa i përket **kritereve ekonomike**, Shqipëria ka bërë njëfarë progresi dhe është mesatarisht e përgatitur në drejtim të zhvillimit të një ekonomie tregu funksionale. I goditur nga goditja e dyfishtë nga tërmeti i nëntorit 2019 dhe pandemia COVID-19, PBB u tkurr në vitin 2020, edhe pse me më pak se sa pritej fillimisht. Mbyllja e brendshme e lidhur me pandeminë dhe kufizimet e udhëtimeve ndërkombëtare shkaktuan humbje të konsiderueshme për sektorët e turizmit dhe prodhimit, por ekonomia filloi të rimëkëmbet në gjysmën e dytë të vitit. Brenda hapësirës së kufizuar të politikës fiskale dhe monetare në dispozicion, qeveria dhe banka qendrore ndërmorën veprime të shpejta dhe të përshtatshme për të mbështetur biznesin, familjet dhe sektorin e shëndetësisë. Kjo zbuti ndikimin në tregun e punës dhe ruajti stabilitetin e sektorit makroekonomik dhe financiar. Kjo gjithashtu rriti raportet e borxhit publik dhe deficitit dhe rriti cenueshmërinë e vendit ndaj goditjeve të jashtme. Përballja me goditjen e dyfishtë ngarkoi kapacitetin e administratës, por ajo ruajti në masë të madhe vazhdimësinë e biznesit dhe puna vazhdoi për shumicën e reformave dhe nismave legislative që ishin në proces e sipër.

Shqipëria ka bërë njëfarë progresi dhe ka një nivel përgatitjeje në **kapacitetin e saj për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut** brenda BE-së. Ajo ka bërë përmirësime në infrastrukturën e energjisë dhe transportit, përdorimin e komunikimit dixhital dhe në rezultatet e arsimit, por mbeten boshllëqe të konsiderueshme në krahasim me homologët e saj rajonale dhe evropiane. Konkurrueshmëria e Shqipërisë pengohet nga mungesa e njohurive sipërmarrëse dhe teknologjike, nivele të konsiderueshme informaliteti, nevoja të paplotësuara për investime në kapitalin njerëzor dhe fizik dhe shpenzime të ulëta për kërkim dhe zhvillim. Boshllëqet paraekzistuese dhe të rëndësishme në aftësi dhe arsim janë zgjeruar ndoshta për shkak të mbylljeve të lidhura me COVID-19 dhe mësimin në distancë, i cili nuk është i arritshëm për të gjithë. Integrimi rajonal dhe eksportet u rritën, por mbetën nën potencial. Mungesa e diversifikimit të produkteve dhe atij gjeografik në eksportet e Shqipërisë shtojnë cenueshmërinë e saj ndaj goditjeve të jashtme.

Përsa i përket **prokurimit publik**, ku Shqipëria është mesatarisht e përgatitur, vendi ka bërë progres të mirë, veçanërisht duke miratuar ligjin e ri për prokurimin publik. Për sa i përket **statistikave**, ku Shqipëria është gjithashtu e përgatitur mesatarisht, ka bërë disa përparime në përafrimin me standardet e ESA 2010, publikim më të shpejtë dhe miratimin e Ligjit të Regjistrimit të Popullsisë. Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në shumicën e fushave për **kontrollin financiar**, ku vendi ka bërë disa përparime, veçanërisht në kontrollin e brendshëm financiar publik dhe auditimin e jashtëm.

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në shumicën e fushave të **tregut të brendshëm**, përkatësisht lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, politikën e konkurrencës dhe shërbimet financiare. Ajo ka bërë njëfarë progresi në veçanti duke miratuar një ligj për sigurimin e detyrueshëm në transport dhe duke përafruar më tej legjislacionin e saj bankar, por Komisioni i Ndhmës Shtetërore duhet të bëhet i pavarur dhe me burime të mjaftueshme. Përgatitjet janë në një fazë të hershme për mbrojtjen e konsumatorëve dhe shëndetit, pasi që vendi nuk ka bërë përparim në shëndetësi jashtë reagimit të saj ndaj COVID-19. Shqipëria duhet të zbatojë qasjen “Një shëndetësi” dhe të sigurojë që të gjithë të kenë mbulim cilësor të kujdesit shëndetësor. Ky grup politikash është kyç për përgatitjet e Shqipërisë për të përmbushur kërkesat e tregut të brendshëm të BE-së dhe është i një rëndësie të madhe për integrimin e hershëm dhe zhvillimin e tregut të përbashkët rajonal.

Shqipëria ka arritur një nivel të moderuar përgatitjeje në shumë fusha që lidhen me **konkurrueshmërinë dhe rritjen gjithëpërfshirëse**, përkatësisht shoqërinë e informacionit dhe mediat, taksat, politikën ekonomike dhe monetare, politikat e sipërmarrjeve dhe industriale, arsimin dhe kulturën, si dhe unionin doganor. Vendi ka një nivel përgatitjeje në politikën sociale dhe punësimin, si dhe në shkencë dhe kërkime. Shqipëria ka bërë disa përparime në veçanti me Strategjinë e Specializimit Smart dhe në pjesëmarrjen e saj në programin e kërkimit Horizon 2020, por progresi ka qenë i kufizuar në politikën ekonomike dhe monetare dhe unionin doganor gjatë periudhës raportuese.

Reformat socio-ekonomike duhet të ndiqen për të ndihmuar në adresimin e dobësive ekzistuese strukturore, konkurrencës së ulët, papunësisë së lartë dhe ndikimit të pandemisë.

Shqipëria është e përgatitur mesatarisht në shumicën e fushave që lidhen me **Agjendën e gjelbër dhe konektivitetin e qëndrueshëm**, përkatësisht rrjetet trans-evropiane, energjinë, mjedisin dhe ndryshimet klimatike. Ajo ka një nivel përgatitjeje në fushën e politikës së transportit. Vendi ka bërë njëfarë përparimi në shumicën e fushave, veçanërisht nëpërmjet planifikimit të rishikuar të transportit dhe konektivitetit të energjisë. Nevojiten më shumë përpjekje për të përmirësuar performancën e anijeve nën flamurin shqiptar dhe për të zbatuar legjislacionin për energjinë dhe mjedisin, jo vetëm në zonat e mbrojtura. Tranzicioni i gjelbër dhe konektiviteti i qëndrueshëm janë kyçe për integrimin ekonomik brenda rajonit dhe me Bashkimin Evropian, duke lehtësuar tregtinë ndërkufitare brenda rajonit dhe duke krijuar përfitime reale për bizneset dhe qytetarët. Ky grup dhe reformat në fjalë kanë lidhje të rëndësishme me Programin e reformës ekonomike të Shqipërisë, Planin ekonomik dhe investues të komisionit dhe Agjendën e gjelbër për Ballkanin Perëndimor të miratuar nga Shqipëria në dhjetor 2020.

Shqipëria ka një nivel përgatitjeje në shumicën e fushave të lidhura me **burimet, bujqësinë dhe kohezionin**, përkatësisht bujqësinë dhe zhvillimin rural, sigurinë ushqimore, politikat veterinarë dhe fitosanitare, peshkimin dhe dispozitat financiare dhe buxhetore. Ajo është e përgatitur mesatarisht për sa i përket politikës rajonale dhe koordinimit të instrumenteve strukturore. Shqipëria ka bërë progres të mirë në fushën e peshkimit, duke riaktivizuar sistemin e monitorimit të anijeve (VMS). Ajo ka bërë njëfarë progresi në dispozitat financiare dhe buxhetore, në bujqësi dhe zhvillimin rural, dhe sigurinë ushqimore, politikën veterinarë dhe fitosanitare, por duhet të krijohet regjistri i fermave. Ajo ka bërë përparim të kufizuar në politikën rajonale dhe koordinimin e instrumenteve të financimit strukturor. Në këtë drejtim, koordinimi midis agjencioneve për ndihmën e para-anëtarësimit ka nevojë për përmirësim, dhe duhet të adresohen çështjet në lidhje me planifikimin strategjik, zbatimin dhe kapacitetin monitorues të projekteve të infrastrukturës në kuadër të Planit ekonomik dhe investiv.

Shqipëria ka arritur një nivel të mirë përgatitjeje për sa i përket **marrëdhënive të jashtme, sigurisë së jashtme dhe mbrojtjes**. Për sa i përket kapitullit të marrëdhënive me jashtë të negociatave, Shqipëria bëri përparim të mirë dhe arriti një nivel të mirë përgatitjeje, jo vetëm duke miratuar dhe ratifikuar protokollin shtesë të Marrëveshjes së tregtisë së lirë të Evropës qendrore dhe duke certifikuar operatorët e parë të autorizuar ekonomikë (OAE). Ajo ka punuar në zgjerimin e Korsive/Korridoreve të gjelbërta me shtetet anëtare të BE-së. Vendi ka përmbushur gjithashtu masa politikash për ndihmën humanitare dhe ndihma zhvillimore. Vendi mbajti një kryesim të suksesshëm të CEFTA-s. Për sa i përket Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së, ajo vazhdoi të ruajë harmonizimin e plotë me të gjitha vendimet dhe deklaratat përkatëse të BE-së. Vendi mbajti kryesimin e OSBE-së në vitin 2020, duke demonstruar përkushtimin e tij ndaj bashkëpunimit shumëpalësh. Shqipëria vazhdoi të marrë pjesë në misionet dhe operacionet e BE-së për menaxhimin e krizave.

Bosnjë dhe Hercegovina

Për sa i përket **kritereve politike**, autoritetet legjislative dhe ekzekutive patën një rezultat të ulët për shkak të polarizimit politik dhe çrregullimit të shkaktuar nga pandemia. Qeveria e njësisë së Federatës është ende duke vepruar në një rol të kujdestarit. Kushtetuta e Bosnje dhe Hercegovinës mbetet në kundërshtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), pas rasteve Sejdić-Finci dhe rasteve të ngjashme. Një grup pune ndër-institucional, i cili pritet të diskutojë reformat zgjedhore dhe kushtetuese, u krijua në maj 2021. Zgjedhjet komunale u mbajtën në Mostar në dhjetor 2020, për herë të parë që nga viti 2008. Komisioni Parlamentar i Stabilizimit Asociimit u mblodh dhe miratoi rregulloren e tij të punës në qershor 2021, pas një ngërçi pesë-vjeçar. Procesi gjithëpërfshirës i reformës zgjedhore, përmes dialogut të mirëfilltë dhe në përputhje me standardet evropiane që do të eliminonte të gjitha format e pabarazisë dhe diskriminimit në procesin zgjedhor është i një rëndësie parësore. Nuk është bërë përparim në përmirësimin e kuadrit zgjedhor në përputhje me standardet evropiane dhe sigurimin e transparencës së financimit të partive politike. Bosnja dhe Hercegovina ende

nuk i ka adresuar rekomandimet nga Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE/ODIHR), Komisioni i Venecias dhe Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit të Këshillit të Evropës (GRECO). Një sërë vendimesh të Gjykatës Kushtetuese ende nuk janë zbatuar plotësisht. Zhvillimi i një programi kombëtar për miratimin e acquis të BE-së është ende në pritje. Është bërë përparim i kufizuar në sigurimin e një mjedisi të favorshëm për shoqërinë civile.

Bosnja dhe Hercegovina është në një fazë të hershme të përgatitjes për **reformën e administratës publike** (RAP); Është arritur njëfarë progresi duke miratuar planin e veprimit për reformën e administratës publike si dhe strategjitë për menaxhimin e financave publike në të gjitha nivelet e qeverisë. Vendi duhet të sigurojë një shërbim civil profesional dhe të depolitizuar dhe një qasje të koordinuar mbarëkombëtare ndaj politikëbërjes.

Bosnja dhe Hercegovina është në një fazë të hershme/ka një nivel përgatitjeje për sa i përket **gjyqësorit** të saj. Nuk është bërë përparim në këtë fushë gjatë periudhës raportuese. Autoritetet kanë ndërmarrë veprime të kufizuara për të adresuar gjetjet e Raportit të Ekspertëve për çështjet e sundimit të ligjit ('Raporti Priebe'). Amendamentet e integritetit duhet të hyjnë në procedurë parlamentare; miratimi i tyre është kyç për krijimin e një sistemi të besueshëm dhe rigoroz të verifikimit të deklaratave financiare të bartësve të funksioneve gjyqësore. Shenjat e vazhdueshme dhe evidente të përkeqësimit vazhdojnë të kërkojnë masa urgjente për të forcuar integritetin dhe rifitimin e besimit të qytetarëve në gjyqësor. Mungesa e angazhimit për reformën në drejtësi nga aktorët politikë, dhe funksionimi i dobët i sistemit gjyqësor vazhdoi të minonte gëzimin e të drejtave të qytetarëve dhe luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Bosnja dhe Hercegovina është në një fazë të hershme/ka një nivel përgatitjeje në parandalimin dhe **luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar**. Nuk është bërë përparim në këtë fushë gjatë periudhës raportuese; kërkohet veprim urgjent për miratimin e legjislacionit në pritje për prokurimin publik dhe konfliktin e interesit. Gjatë pandemisë, efektet negative të korrupsionit të përhapur dhe shenjat e kapjes politike vazhduan të shfaqen fuqishëm gjatë pandemisë, duke ndikuar drejtpërdrejt në mirëqenien e qytetarëve. Ndjekja penale selektive dhe jotransparente dhe ndjekja gjyqësore e rasteve të korrupsionit është një shkak për shqetësim. Ka mangësi sistematike në bashkëpunimin operacional ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit dhe një shkëmbim shumë i kufizuar informacioni. Policia është e cenueshme ndaj ndërhyrjeve politike. Hetimet financiare dhe sekuestrimi i aseteve janë kryesisht joefektive. Edhe pse janë ndërmarrë disa hapa përgatitor, pika e kontaktit për bashkëpunim me Europolin nuk është ende funksionale. Bosnja dhe Hercegovina nuk ka ndërmarrë asnjë hap për të vendosur bashkëpunimin me Eurojust. Vendi duhet të vazhdojë përpjekjet e tij në luftën kundër terrorizmit dhe trafikut të drogës dhe të rris kapacitetin e tij për ta bërë këtë.

Për sa i përket **të drejtave themelore**, ndërkohë që korniza legjislative dhe institucionale është kryesisht e vendosur, Bosnja dhe Hercegovina ende nuk ka miratuar një kornizë strategjike gjithëpërfshirëse. Nevojiten reforma të rëndësishme për të siguruar që të gjithë qytetarët të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e tyre politike dhe për të siguruar arsim jodiskriminues, gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë, duke përfshirë edhe tejkalimin e praktikës së 'dy shkollave nën një çati'. Nuk është bërë përparim në garantimin e lirisë së shprehjes dhe të medias, në mbrojtjen e gazetarëve nga kërcënimet dhe dhuna duke siguruar një ndjekje të duhur gjyqësore, as në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të sistemit të transmetimit publik. Sfidat vazhdojnë në lidhje me lirinë e tubimit, veçanërisht në entitetin *Republika Srpska*, ku aktivistët i janë nënshtruar frikësimit dhe ndjekjes gjyqësore.

Dështimi i autoriteteve për të krijuar një sistem të qëndrueshëm **migrimi** dhe azili çoi në një krizë humanitare në dhjetor të vitit 2020. Pas angazhimit dhe mbështetjes së gjerë të BE-së, u krijua një kamp i përkohshëm tendash në Lipa për t'u ofruar strehim të gjithë personave në nevojë. Një qendër e përhershme e pritjes shumë-qëllimëshe po ndërtohet në Lipa gjatë vitit 2021. Bosnja dhe Hercegovina ka shtuar përpjekjet për të përmirësuar menaxhimin e migracionit; ajo duhet të sigurojë koordinim efektiv, në të gjitha nivelet, të menaxhimit të kufirit dhe kapaciteteve të menaxhimit të migracionit, si

dhe funksionimin e sistemit të azilit. Kjo kërkon një shpërndarje të drejtë të përgjegjësi ndërmjet të gjitha entiteteve dhe kantoneve, duke përfshirë edhe në organizimin e qendrave të pritjes.

Për sa i përket **kritereve ekonomike**, Bosnja dhe Hercegovina ka bërë përparim të kufizuar dhe është në një fazë të hershme të krijimit të një ekonomie funksionale të tregut. Vendi mori masa për të luftuar efektet negative të pandemisë COVID-19 në ekonomi dhe në tregun e punës. Banka Qendrore ndërmori masa të rëndësishme për të përmirësuar kapacitetet e saj analitike. Janë marrë disa hapa për të forcuar rezistencën ndaj goditjeve të sektorit financiar. Megjithatë, nuk ka pasur masa të rëndësishme për të përmirësuar funksionimin e tregjeve të produkteve. Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet palëve të interesit të vendit është përkeqësuar më tej. Rezistenca nga entiteti i *Republika Srpska* kundër reformave të lidhura me *acquis* të BE-së në mbarë vendin ka ngadalësuar më tej përputhjen e vendit me kriteret e pranimit në BE. Si rezultat, struktura institucionale e vendit si dhe tregu i brendshëm i tij mbeten të fragmentuara. Nuk është arritur asnjë përmirësim në lidhje me sundimin e ligjit dhe funksionimin e institucioneve mbikëqyrëse dhe rregullatore në mbarë vendin. Kjo vazhdon të pengojë mjedisin e biznesit në vend. Cilësia e shpenzimeve publike nuk është përmirësuar, ndërkohë që sektori publik ka mbetur joefikas dhe i stërmadh.

Bosnja dhe Hercegovina ka bërë përparim të kufizuar dhe mbetet në një fazë të hershme për sa i përket kapacitetit për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut në BE. Niveli i përgjithshëm i cilësisë së arsimit ka mbetur i ulët, ndërsa masat për përmirësimin e infrastrukturës së transportit dhe energjisë kanë mbetur të pamjaftueshme. Shtrirja e rregullimit strukturor ka qenë e kufizuar.

Bosnja dhe Hercegovina në përgjithësi është në një fazë të hershme/ka njëfarë niveli përgatitjeje në lidhje me nivelin e saj të gatishmërisë dhe aftësisë për të marrë përsipër **detyrimet e anëtarësimit në BE** dhe duhet të përshpejtojë ndjeshëm përafrimin me *acquis* të BE-së dhe të implementojë dhe zbatojë legjislacionin përkatës. Gjatë periudhës raportuese u arrit progres i kufizuar apo aspak progres në kapitujt e ndryshëm të *acquis* të BE-së.

Bosnja dhe Hercegovina ka shënuar kthim prapa në fushën e **prokurimit publik**, ku ka aplikuar trajtim preferencial për ofertuesit vendas në dhënien e kontratave publike gjatë pjesës më të madhe të periudhës raportuese; ndryshimet në ligjin e prokurimit publik janë në pritje të miratimit nga parlamenti. Është bërë përparim i kufizuar në **statistika**, pasi përgatitja për regjistrimin e ardhshëm të popullsisë dhe banesave nuk ka përparuar pothuajse fare. Është bërë njëfarë progresi në **kontrollin** e brendshëm **financiar** publik, me miratimin e strategjive nga të dyja entitetet.

Kërkohen hapa të mëdhenj për të harmonizuar kuadrin legjislativ me *acquis* të BE-së për **tregun e brendshëm** (lëvizja e lirë e mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, politika e konkurrencës dhe shërbimet financiare). Bosnja dhe Hercegovina ka bërë njëfarë progresi vetëm në politikën e konkurrencës, duke përafruar më tej ligjin për ndihmën shtetërore me *acquis* të BE-së dhe në shërbimet financiare. Ky grup është kyç për përgatitjet e Bosnjë-Hercegovinës për kërkesat e tregut të brendshëm të BE-së dhe është shumë i rëndësishëm për integrimin e hershëm dhe zhvillimin e Tregut të përbashkët rajonal.

Bosnja dhe Hercegovina bëri përparim të kufizuar ose aspak përparim në shumicën e fushave të **konkurrencës dhe rritjes gjithëpërfshirëse** (shoqëria e informacionit dhe media, taksat, politika ekonomike dhe monetare, politika e ndërmarrjeve dhe industriale, arsimi dhe kultura dhe unioni doganor), ku është në një fazë fillestare ose ka një nivel përgatitjeje. Këto fusha kanë lidhje të rëndësishme me Programin e reformës ekonomike të vendit. Reformat socio-ekonomike duhet të ndiqen për të ndihmuar në adresimin e dobësive strukturore ekzistuese, konkurrencës së ulët, papunësisë së lartë, si dhe ndikimit të pandemisë, e cila ka rritur më tej urgjencën e tyre. Është bërë njëfarë progresi me miratimin e politikave për arsimin gjithëpërfshirës, arsimin dhe trajnimin profesional dhe mësimin sipërmarrës.

Bosnja dhe Hercegovina bëri njëfarë progresi ose progres të kufizuar në shumicën e fushave që lidhen me **Agjendën e gjelbër dhe konektivitetin e qëndrueshëm**, (rrjetet trans-evropiane, energjia dhe mjedisi dhe ndryshimet klimatike), ku është në një fazë të hershme ose ka njëfarë niveli të përgatitjes.

Vendi duhet të rris ndjeshëm ambiciet e tij drejt një tranzicioni të gjelbër dhe të harmonizojë ligjet e tij për gazin dhe energjinë elektrike me *acquis* të BE-së. Tranzicioni i gjelbër dhe konektiviteti i qëndrueshëm janë kyçe për integrimin ekonomik brenda rajonit dhe me BE-në, duke lehtësuar tregtinë ndërkufitare brenda rajonit dhe duke krijuar përfitime reale për bizneset dhe qytetarët. Ky grup dhe reformat në fjalë kanë lidhje të rëndësishme me Programin e reformës ekonomike, Planin ekonomik dhe të investimeve dhe Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor.

Bosnja dhe Hercegovina nuk bëri përparim në fushat që lidhen me **burimet, bujqësinë dhe kohezionin** (bujqësia dhe zhvillimi rural, siguria ushqimore, politika veterinare dhe fitosanitare, peshkimi dhe dispozitat financiare dhe buxhetore), ku përgatitja është kryesisht në një fazë të hershme.

Bosnja dhe Hercegovina ka një nivel përgatitjeje, por nuk ka bërë përparim në lidhje me **marrëdhëniet e jashtme**. Vendi duhet të intensifikojë përpjekjet për të finalizuar anëtarësimin e tij në Organizatën Botërore të Tregtisë. Bosnja dhe Hercegovina inkurajohet fuqimisht të përmirësojë përafrimin e saj me deklaratat e politikës së jashtme të BE-së dhe masat kufizuese, e cila ka rënë ndjeshëm për të arritur në 43% deri në gusht 2021, gjë që është shqetësuese. Bosnja dhe Hercegovina vazhdoi të marrë pjesë aktive në **bashkëpunimin rajonal** dhe të mbajë marrëdhënie të mira fqinjësore.

Kosova

Përsa i përket **kritereve politike**, pjesa më e madhe e periudhës së raportimit u shënuar nga jostabiliteti politik në Kosovë. Pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në shkurt 2021, një qeveri e re mori detyrën, me një shumicë parlamentare të fortë të paprecedentë.

Gjatë pjesës më të madhe të periudhës raportuese, aktivitetet legjislative ishin të kufizuara për shkak të këtij jostabiliteti politik, duke përfshirë përpjekjet për reforma të lidhura me BE-në. Miratimi i një faze të dytë të Agjendës së Reformave Evropiane (ERA 2) dhe Planit të veprimit të saj, të miratuar nga Kuvendi në tetor 2021, dhe një fokus solid i qeverisë, konfirmoi trendin pozitiv të përkushtimit të ripërtërirë të Kosovës ndaj reformave të ndërlidhura me BE-në.

Pas një vendimi të Gjykatës Kushtetuese të dhjetorit 2020, i cili shpalli të pavlefshme zgjedhjen e qeverisë së mëparshme në qershor 2020, Kuvendi u shpërnda dhe zgjedhjet e parakohshme u mbajtën në shkurt 2021. Pas fitores dërrmuese të një aleance opozitare të udhëhequr nga partia Vetëvendosje, shumica e re e Kuvendit miratoi një qeveri të re në mars të vitit 2021.

Në nëntor të vitit 2020, ndaj Presidentit të Kosovës në detyrë u ngrit aktakuzë dhe ai u arrestua nën akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit nga Prokuroria Speciale. Më pas ai dha dorëheqjen nga detyra. Kryetari i atëhershëm i Kuvendit u bë ushtrues detyre i Presidentit, në përputhje me Kushtetutën, përpara se të zgjidhej nga legjislativa e re për të shërbyer një mandat të plotë presidencial në prill të vitit 2021.

Për një pjesë të madhe të periudhës raportuese, atmosfera e polarizuar politike, mungesa e një shumice efektive qeveritare dhe mungesa e kuorumit ndikuan rëndë në vendimmarrjen e **Kuvendit**. Është e nevojshme që Kuvendi të përmirësojë kuadrin e tij rregullator, duke përfshirë rregulloren e punës. Kuvendi ka qëndruar i hapur gjatë pandemisë, duke zbatuar masat mbrojtëse shëndetësore.

Në përgjithësi, **zgjedhjet** legjislative të shkurtit 2021 ishin të mirëadministruara, transparente dhe konkurruese, pavarësisht disa mangësive. Procesi zgjedhor i Kosovës mbetet në nevojë për fuqizim gjithëpërfshirës për të adresuar dobësitë e kahershme gjatë gjithë ciklit zgjedhor, siç janë identifikuar në misionet e njëpasnjëshme të vëzhgimit të zgjedhjeve të BE-së që nga viti 2014. Forcimi i kornizës ligjore dhe institucionale për financimin e fushatës dhe partive politike mbetet një fushë pezull që ka nevojë për reforma.

Situata në veri të Kosovës mbetet sfiduese, veçanërisht në aspektin e korrupsionit, krimit të organizuar dhe kushteve për lirinë e shprehjes.

Ka njëfarë niveli përgatitjeje në fushën e **reformës së administratës publike**, por nuk ka pasur progres në këtë drejtim gjatë periudhës raportuese, duke pasur parasysh ndryshimet e shpeshta të

qeverisë. Ligji për zyrtarët publikë ka hyrë në fuqi në qershor, por nuk janë bërë përpjekje të konsiderueshme për të filluar zbatimin e tij, veçanërisht në lidhje me rekrutimet. Krijimi i një departamenti efektiv qendror të rekrutimit u vonua. Në disa raste është vërejtur ndikim i padrejtë politik mbi emërimet dhe shkarkimet e funksionarëve të lartë publikë dhe nëpunësve civilë dhe Kosova ka përmbushur vetëm disa nga zotimet e saj ndaj kritereve të bazuara në merita. Nuk ka bërë përpërim në adresimin e pabarazive në sistemin e pagave në sektorin publik. Procesi për racionalizimin e agjencive ka ngecur. Pasiguria ligjore për bizneset dhe individët vazhdon për shkak të mungesës së vazhdueshme të progresit në harmonizimin e legjislacionit sektorial me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Një angazhim i ripërtërirë për reformën e administratës publike është urgjent.

Kosova është ende në një fazë të hershme në zhvillimin e një **sistemi gjyqësor** që funksionon mirë. Administrimi i përgjithshëm i drejtësisë vazhdon të jetë i ngadaltë, joefikas dhe i cënueshëm ndaj ndikimeve të panevojshme politike. Është bërë njëfarë progresi gjatë periudhës raportuese. Rishikimi funksional i sektorit të sundimit të ligjit rezultoi në Strategjinë e sundimit të ligjit dhe planin e veprimit, i cili përshkruan sfidat kryesore në sistemin e sundimit të ligjit dhe u ai miratua në gusht 2021. Kosova krijoi një sistem elektronik të menaxhimit të rasteve dhe ngriti një sistem qendror të evidencës penale, megjithatë sfidat mbeten. Ka bërë përpjekje për zbatimin e Ligjit për ndërmjetësim. Pandemia e COVID-19 ndikoi në procedimin efektiv të rasteve dhe mbajtjen e seancave gjyqësore (dhe qasjen publike në to) në Kosovë. Qeveria e re ka shqyrtuar disa opsione për një proces ‘vetingu’ të gjyqësorit dhe prokurorisë. Në këtë kontekst, prezantimi i mundshëm i një rivlerësimi të plotë e të njëhershëm të të gjithë prokurorëve dhe gjyqtarëve është një burim shqetësimi serioz. Një proces i tillë duhet të konsiderohet vetëm si një masë e jashtëzakonshme e fundit, pasi të jenë ezauruar të gjitha mjetet dhe mekanizmat ekzistues për të garantuar integritetin dhe për të luftuar korrupsionin e zyrtarëve gjyqësorë dhe duhet të jetë në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe me këshillat e Komisionit të Venecias.

Kosova është në një fazë të hershme/ka një nivel të përgatitjes në **luftën kundër korrupsionit**. Gjatë periudhës së raportimit, është bërë përpërim i kufizuar, duke përfshirë hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të nivelit të lartë të shënjestruara “in the track record”. Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të arritur hetime më proaktive, vendime gjyqësore përfundimtare dhe konfiskim përfundimtar të aseteve. Zyra e Prokurorisë Speciale u forcua me funksionimin e Departamentit të Korrupsionit dhe Krimin Financiar dhe arriti një rritje të përgjithshme të nivelit të personelit. Pakoja ligjore kundër korrupsionit dhe Kodi i rishikuar i procedurës Penale mbeten ende të miratohen. Korniza ligjore për konfiskimin është në fuqi por nuk po zbatohet në mënyrë konsistente dhe vlera e aseteve të konfiskuara përfundimisht mbetet e ulët. Në përgjithësi, korrupsioni është i përhapur dhe mbetet një çështje shqetësuese serioze. Pavarësisht përpjekjeve të bëra, ekziston nevoja për vullnet të fortë dhe të vazhdueshëm politik për të trajtuar në mënyrë efektive rreziqet e korrupsionit sistematik, si dhe një përgjigje të fuqishme të drejtësisë penale ndaj korrupsionit të nivelit të lartë.

Kosova është në një fazë të hershme në **luftën kundër krimit të organizuar**. Ajo bëri përpërim të kufizuar gjatë periudhës së raportimit në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të krimit të organizuar. Prokuroria Speciale u forcua me staf shtesë të specializuar dhe u zhvilluan aktivitete të synuara trajnuese. Megjithatë, mjetet e fuqishme të parashikuara nga Kodi Penal dhe Ligji për kompetencat e zgjeruara të konfiskimit ende nuk janë shfrytëzuar plotësisht nga policia dhe prokurorët. Nevojiten masa për të forcuar prokurorinë si dhe për të siguruar që të mos ketë ndërhyrje politike në aktivitetet operacionale të të gjitha organeve të zbatimit të ligjit.

Në korrik 2020, Europoli dhe Policia e Kosovës kanë lidhur një marrëveshje pune. Marrëveshjet shtesë të nevojshme për funksionalizimin e këtij bashkëpunimi, duke lejuar aksesin në Aplikacionin e rrjetit të shkëmbimit të sigurt të informacionit (SIENA) dhe shkëmbimin e Oficerëve Ndërlidhës, u finalizuan në shtator 2021.

Është bërë përpërim në **luftën kundër terrorizmit**, në përputhje me objektivat e përcaktuara në marrëveshjen zbatuese BE-Kosovë për Planin e përbashkët të veprimit kundër terrorizmit për

Ballkanin Perëndimor, veçanërisht në lidhje me rehabilitimin dhe riintegrimin e luftëtarëve të huaj terroristë dhe familjeve të tyre. Autoritetet e Kosovës duhet të jenë më efektive në përpjekjet e tyre për të luftuar pastrimin e parave dhe ligji në fuqi duhet të përafrohet me *acquis* të BE-së dhe me standardet ndërkombëtare.

Kuadri ligjor garanton gjerësisht mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe **themelore** në përputhje me standardet evropiane. Megjithatë, nevojiten përpjekje shtesë për ta zbatuar plotësisht atë dhe për të përmirësuar koordinimin dhe mbikëqyrjen e politikave dhe legjislacionit për të drejtat themelore. Autoritetet ende varen nga mbështetja dhe udhëzimi i donatorëve dhe duhet të marrin pronësi më të madhe. Duhet bërë më shumë për të garantuar në mënyrë efektive të drejtat e personave që u përkasin pakicave, përfshirë romët²¹ dhe ashkalitë dhe personat e zhvendosur, për të siguruar barazinë gjinore në praktikë dhe për të avancuar mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Sa i përket **lirisë së shprehjes**, Kosova ka njëfarë niveli të përgatitjes dhe përfiton nga një mjedis pluralist dhe i gjallë mediatik. Megjithatë, shqetësimet mbeten në lidhje me fushatat e shpifjeve publike, kërcënimet dhe sulmet fizike ndaj gazetarëve. Mungesa e vetëqëndrueshmërisë financiare, e përkeqësuar më tej nga pandemia e COVID-19, e lë median të pambrojtur ndaj interesave politike dhe të biznesit. Transmetuesi publik gjithashtu mbetet i cenueshëm ndaj ndikimit politik dhe ende duhet gjetur një zgjidhje e qëndrueshme për financimin e tij.

Autoritetet e Kosovës vazhduan të bëjnë përparim në menaxhimin e flukseve të migrimit të rregullt dhe të **migrimit** të përzier në kontekstin e rënduar të pandemisë COVID-19. Kosova rriti më tej kapacitetin e saj akomodues dhe rriti gatishmërinë për të trajtuar një fluks të shtuar hyrës të migrantëve.

Për sa i përket **kritereve ekonomike**, Kosova ka bërë progres të kufizuar dhe është në një fazë të hershme të zhvillimit të një ekonomie tregu funksionale. Ekonomia u zhyt në recesion në vitin 2020, por ky trend u përmbys në gjysmën e parë të vitit 2021. Problemet strukturore të kahmotshme, si mungesa e diversifikimit ekonomik dhe varësia nga flukset financiare nga diaspora e bënë Kosovën shumë të cenueshme ndaj mbylljes dhe kufizimeve të udhëtimeve të lidhura me pandeminë. Në përgjigje të krizës, autoritetet pezulluan rregullin fiskal dhe miratuan dy pako fiskale. Një rritje e fortë e shpenzimeve dhe tkurrja e të ardhurave tatimore rezultoi në një deficit të madh buxhetor në vitin 2020, por rikuperimi i të ardhurave tatimore ndihmoi në arritjen e një suficiti buxhetor në gjysmën e parë të vitit 2021. Mjedisi i biznesit pati pak përmirësim. Zhvillimi i sektorit privat mbetet i kufizuar nga një ekonomi joformale e përhapur, një gjyqësor i ngadaltë dhe joefikas, një prevalencë e lartë e korrupsionit dhe sundimi i dobët i ligjit në përgjithësi.

Kosova ka bërë progres të kufizuar dhe është në një fazë të hershme sa i përket **kapacitetit për t'u përballur me presionin konkurrues dhe forcat e tregut** në BE. Është bërë pak përparim në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe adresimin e boshllëqeve të aftësive në tregun e punës. Kosova ka bërë disa përparime në përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe rritjen e investimeve në burimet e ripërtëritshme, por furnizimi me energji me bazë tërëgjilje, i vjetëruar dhe jo i besueshëm mbetet shqetësues. Kosova ka bërë disa përparime sa i përket dixhitalizimit të ekonomisë. Ndryshimet strukturore po shfaqen vetëm ngadalë pasi ekonomia mbetet shumë e varur nga firmat e vogla dhe shumë të vogla, të cilat nuk mund të konkurrojnë ndërkombëtarisht, ndërkohë që struktura e eksportit mbetet e dominuar nga disa produkte, si metalet bazë.

Sa i përket **marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe bashkëpunimit rajonal**, Kosova vazhdoi të marrë pjesë në shumicën e forumeve rajonale. Kosova ka mbajtur në përgjithësi marrëdhënie të mira me Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut. Nuk ka pasur asnjë ndryshim në marrëdhëniet

²¹ Të gjitha këto grupe konsiderohen nën termin më të gjerë ombrellë 'romë' nën kuadrin e BE-së për Strategjitë Kombëtare të Integritimit të Romëve.

formale të Kosovës me Bosnjën dhe Hercegovinën, e cila nuk e njeh pavarësinë e Kosovës dhe të dyja mbajnë një regjim të rreptë vizash.

Lidhur me **normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë**, dialogu i ndërmjetësuar nga BE-ja ka vazhduar me takimet e nivelit të lartë më 15 qershor dhe 19 korrik 2021, si dhe me tre takime të kryenegociatorëve. Gjatë periudhës raportuese të dyja palët emëruan kryenegociatorë të rinj dhe ekipe negociuese. Kosova duhet të angazhohet në mënyrë konstruktive dhe të bëjë përpjekje të mëtijshme thelbësore për zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të kaluara dhe të kontribuojë në arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse të normalizimit ligjërish të detyrueshme me Serbinë. Një marrëveshje e tillë është urgjente dhe vendimtare në mënyrë që Kosova dhe Serbia të mund të avancojnë në rrugët e tyre përkatëse evropiane.

Për sa i përket përafrimit me **standardet evropiane**, është bërë njëfarë progresi gjatë periudhës raportuese në fushat e prokurimit publik, statistikave dhe kontrollit financiar. Në shumicën e fushave të mbuluara nga Grupi (klasteri) 2 mbi tregun e brendshëm, Kosova ka një nivel të përgatitjes përkatësisht lëvizjen e lirë të mallrave, kapitalit, të drejtës së shoqërive tregtare dhe pronës intelektuale, ndërsa është mesatarisht e përgatitur për lëvizjen e punëtorëve, shërbimet dhe të drejtën e themelimit, dhe për shërbimet financiare. Kosova është në një fazë të hershme të përgatitjes për konkurrencën, si dhe për politikën e konsumatorit dhe mbrojtjen e shëndetit. Në periudhën raportuese, Kosova ka bërë disa përparime në të gjitha fushat, përveç politikës së konsumatorit dhe mbrojtjes së shëndetit, ku është bërë vetëm progres i kufizuar. Në fushën e konkurrencës dhe rritjes gjithëpërfshirëse, ajo bëri disa përparime në shumicën e fushave (doganat, taksat, shoqëria e informacionit dhe media, sipërmarrjet dhe politikat industriale), por bëri vetëm përparim të kufizuar në kërkim, arsim dhe kulturë. Ajo bëri disa përparime në fushat e politikave që lidhen me Agjendën e gjelbër dhe të konektivitetit të qëndrueshëm, në sektorin e energjisë, por vetëm progres të kufizuar në fushat e transportit, mjedisit dhe ndryshimeve klimatike. Në fushën e burimeve dhe bujqësisë, ajo bëri përparim të kufizuar në bujqësi, siguri ushqimore, politika veterinare dhe fitosanitare. Në politikën tregtare, është bërë njëfarë progresi në zvogëlimin e deficitit tregtar të Kosovës, por Kosova ende nuk i ka ratifikuar protokollin shtesë të CEFTA-s për lehtësimin e tregtisë dhe tregtinë e shërbimeve. Në përgjithësi, Kosova duhet të përmirësojë kapacitetin e saj administrativ dhe koordinimin në të gjithë sektorët, për të arritur zbatimin efektiv të *acquis* të BE-së.

Turqia

Ka mangësi serioze në funksionimin e **institucioneve demokratike** të Turqisë. Ecja demokratike prapa vazhdoi gjatë periudhës raportuese. Mangësitë strukturore të sistemit presidencial mbetën në vend. Rekomandimet kryesore të Këshillit të Evropës dhe organeve të tij mbeten për t'u adresuar. Parlamentit vazhduan t'i mungojnë mjetet e nevojshme për ta mbajtur qeverinë përgjegjëse. Arkitektura kushtetuese vazhdoi të centralizonte pushtetet në nivelin e Presidencës pa siguruar një ndarje të shëndoshë dhe efektive të pushteteve midis ekzekutivit, legjislativit dhe gjyqësorit. Në mungesë të një mekanizmi efektiv kontrolli dhe balanci, llogaridhënia demokratike e degës ekzekutive mbetet e kufizuar në zgjedhje. Vazhdoi shënjestrimi i partive opozitare, duke përfshirë pranimin nga Gjykata Kushtetuese të një aktakuze nga Kryeprokurori Publik i Gjykatës së Kasacionit që kërkonte mbylljen e partisë së dytë më të madhe opozitare, e cila kontribuoi në dobësimin e pluralizmit politik në Turqi. Gjatë periudhës së raportimit, Presidenti shkarkoi dy herë guvernatorin e Bankës Qendrore.

Pavarësisht përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme në korrik të vitit 2018, disa dispozita ligjore që u japin autoriteteve qeveritare kompetenca të jashtëzakonshme dhe ruajnë disa elementë kufizues nga rregulli i emergjencës mbetën të integruara në ligj, gjë që vazhdoi të kishte një ndikim të rëndësishëm në demokraci dhe të drejtat themelore. Në korrik 2021, parlamenti i Turqisë miratoi një projekt-ligj që zgjat edhe për një vit kohëzgjatjen e këtyre elementeve kufizuese të gjendjes së jashtëzakonshme. Komisioni Hetimor për Gjendjen e Jashtëzakonshme nuk e ka përfunduar ende shqyrtimin e ngarkesës së tij me raste në lidhje me nëpunësit publikë të cilët janë shkarkuar me dekret gjatë rregullit të emergjencës.

Presioni mbi kryetarët e bashkive të partive opozitare nga qeveria e koalicionit në pushtet e dobësoi më tej demokracinë lokale. Kryebashkiakët nga partitë opozitare u përballën me hetime administrative dhe gjyqësore. Në juglindje, kryebashkiakët e shkarkuar me forcë vazhduan të zëvendësohen nga administrues të besuar të emëruar nga qeveria, duke u mohuar qytetarëve përfaqësimin e tyre të zgjedhur. Në shumicën e rasteve, të besuarit e ardhur i kanë mbajtur të pezulluara kuvendet komunale. Qindra politikanë vendas dhe zyrtarë të zgjedhur u arrestuan me akuza të lidhura me terrorizmin.

Situata në juglindje mbeti shumë shqetësuese. Qeveria kreu operacione të sigurisë së brendshme dhe ndërkuftare dhe ushtarake në Irak dhe Siri. Situata e sigurisë mbeti e pasigurt në zonat kufitare me akte terroriste të përsëritura nga Partia e Punëtorëve të Kurdistanit (PKK), e cila mbetet në listën e BE-së të personave, grupeve dhe subjekteve të përfshirë në akte terrorizmi. BE-ja dënoi në mënyrë të qartë sulmet e PKK-së dhe shprehu solidaritetin me familjet e viktimave. Ndërsa qeveria ka të drejtë legjitime për të luftuar terrorizmin, është thelbësore që ajo ta bëjë këtë në përputhje me sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Masat kundër terrorizmit duhet të jenë proporcionale. Nuk pati zhvillime për rifillimin e një procesi politik të besueshëm për të arritur një zgjidhje paqësore dhe të qëndrueshme. Organizatat e të drejtave të njeriut dhe partitë opozitare raportuan shkelje të rënda të të drejtave të njeriut nga forcat e sigurisë.

Rreth 4 000 anëtarë dhe zyrtarë të Partisë Demokratike Popullore (HDP) mbeten në burg, duke përfshirë një numër deputetësh. Në qershor, Gjykata Kushtetuese pranoi një aktakuzë që kërkon mbylljen e HDP-së, duke kërkuar një ndalim politik për 451 drejtues të HDP-së, duke përfshirë bashkëkryetarët e partisë dhe të gjithë anëtarët e kaluar dhe të tanishëm të Parlamentit dhe drejtuesit, si dhe ngrirjen e xhirologarive bankare të partisë. Kishte kërkesa në pritje nga prokuroria në Parlament për heqjen e imunitetit të pothuajse të gjithë deputetëve të HDP-së.

Përsa i përket **çështjeve të shoqërisë civile**, ka vazhduar kthimi serioz prapa. Shoqëria civile u përball me presion të vazhdueshëm dhe hapësira e tyre për të vepruar lirshëm ka vazhduar të zvogëlohet duke kufizuar lirinë e tyre të shprehjes dhe lirinë e asociimit. Ligji i ri për parandalimin e financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë ngre shqetësime në lidhje me kufizimet e mundshme mbi aktivitetet e mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe shoqërisë civile.

Korniza ligjore dhe institucionale që rregullon sektorin e sigurisë dhe inteligjencës mbeti e pandryshuar me **mbikëqyrjen** e përforcuar **civile të forcave të sigurisë** nën sistemin presidencial. Qeveria ndërmori hapa për të konsoliduar më tej kontrollin civil të forcave të sigurisë.

Turqia ka një nivel përgatitjeje/është e përgatitur mesatarisht në fushën e **reformës së administratës publike**. Nuk ka pasur progres gjatë periudhës raportuese. Turqisë i mungon një agjendë gjithëpërfshirëse e reformës së administratës publike dhe një institucion drejtues në krye të procesit. Shqetësimet mbetën rreth llogaridhënies së administratës dhe menaxhimit të burimeve njerëzore. Vullneti politik për reforma ende mungon. Edhe pse koordinimi i politikave ndërmjet institucioneve të qeverisë qendrore mbeti i fortë, bërja e politikave nuk bazohet në fakte apo nuk është pjesëmarrëse. Politizimi i administratës vazhdoi. Përfaqësimi i grave mbeti i ulët në nivelet më të larta të burokracisë.

Sistemi gjyqësor i Turqisë është në një fazë të hershme përgatitjeje. Kthimi serioz prapa i vërejtur që nga viti 2016 vazhdoi. Shqetësimet mbetën, veçanërisht për mungesën sistematike të pavarësisë së gjyqësorit dhe presionin e panevojshëm ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve. Plani i ri i veprimit për të drejtat e njeriut parashikon disa masa pozitive, por ai nuk adreson asnjë nga mangësitë kryesore që lidhen me pavarësinë e gjyqësorit. Në veçanti, nuk parashikohen masa për të përmirësuar respektimin e parimit të ndarjes së pushteteve ose për të përmirësuar strukturën dhe procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, rekomandime këto të kahmotshme në pritje të Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës dhe Komisionit Evropian. Pavarësisht liritë të tyre, asnjë nga gjyqtarët apo prokurorët e shkarkuar pas tentativës për grushtshtet nuk u rikthye në detyrë. Mungesa e kriterëve objektive, të bazuara në merita, uniforme dhe të paracaktuara për rekrutimin dhe promovimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve mbetet një burim shqetësimi. Institucioni i gjyqtarëve të së drejtës penale të paqes vazhdoi të ngrinte shqetësime mbi juridiksionin dhe praktikën e tyre.

Për sa i përket **luftës kundër korrupsionit**, Turqia ka mbetur në një fazë të hershme të përgatitjeve dhe nuk ka bërë përparim në periudhën raportuese. Vendi nuk krijoi organe kundër korrupsionit në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Turqisë. Të metat e kuadrit ligjor dhe arkitekturës institucionale lejuan ndikim të panevojshëm politik në fazat e hetimit dhe ndjekjes penale të rasteve të korrupsionit. Llogaridhënia dhe transparencja e institucioneve publike duhet të përmirësohet. Mungesa e një strategjie dhe plani veprimi kundër korrupsionit tregonte mungesë vullneti për të luftuar me vendosmëri kundër korrupsionit. Shumica e rekomandimeve të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit të Këshillit të Evropës (GRECO) nuk janë zbatuar. Në përgjithësi, korrupsioni është i përhapur dhe mbetet një çështje shqetësuese.

Turqia ka një nivel përgatitjeje në **luftën kundër krimit të organizuar** dhe ka bërë përparim të kufizuar. Bashkëpunimi ndërmjet Europolit dhe Turqisë bazohet në një Marrëveshje Strategjike për Bashkëpunim, e cila ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2004. Negociatat në lidhje me një marrëveshje ndërkombëtare për shkëmbimin e të dhënave personale ndërmjet Europolit dhe autoriteteve turke kompetente për luftimin e krimeve të rënda dhe terrorizmit janë në vazhdim, duke kërkuar nga Turqia të reformojë legjislacionin e saj duke përafuar ligjin e saj për mbrojtjen e të dhënave me standardet evropiane. Turqia duhet të përmirësojë historikun e saj në asgjësimin e rrjeteve kriminale dhe konfiskimin e aseteve kriminale. Kuadri ligjor që rregullon luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit duhet të përmirësohet në përputhje me rekomandimet e Task Forcës së Veprimit Financiar (TFVF) dhe ato të Komisionit të Venecias për ligjin për parandalimin e financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë. Nevojiten përpjekje për të përmirësuar legjislacionin për krimin kibernetik dhe mbrojtjen e dëshmitarëve.

